

---

## VENDIM

Nr.229, date 23.4.2004

### PER MIRATIMIN E CEREMONIALIT ZYRTAR TE REPUBLIKES SE SHQIPERISE

Ne mbështetje te nenit 100 te Kushtetutës dhe te neneve 12 pika 2 dhe 49 pika 1 te ligjit nr.9095, date 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm te Republikës se Shqipërisë", me propozimin e Ministrit te Punëve te Jashtme, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Miratimin e Ceremonialit Zyrtar te Republikës se Shqipërisë, qe i bashkëlidhet këtij vendimi.
  2. Revokimin e vendimit nr. 349, date 23.5.1998 te Këshillit te Ministrave "Rregullore e Ceremonialit Zyrtar te Republikës se Shqipërisë".
- Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

"1. Në Ministrinë e Punëve të Jashtme funksionon Zyra e Protokollit të Shtetit, e cila ka për detyrë:

- a) organizimin dhe realizimin e të gjithë veprimtarisë kryesore protokollare të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe Ministrit të Punëve të Jashtme për të gjithë veprimtarinë e tyre brenda dhe jashtë vendit;
- b) bashkërendimin e veprimtarisë protokollare të anëtarëve të Këshillit të Ministrave dhe titullarëve të institucioneve të larta qendrore;
- c) bashkërendimin dhe zbatimin e programit të vizitave të delegacioneve të huaja të nivelit të lartë.

2. Veprimtaria e Zyrës së Protokollit të Shtetit rregullohet me akte të veçanta ligjore ose nënligjore. "

Ligji nr.9095, datë 3.07.2003

KAPITULLI I

## PROTOKOLLI I SHTETIT

Ceremoniali i shtetit përfaqëson përmbledhjen institucionale të kriterëve që rregullojnë çdo aspekt të natyrës formale dhe joformale të marrëdhënieve zyrtare. Zbatimi i këtyre kriterëve është kompetencë e Protokollit të Shtetit.

Protokolli i Shtetit është zyra kompetente që përcakton dhe trajton në Republikën e Shqipërisë protokollin dhe ceremonialin zyrtar.

Protokolli i Shtetit kryen detyrën e zbatimit të ceremonialit zyrtar dhe veprimtarisë protokollare të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryetarit të Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme për veprimtaritë e tyre më të rëndësishme brenda dhe jashtë vendit.

### 1. Kompetencat e Protokollit të Shtetit

Protokolli i Shtetit kryen këto funksione:

1.1 Zbaton me saktësi radhën e përparësisë së rangjeve zyrtare të Republikës së Shqipërisë, trupit diplomatik, si dhe e përcakton atë në rastet e veçanta të paparashikuara në këtë rregullore. Kriteri themelor i funksionimit të kësaj strukture është respektimi i rangut zyrtar, i cili është i pa trashëgueshëm dhe i patjetërsueshëm.

1.2 Organizon dhe ndjek ceremonitë e pritjes e të përcjelljes së delegacioneve të huaja të rangut: kryetar shteti, kryetar qeverie, parlamenti dhe ministër i punëve të jashtme; harton në bashkëpunim me kabinetet e Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe Ministrit të Punëve të Jashtme programin e vizitës së tyre dhe përgjigjet për zbatimin e tij.

1.3 Përgatit anën protokollare për vizitat zyrtare jashtë shtetit të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe të Ministrit të Punëve të Jashtme. Protokolli i Shtetit, në bashkëpunim me përfaqësitë diplomatike shqiptare dhe me institucionin homolog të shtetit pritës, përpunon programin e vizitës së personaliteteve të mësipërme.

1.4 Përgjigjet për organizimin e ceremonive për festat zyrtare, kombëtare dhe lokale, në rastet kur ato janë jubilarë dhe kur për organizimin e të cilave ngrihet me akt normativ të Këshillit të Ministrave një komision shtetëror, ku merr pjesë edhe Protokolli i Shtetit.

1.5 Përgjigjet për veprimtaritë shtetërore, ku është i ftuar trupi diplomatik i akredituar në Republikën e Shqipërisë. Për çdo veprimtari tjetër angazhohet protokolli i institucionit ose zyrtarë të tjerë të ngarkuar nga titullari i atij institucioni.

1.6 Disiplinon përdorimin e simboleve kombëtare, flamurit kombëtar, himnit, stemës së Republikës dhe shenjave të tjera zyrtare.

1.7 Në bashkëpunim me Drejtorinë Politike të Ministrisë së Punëve të Jashtme sugjeron nivelin e përfaqësimit e të pjesëmarrjes së personaliteteve të larta shtetërore në veprimtaritë dhe pritjet kombëtare që organizohen nga përfaqësitë e huaja. Sugjerimi bëhet duke pasur parasysh reciprocitetin dhe interesat e Republikës së Shqipërisë për zhvillimin e marrëdhënieve ndërshtetërore.

1.8 Ndjek veprimtarinë protokollare të përfaqësuesve diplomatikë të vendit tonë jashtë shtetit dhe atyre të vendeve të huaja të akredituara në Republikën e Shqipërisë, që nga kërkesa e agreementit, paraqitja e letërkredencialeve, fillimi i detyrës së diplomatit e deri te përfundimi i saj.

1.9 Koordinon takimet e Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Ministrit të Punëve të Jashtme dhe të anëtarëve të tjerë të qeverisë me përfaqësuesit diplomatikë të akredituar

në Republikën e Shqipërisë.

1.10 Është struktura përgjegjëse për të filluar kërkesën për agreementin e ambasadorit shqiptar jashtë vendit, si dhe për përgatitjen e letërkredencialeve dhe të letërthirrjes , ndihmon dhe ndjek aktivitetin protokollar të përfaqësive shqiptare jashtë vendit dhe zbatimin e reciprocitetit nga ana e tyre.

1.11 Në bashkëpunim me Drejtorinë Politike të Ministrisë së Punëve të Jashtme, realizon shkëmbimin e telegrameve e të korrespondencës zyrtare të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit e të Ministrit të Punëve të Jashtme me personalitetet e larta të shteteve të tjera dhe të organizatave të ndryshme ndërkombëtare.

1.12 Mobilizon dhe drejton në funksion të aktiviteteve ceremoniale të rëndësishme shtetërore të kompetencës së tij të gjitha strukturat e Ministrisë së Punëve të Jashtme, të institucioneve të tjera qendrore e lokale, civile e ushtarake, të cilat lidhen drejtpërdrejt me këto aktivitete.

1.13 Në raste shkeljesh të përsëritura të udhëzimeve që lidhen me zbatimin e ceremonialit zyrtar të Republikës së Shqipërisë, Protokollit i Shtetit rezervon të drejtën e propozimit për masa administrative ndaj zyrtarëve të sektorëve që mbulojnë protokollin.

1.14 Institucionet qendrore apo vendore, si dhe përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë janë të detyruara t' i ofrojnë Protokollit të Shtetit informacionin e kërkuar kur ai lidhet drejtpërdrejt ose jo me aktivitetin e tij, me normativat e ceremonialit zyrtar, të konventave të Vjenës "Për marrëdhëniet diplomatike" dhe "Për marrëdhëniet konsullore", si dhe për zbatimin e reciprocitetit.

1.15 Merret me organizimin dhe ndjekjen e konferencave shumëpalëshe të nivelit: kryetar shteti, kryetar qeverie dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme. Çdo lloj tjetër konference shumëpalëshe e nivelit më të ulët organizohet nga protokollat dhe drejtoritë e institucioneve përkatëse që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me këtë aktivitet. Protokollit i Shtetit ofron ndihmën e tij në raste të tilla.

1.16 Është i autorizuar që në respektim të reciprocitetit dhe marrëveshjeve në fuqi të kërkojë lehtësimin ose përjashtimin nga taksat kufitare të personave apo delegacioneve të huaja zyrtare që vijnë në Shqipëri.

1.17 Punonjësve të Protokollit të Shtetit u krijohen lehtësitë e nevojshme për të hyrë në të gjitha institucionet qendrore të shtetit për shkak të detyrës.

1.18 Drejton dhe organizon aktivitetin e klubit diplomatik.

## 2. Zyra të tjera protokollit

2.1 Institucionet qendrore të shtetit kanë veçoritë dhe specifikat e tyre në zbatimin e protokollit zyrtar. Pranë tyre operojnë zyrat përkatëse që trajtojnë drejtpërsëdrejti praktikat ceremoniale në shërbim të titullarëve të tyre.

2.2 Ato përgjigjen për aktivitetin zyrtar të titullarëve përkatës, jetën e përditshme me karakter formal ose jo të tyre, lëvizjet brenda territorit të Shqipërisë, inaugurime, pritje dhe vizita, takime dhe evenimente të ndryshme publike.

2.3 Protokollit i Kuvendit përgjigjet për zbatimin e ceremonialit të brendshëm të këtij institucioni, aktivitetit parlamentar dhe rregullimin e aspekteve të ndryshme të marrëdhënieve me trupin diplomatik, marrëdhënieve publike të institucionit dhe takimet e parlamentarëve me delegacionet e huaja.

2.4 Protokollit i Ministrisë së Mbrojtjes ka kompetencën e organizimit të ceremonive respektive

ushtarake brenda territorit të këtij institucioni dhe reparteve ushtarake, në përputhje me normat themelore të ceremonialit zyrtar të Republikës dhe rregulloret ushtarake në fuqi.

2.5 Protokollit i Shtetit mban lidhje të ngushta me protokollat e institucioneve qendrore e vendore. Ai komunikon praktikat protokollare, shkëmben informacione, organizon takime konsultative dhe shërben njëkohësisht si strukturë qendrore e unifikimit dhe e mbikëqyrjes së praktikave protokollare dhe të ceremonialit.

## KAPITULLI II

### CEREMONIALI DIPLOMATIK

Ceremoniali diplomatik parashikon dhe disiplinon raportet e kontaktet protokollare midis shtetit shqiptar dhe shteteve të tjera, rregullat, praktikat administrative dhe avantazhet që gëzojnë përfaqësitë diplomatike në Shqipëri, në përputhje me konventat e Vjenë "Për marrëdhëniet diplomatike" dhe "Për marrëdhëniet konsullore", marrëveshjet dy dhe shumëpalëshe dhe mbi bazën e reciprocitetit.

Ceremoniali diplomatik përmbledh formalitetet që respektohen për ardhjen dhe largimin nga Shqipëria të funksionarëve diplomatikë, veçoritë e statusit të tyre, imunitetet, privilegjet e trupit diplomatik, modalitetet e sigurimit të tyre dhe një varg informacionesh të tjera të vlefshme. Është detyrë ekskluzive e Protokollit të Shtetit të drejtojë dhe t'i respektojë këto procedura të rëndësishme.

#### 1. Akreditimi i shefit të misionit diplomatik

1.1 Në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe praktikat ndërkombëtare, ambasadorët e huaj akreditohen te Kryetari i Shtetit si përfaqësues të kreut të shtetit të tyre. Akreditimi i ambasadorëve si proces kalon në disa shkallë, gjatë të cilave kërkohet plotësimi i formaliteteve të paracaktuara.

1.2 Procedura fillon me marrjen e kërkesës, në formën e një note diplomatike për agreement, e cila i dërgohet Protokollit të Shtetit nga ambasada e vendit për kues në Shqipëri, që vjen nëpërmjet njoftimit të përfaqësisë diplomatike shqiptare në atë vend ose nga një vend i tretë. Pas kësaj, përgatitet nga Protokollit i Shtetit një informacion vlerësues, i cili së bashku me CV -në përkatëse i dorëzohet Presidentit të Republikës.

1.3 Pas miratimit të agreementit, Protokollit i Shtetit ka për detyrë të informojë ambasadën e vendit nga është paraqitur kërkesa për qëndrimin e Qeverisë shqiptare, si dhe përfaqësinë tonë në atë vend. Në përgjithësi, kjo procedurë kërkon deri 30 ditë punë ose zbatohet parimi i reciprocitetit.

1.4 Mbërritja e ambasadorit të ri është objekt i rregullave të veçanta që zbatohen nga ceremoniali diplomatik i Protokollit të Shtetit. Nëse ardhja bëhet brenda ditëve të punës në orët 07:00 deri 22:00, atëherë atij i urohet mirëseardhja nga zyrtari përkatës i protokollit dhe shoqërohet prej tij në sallën VIP të aeroportit. Për çdo ditë dhe orë tjetër, ambasadori pritët nga personeli i autorizuar i aeroportit.

1.5 Shefi i ceremonialit i bën ambasadorit të ri në kohën më të shpejtë një vizitë kortezie, në të cilën atij i komunikohet data e takimit me Drejtorin e Protokollit të Shtetit për dorëzimin e kopjeve të kredencialeve dhe të letërthirrjes së ambasadorit paraardhës. Atij i dorëzohet gjithashtu edhe rregullorja përkatëse e ceremonisë së paraqitjes së letërkredencialeve te Presidenti i Republikës.

1.6 Data dhe ora e mbërritjes së ambasadorit regjistrohet nga protokollit, sepse përcakton edhe radhën e paraqitjes së kredencialeve. Nëse protokollit nuk merr dijëni për ardhjen e tij, atëherë si datë e mbërritjes konsiderohet koha kur ambasada përkatëse lajmëron me notë verbale për mbërritjen e shefit të saj.

1.7 Që prej këtij momenti, ai konsiderohet si ambasador i emëruar dhe brenda disa ditëve (jo më shumë se 10 ditë) Drejtori i Protokollit të Shtetit (ose zëvendësi) e pret për të marrë kopjet e letërkredencialeve dhe të thirrjes së paraardhësit. Gjatë kësaj kohe, ambasadori i ri mund të takojë anëtarë të trupit diplomatik, zyrtarë të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe persona të tjerë jozyrtarë, por i sugjerohet që të mos kërkojë takim me anëtarët e Këshillit të Ministrave, Kuvendit dhe Presidencës.

1.8 Sapo Presidenca përcakton datën e ceremonisë së akreditimit, Protokollit i Shtetit informon ambasadorin. Shkresa përkatëse përcakton, përveç ceremonisë, gjuhën e përdorur, vendin nga ku ambasadori do të merret në ceremoni dhe emrat e një deri dy bashkëpunëtorëve të tij që janë paracaktuar për ta shoqëruar.

1.9 Veshja e rekomanduar është kostum i zi ose gri e errët, këmbishë e bardhë, kravatë e errët, këpucë të zeza ose veshje kombëtare. Që nga ky moment, ambasadori i ri gëzon statusin e tij diplomatik.

1.10 Lajmi i akreditimit të ambasadorit të ri publikohet menjëherë në botimin e radhës së Fletores Zyrtare. Për këtë kujdeset zyra e Presidentit.

1.11 Brenda një periudhe kohe prej një deri në dy muaj nga paraqitja e kredencialeve, ambasadori i ri thirret së bashku me një ose dy ambasadorë të tjerë për drekë ose darkë kortezie nga Ministri i Punëve të Jashtme.

1.12 Kur shefi i përfaqësisë largohet për periudha të shkurtra ose kur posti i tij mbetet vakant, misioni duhet të informojë për këtë Protokollin e Shtetit me anë të një note verbale, ku të tregohet data e nisjes së tij/saj dhe emri i të ngarkuarit me punë që e zëvendëson. Menjëherë pas kthimit të shefit të misionit, Protokollit i Shtetit duhet informuar përsëri për datën e rimarrjes së funksioneve të tij.

## 2. Paraqitja e kredencialeve Presidentit të Republikës

2.1 Protokollit i Shtetit njofton ambasadën përkatëse për datën, orën dhe vendin e paraqitjes së kredencialeve Presidentit të Republikës nga ana e ambasadorit të ri.

2.2 Ditën dhe orën e caktuar në vendin ku është akomoduar ambasadori (jo në selinë e tij) paraqitet makina ceremoniale, në të cilën vendoset flamuri kombëtar shqiptar dhe ai i shtetit të huaj. Nën eskortën e dy motoçikletave ceremoniale, ajo drejtohet për në Pallatin e Brigadave. Diplomatët që shoqërojnë ambasadorin zënë vend në makinën e dytë të përfaqësisë, e cila ndjek makinën ceremoniale.

2.3 Makinat ndalojnë në hyrjen kryesore të Pallatit të Brigadave dhe me daljen e ambasadorit nga makina ceremoniale, komandanti i trupprojës së nderit (9+9) jep komandën për nder armë.

Ambasadori i ri përshëndet me një tundje të lehtë të kokës rojën e nderit dhe ngjitet shkallëve, në krye të të cilave e pret Drejtori i Protokollit të Shtetit ose zëvendësi.

2.4 Ai e shoqëron ambasadorin në një dhomë pritjeje të veçantë, ku ambasadori firmos Librin e Miqve dhe qëndrojnë për disa çaste për një bisedë të shkurtër. Më pas Drejtori i Protokollit e drejton atë në sallën kryesore të ceremonisë.

2.5 Në ceremoninë e paraqitjes së kredencialeve marrin pjesë gjithashtu zëvendësministri i Punëve të Jashtme (ose Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme), këshilltari diplomatik i Presidentit, Drejtori i Protokollit të Shtetit, si dhe diplomatët që shoqërojnë ambasadorin.

2.6 Ambasadori drejtohet në sallën e ceremonisë dhe ndalon 2,5 m larg Presidentit të Republikës, i cili ndodhet aty që më parë. Shoqëruesit e Presidentit qëndrojnë një hap prapa dhe vendosen sipas kësaj skeme: në të djathtë zëvendësministri i Punëve të Jashtme dhe në të majtë këshilltari diplomatik. Po kështu qëndrojnë edhe shoqëruesit e ambasadorit. Nëse është e nevojshme prania e përkthyesve, ata qëndrojnë në të majtë, pas personalitetit që përkthej në.

2.7 I pari përshëndet shkurtimisht ambasadori. Presidenti i kthen përshëndetjen. Pas shkëmbimit të përshëndetjeve, ambasadori bën dy hapa dhe i dorëzon Presidentit të Republikës kredencialet dhe letërthirrjen e paraardhësit (nëse ai nuk e ka dorëzuar vetë më parë). Presidenti i merr dhe ia kalon dokumentet Drejtorit të Protokollit të Shtetit, shtrëngon dorën me ambasadorin e ri dhe i prezanton shoqëruesit e tij. Ambasadori nga ana e tij i prezanton Presidentit të Republikës diplomatët që e shoqërojnë.

2.8 Pas kësaj Presidenti i Republikës i fton të gjithë të pranishmit të ulen dhe zhvillojnë një bisedë që zgjat 15-20 minuta. Në mbarim të këtij intervali, i pari ngrihet Presidenti i Republikës dhe e shoqëron ambasadorin deri në fund të sallës së ceremonisë, ku edhe ndahet prej tij duke i shtrënguar dorën. Drejtori i Protokollit të Shtetit e shoqëron ambasadorin deri te makina ceremoniale, ku edhe ndahet prej tij. Truproja e nderit merr përsëri qëndrimin për nder armë.

2.9 Ambasadori hipën në makinën ceremoniale i shoqëruar nga zyrtari përkatës i protokollit, kurse diplomatët në makinën e dytë dhe të shoqëruar nga dy motoçikletat e policisë kthehen në vendin nga ku u nisën.

2.10 Mbas ceremonisë, ambasadori konsiderohet përfaqësues zyrtar i shtetit të tij. Ai zë vendin që i takon në listën diplomatike sipas ditës dhe orës së paraqitjes së kredencialeve.

2.11 Ceremonia ndiqet nga fotografi e kameramani zyrtar, të cilët ndërhyjnë në çastin e dorëzimit të kredencialeve, përshëndetjeve dhe shtrëngimit të duarve. Presidenti i Republikës i dërgon ambasadorit, brenda muajit, 2-3 foto të ceremonisë, me firmën e tij.

### 3. Takimet zyrtare të shefit të misionit

3.1 Pas paraqitjes së kredencialeve, ambasadori i ri njofton dekanin e trupit diplomatik dhe të gjitha përfaqësitë e huaja për datën e paraqitjes së kredencialeve dhe fillimin e kryerjes së funksioneve të tij.

3.2 Bën kërkesë zyrtare për takim me Kryetarin e Kuvendit, Kryeministrin, anëtarët e Këshillit të Ministrave dhe Kryetarin e Bashkisë së Tiranës. Asnjë nga personalitetet e larta të mësipërme nuk e viziton me këtë rast ambasadorin e ri në selinë e tij.

3.3 Bashkëshortja e ambasadorit të ri, nga ana e saj, i kërkon një takim bashkëshortes së Ministrit të Jashtëm dhe të Presidentit ose, në mungesë të saj, bashkëshortes së Kryeministrit. Bashkëshortja e Presidentit (ose në mungesë e Kryeministrit), në disa raste brenda vitit, i thërret për takim kortezie në grupe nga dy ose tre bashkëshortet e ambasadorëve të rinj.

### 4. Fillimi i detyrës së diplomatit, atasheut ushtarak, konsullit dhe funksionarit të organizatave ndërkombëtare

4.1 Fillimi i detyrës së një diplomati njoftohet nga përfaqësia përkatëse me anë të një nate verbale

drejtuar zyrës së Protokollit të Shtetit, në të cilën shënohet pozicioni që zë diplomati i sapoardhur, personin që zëvendëson apo nëse është pozicion i ri. Notës verbale i bashkëlidhet formulari ID-2002 në 2 kopje, me firmën e titullarit dhe vulën e misionit.

4.2 Akreditimi i atasheut ushtarak ndjek të njëjtën procedurë për sa i përket kërkesës së agreementit, ndërsa konsultimet protokollare bëhen me strukturat përkatëse të Ministrisë së Mbrojtjes. Njoftimi për pranimin mund të bëhet vetëm pas daljes së miratimit në përfundim të këtyre konsultimeve.

4.3 Njoftimi për ardhjen e atasheut ushtarak bëhet nga misioni përpara mbërritjes me anë të një nate verbale, ku të specifikohet emri i plotë, kualifikimi i saktë, personi që zëvendësohet dhe CV -ja e tij. I interesuari duhet të presë miratimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme para se të fillojë të ushtrojë funksionet e tij.

4.4 Njoftimi për fillimin e funksionit të shefit të konsullatës bëhet me anë të një nate verbale drejtuar Protokollit të Shtetit dhe Drejtorisë Konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme, ku specifikohet territori, vendndodhja dhe adresa e qytetit ku do të ushtrojë funksionet posti konsullor.

4.5 Konsujt e nderit, të cilët janë shtetas shqiptarë ose me dyshtetësi, kanë një status specifik. Ata e kryejnë mbi baza vullnetare misionin e tyre diplomatik dhe ndërkohë janë të lejuar të vazhdojnë të kryejnë aktivitetin e tyre privat.

4.6 Propozimi për konsull nderi duhet bërë nëpërmjet një kërkesë zyrtare të ardhur nga përfaqësia diplomatike e akredituar në Shqipëri ose drejtpërdrejt nga Ministria e Punëve të Jashtme e vendit që e kërkon dhe duhet miratuar nga autoritetet shqiptare kompetente.

4.7 Përjashtohen nga mundësia për të qenë konsull nderi:

- personat me shtetësi shqiptare që janë të zgjedhur në o rganet përfaqësuese;
  - personat që punojnë në institucionet shtetërore, me funksione të papajtueshme në bazë të ligjit me këtë detyrë;
  - personat që ushtrojnë profesionin e gjykatësit apo të prokurorit dhe të shërbimeve sekrete.
- 4.8 Organizatat ndërkombëtare duhet të bëjnë të njohur funksionarët e tyre të kategorisë së parë në të njëjtën mënyrë, si edhe misionet diplomatike, duke plotësuar të njëjtat procedura.

## 5. Lidhjet me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe institucionet qendrore

5.1 Përfaqësitë diplomatike mbajnë lidhje me administratën shtetërore shqiptare nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme. Për takimet që dëshirojnë të kryejnë me administratën shtetërore dhe që kanë të bëjnë me marrëdhëniet dypalëshe ose probleme me interes të përbashkët, duhet që paraprakisht të vënë në dijeni Protokollin e Shtetit dhe drejtorinë përkatëse në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

5.2 Diplomatët, specialistët dhe ekspertët e huaj mund të komunikojnë drejtpërdrejt me homologët e tyre shqiptarë në administratën shtetërore, kur bëhet fjalë për marrëdhënie shoqërore, kortezie ose probleme të veçanta midis ekspertësh.

5.3 Postet konsullore, që kanë njoftuar me shkrim Ministrinë e Punëve të Jashtme mbi juridiksionin e veprimtarisë së tyre konsullore, mund të komunikojnë drejtpërdrejt me autoritetet vendore, brenda të cilave shtrihet veprimtaria e tyre konsullore.

5.4 Përfaqësitë diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë, për pritjet zyrtare me rastin e festës kombëtare dhe për çdo veprimtari tjetër festive, politike, shkencore e sociale që organizojnë, ftesat drejtuar Presidentit të Republikës, Kryeministrit, Ministrit të Punëve të Jashtme duhet t'i

dorëzojnë pranë Protokollit të Shtetit. Është ky institucion që përgjigjet për shpërndarjen e tyre në destinacion. Protokollit i Shtetit sugjeron nivelin e përfaqësimit. Anëtarët e Këshillit të Ministrave si rregull nuk marrin pjesë në pritje pa njoftimin e Protokollit të Shtetit.

## 6. Hapja e një përfaqësie të re diplomatike

6.1 Zyrtari i huaj që vjen në Shqipëri për të hapur një përfaqësi diplomatike mund të jetë diplomat i saj ose një diplomat tjetër i ngarkuar me këtë detyrë. Me të mbërritur, ai merr takim në Ministrinë e Punëve të Jashtme me drejtorinë përkatëse dhe Protokollin e Shtetit, të cilët i informon për qëllimin e misionit të tij.

6.2 Diplomati duhet të jetë i pajisur nga Ministria e tij e Punëve të Jashtme me letrën përkatëse drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë, ku shënohet misioni i ngarkuar. Dorëzimi i saj bëhet në Protokollin e Shtetit.

6.3 Për hapjen e përfaqësisë së re diplomatike, diplomati mund të kërkojë ndihmën e Drejtorisë së Shërbimit Diplomatik në Ministrinë e Punëve të Jashtme, e cila i jep atij rekomandimet përkatëse. Diplomati mund t'i drejtohet për ndihmë edhe komunitetit të huaj diplomatik në Tiranë. Për veprimet që kryen në kërkim të vendit dhe ndërtesës, ai është i lirë të veprojë sipas dëshirës.

## 7. Ndihma për diplomatët

7.1 Protokollit i Shtetit ndihmon trupin diplomatik për çështje të ndryshme. Brenda kuadrit të lejuar, ai ndihmon diplomatët dhe familjet e tyre nga dita e ardhjes deri në ditën e largimit të tyre.

7.2 Zyra përkatëse e protokollit i informon diplomatët për vendet më të përshtatshme për banim, për pazar, mësimin e gjuhës, udhëtimet, aktivitetet artistike, shërbimin shëndetësor, shkollat për arsimimin e fëmijëve dhe rekomandime të tjera sipas kërkesës së tyre.

7.3 Protokollit i Shtetit shërben si mbështetje për çështje që përfaqësitë e huaja kanë me institucionet e tjera shqiptare, shtetërore ose private dhe me individë të veçantë.

## 8. Pjesëmarrja në ceremonitë zyrtare

8.1 Shefi i përfaqësisë njoftohet që në fillim të ardhjes së tij me një notë verbale, ku pasqyrohen festat zyrtare shqiptare dhe orari i punës së zyrave të administratës publike.

8.2 Zakonisht trupi diplomatik ftohet të marrë pjesë në këto ceremoni kryesore zyrtare:

- Hapja e sesionit të Kuvendit.
- Seanca e Kuvendit, ku kreu i Këshillit të Ministrave parashton programin e saj.
- Seanca e Kuvendit, ku bëhet votimi për zgjedhjen e Presidentit të Republikës.
- Ceremonia që zhvillohet me rastin e ndërrimit të mandatit të presidentëve.
- Dita e Dëshmorëve.
- Dita e Pavarësisë Kombëtare.
- Ceremonia në Pallatin e Brigadave, me rastin e Festës Kombëtare.
- Parada ushtarake.
- Ceremonia në Pallatin e Brigadave, me rastin e Vitit të Ri.
- Në aktivitetet vjetore që planifikon Ministria e Punëve të Jashtme.
- Në funeralet shtetërore.



## 9. Përfundimi i detyrës dhe largimi i shefit të misionit

9.1 Kur shefi i një përfaqësie largohet përfundimisht nga Republika e Shqipërisë, ai njofton paraprakisht me notë verbale Ministrinë e Punëve të Jashtme për largimin e tij, si dhe për emrin e diplomatit që do ta zëvendësojë në drejtimin e misionit si i ngarkuar me punë ai.

9.2 Protokollit i Shtetit i jep atij ndihmën e duhur për të realizuar takimet e lamtumirës me Presidentin e Republikës, Kryeministrin, Ministrin e Punëve të Jashtme (ose zëvendësministrin) dhe personalitete të tjera që ai shpreh dëshirën për t'i takuar.

9.3 Nëse shefi i përfaqësisë që largohet disponon letërthirrjen e tij në atdhe, atëherë i dorëzon kopjen e saj Drejtorit të Protokollit të Shtetit, ndërsa origjinalet, Presidentit të Republikës.

9.4 Takimin e fundit shefi i përfaqësisë e bën me Ministrin e Punëve të Jashtme (ose zëvendësministrin), i cili jep një drekë ose darkë të ngushtë për nder të largimit të ambasadorit dhe një dhuratë simbolike. Në drekë ata mund të shoqërohen nga bashkëshortët e tyre.

9.5 Ditën e largimit, shefi i përfaqësisë përcillet në aeroport nga Drejtori i Protokollit të Shtetit ose zëvendësi. Në dispozicion të tij vihet salla VIP e aeroportit. Në çdo rast largimi me mjet tjetër, ai nuk përcillet nga autoritetet e mësipërme.

## 10. Imuniteti diplomatik

10.1 Imuniteti diplomatik përfaqëson një tërësi të drejtash që gëzohen nga misionet diplomatike dhe anëtarët e tyre për kryerjen e detyrës zyrtare të mbrojtur nga çdo ndërhyrje, presion dhe që krijojnë një klimë marrëdhëniesh të lira dhe respekti midis shteteve.

10.2 Imuniteti diplomatik është rezultat i respektimit të së drejtës ndërkombëtare. Republika e Shqipërisë njeh dhe respekton veprimin e saj, por njëkohësisht edhe faktin se kjo e drejtë nuk i përjashton personat që gëzojnë imunitet nga respektimi i rregullave dhe ligjeve të shtetit shqiptar.

10.3 Imuniteti dhe paprekshmëria diplomatike shtrihet mbi përfaqësitë e huaja, rezidencat private, diplomatët, aktivitetin e plotë të tyre, korrespondencën, arkivat dokumentore dhe çdo lloj pronësie tjetër që gëzojnë për shkak të detyrës dhe në emër të shtetit dërgues.

10.4 Imuniteti ndryshon në varësi me statusin e punonjësit diplomatik. Imunitet të plotë gëzojnë vetëm bartësit e kartës diplomatike të qëndrimit. Për ata që janë shtetas shqiptarë ose kanë dyshtetësi, të huaj dhe shqiptarë, apo që kanë leje qëndrimi të përhershme, imuniteti shtrihet vetëm në fushën e ushtrimit të detyrës specifike që iu është ngarkuar, por jo në të gjithë aktivitetin dhe aspektet e tjera të punës dhe jetës së tyre.

10.5 Çdo çështje konkrete që lind në një përfaqësi të caktuar apo nga një diplomat i duhet relatuar me shkrim Protokollit të Shtetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

10.6 Ministria e Punëve të Jashtme, në çdo kohë që e quan të arsyeshme dhe të nevojshme kur cenohet integriteti, rendi, siguria, marrëdhëniet dy ose shumëpalëshe, pas konsultimit me organet kompetente, mund të shpallë një diplomat të huaj të "pa dëshirueshëm" (persona non grata) në territorin shqiptar. Ky vendim është njëkohësisht i detyrueshëm për shtetin që e ka dërguar, përmban detyrimin që ta tërheqë personin e pa dëshiruar dhe të sigurohet që e ka lënë territorin shqiptar brenda kohës së caktuar.

10.7 Një diplomat mund të shpallet "persona non grata" edhe përpara mbërritjes së tij në territorin shqiptar. Kjo është e realizueshme vetëm në rastet kur autoritetet shqiptare e konsiderojnë

akreditimin ose praninë e tij në Shqipëri si të papranueshme.

## 11. Vdekja e një diplomati

11.1 Sapo Ministria e Punëve të Jashtme vihet në dijeni nga përfaqësia diplomatike për vdekjen e shefit të përfaqësisë ose të ndonjë diplomati tjetër ofron ndihmën dhe bashkëpunimin e saj në formë asistence dhe orientimi.

11.2 Drejtoria përkatëse përgatit një letër ngushëllimi që Ministri i Punëve të Jashtme do t'i dërgojë të vesë së ambasadorit të ndjerë dhe telegramin e ngushëllimit që do t'i dërgohet Ministrisë të Punëve të Jashtme të shtetit të të ndjerit.

11.3 Njoftohet dekani i trupit diplomatik për vdekjen e diplomatit dhe i krijohen kushte që ai të njoftojë sa më shpejt të jetë e mundur tërë komunitetin diplomatik.

11.4 Drejtori i Protokollit të Shtetit (ose zëvendësi), i ngarkuari me punë a.i. i përfaqësisë së të ndjerit dhe dekani i trupit diplomatik përcaktojnë ceremoninë funebre që do të bëhet për të nderuar të ndjerin.

11.5 Në rastin e vdekjes së një diplomati shqiptar në detyrë, arkivoli i tij pritët në aeroport nga Protokollit i Shtetit dhe përfaqësues të tjerë të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Funerali nisët nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe shpenzimet e tij përballohen nga institucioni.

11.6 Nëse diplomati i ndjerë është i rangut ambasador, homazhet kryen në hollin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe prej këtej bëhet nisja për në varreza.

## 12. Flamuri kombëtar në përfaqësitë diplomatike

12.1 Përfaqësitë e huaja diplomatike të akredituara në Shqipëri mund të mbajnë të shpalosur në ndërtesën ose territorin e selisë flamurin e tyre kombëtar.

12.2 Ato duhet të ngrenë flamurin kombëtar shqiptar krahas flamurit të tyre vetëm në rastin kur atje shkon për vizitë Presidenti i Republikës së Shqipërisë. Flamuri mbetet i ngritur deri në largimin e kreut të shtetit. Shefi i përfaqësisë e pret Presidentin në hyrje, i prezanton personelin e rreshtuar për këtë rast dhe e përcjell më pas deri në dalje.

12.3 Përfaqësitë diplomatike shqiptare në vendet e huaja e ngrenë flamurin e shtetit pritës nëse përfaqësia vizitohet nga kreu i shtetit të vendit pritës.

12.4 Në sallën kryesore ceremoniale të përfaqësisë diplomatike shqiptare mund të vihet krahas flamurit shqiptar, në zbatim të reciprocitetit, edhe flamuri i vendit pritës. Në ambientet e tjera të përfaqësisë ngrihet vetëm flamuri shqiptar dhe vendoset vetëm stema e shtetit shqiptar. Flamuri shqiptar qëndron i ngritur vazhdimisht në mjediset e jashtme të përfaqësisë.

## KAPITULLI III

### SIMBOLET E REPUBLIKËS

Simbolet kryesore përfaqësuese të Republikës së Shqipërisë janë flamuri kombëtar dhe himni kombëtar, ndërsa stema e Republikës është simbol i shtetit. Përdorimi i simboleve në Shqipëri rregullohet me anë të ligjit nr.8926, datë 22.7.2002 "Për formën dhe përmasat e flamurit kombëtar, përmbajtjen e himnit kombëtar, formën dhe përmasat e stemës së Republikës të Shqipërisë dhe mënyrën e përdorimit të tyre" .

Simbole kombëtare mund të konsiderohen gjithashtu edhe vlera unike gjeografike, historike e sociale që dallojnë Shqipërinë nga vendet e tjera, si vende të veçanta natyrore, kështjellat, zbulimet arkeologjike, varrezat e dëshmorëve, lapidarët e rëndësishëm, monumentet e betejave më të mëdha historike etj. Kjo vendoset në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

## 1. Flamuri kombëtar

1.1 Shpalosja e flamurit kombëtar është një e drejtë e përgjithshme në Republikën e Shqipërisë. Dimensionet e tij janë orientative dhe shprehen të fiksuara në raportin 1: 1,4. Kur flamuri shpaloset në lartësi mbi 10m nga toka, rekomandohen përmasa jo më tepër se 350cm x 490cm. Për rastet kur shpaloset në ballkon ose deri në 10m lartësi, sugjerohet përmasa 200cm x 280cm. Në mjediset të brendshme (salla, zyra) rekomandohen përmasa 1.07 x 1.50 ose 150cm x 210cm në një shtizë 2.5m të gjatë, në varësi nga hapësira e mjedisit. Flamuri i tavolinës duhet të ketë përmasat 16 x 23cm.

1.2 Në mjediset e jashtme flamuri kombëtar qëndron i ngritur mbi institucionet dhe ndërtesa të tjera qeveritare 24 orë në ditë dhe i ndriçuar drejtpërdrejt gjatë natës. Përjashtim bëjnë rastet e festave të ndryshme kur flamuri ngrihet edhe në vende të tjera me autorizimin e Kryeministrit, për evenimente kombëtare ose të prefektit, për evenimente vendore.

1.3 Ngritja e flamurit bëhet me respektin dhe solemnitetin më të madh. Në vende të caktuara si reparte ushtarake, flamuri shpaloset nga lindja e diellit deri në perëndim. Në këto raste, ulja dhe ngritja bëhet sipas rregullores ushtarake përkatëse. Ditët e festave zyrtare është e detyrueshme ngritja e flamurit.

1.4 Kur flamuri shqiptar shpaloset së bashku me ndonjë flamur tjetër, qëndron gjithmonë në vendin e nderit, në të djathtë. Flamuri tjetër ose të tjerët vendosen në të majtë të tij, me të njëjtat përmasa dhe lartësi shtizë.

1.5 Në rastet kur flamuri shqiptar vendoset në qendër, shtiza e tij duhet të jetë më e lartë se të tjerat. Në të gjitha rastet, flamuri shqiptar ngrihet i pari dhe ulet i fundit.

1.6 Nëse në ndërtesa të ndryshme flamuri kombëtar shqiptar shpaloset bashkë me flamurë të tjerë institucionesh qendrore apo vendore, ai duhet vendosur në pikën më të lartë ose me shtizën më të lartë. Asnjë flamur tjetër nuk duhet të vendoset më lart se flamuri kombëtar shqiptar ose në të djathtë të tij.

1.7 Në takime ndërkombëtare shumëpalëshe flamurët e vendeve të huaja vendosen në të majtë të flamurit shqiptar dhe radha e tyre përcaktohet sipas rendit alfabetik.

1.8 Nëse vendosen dy ose më shumë flamurë në të njëjtën shtizë, flamuri shqiptar duhet të qëndrojë në krye ose më lart se të tjerët.

1.9 Flamuri shqiptar mund të ngrihet edhe nga personat privatë, në ndërtesat dhe objektet që kanë në pronësi. Shtetasit shqiptarë nuk mund të ngrenë flamur tjetër pa ngritur më parë flamurin shqiptar në vendin kryesor të objekteve të tyre.

1.10 Kur flamuri vendoset mbi rrugë ose në pozicione të tjera pa shtizën përkatëse, duhet të jetë kurdoherë me shqiponjën vertikalisht.

1.11 Gjatë ceremonisë së uljes ose ngritjes së flamurit, apo parakalimit të tij në revistë, të gjithë njerëzit prezent janë të detyruar të heqin kapelet dhe të marrin drejtqëndrim duke ndjekur me shikim lëvizjen e flamurit.

1.12 Ushtarakët nderojnë ushtarakisht të drejtuar nga flamuri. Kur flamuri nuk duket, drejtqëndrimi mbahet nga banda. Të huajt prezent marrin drejtqëndrim. Kjo ceremoni nuk zbatohet

vetëm në rastet kur transmetohet në TV ose në radio.

1.13 Në zyrat publike. Flamuri kombëtar mund të vendoset në mjediset e brendshme të zyrave publike, të administratës qendrore, në universitete, në selitë e partive politike dhe të organizatave të ndryshme, në institucione shkencore e kulturore, në objekte të kultit etj. Në këto raste, flamuri qëndron në të djathtë të vendit kryesor (tavolinës së punës).

1.14 Edhe persona privatë mund ta mbajnë flamurin kombëtar në zyra, studio, ente, shoqata e përfaqësi, me kusht që të respektojnë rregullat e vendosjes dhe të dekorit. Çdo flamur tjetër dallues, vendor ose institucional, qëndron në të majtë të tavolinës.

1.15 Vendosja në zyrat publike e një ose më shumë flamurëve të huaj krahas flamurit shqiptar bëhet vetëm në rastet e ceremonive zyrtare ose takimeve dy dhe shumëpalëshe me delegacione të huaja të nivelit ministër dhe në raste kur nënshkruhen marrëveshje zyrtare.

1.16 Në raste të aktiviteteve jozyrtare, si konferenca shoqërore e shkencore, manifestime e protesta publike dhe mbledhje të ndryshme administrative nuk rekomandohet vendosja e flamurit kombëtar dhe as e flamurëve të huaj. Bëjnë përjashtim ceremonitë e dekorimeve.

1.17 Kur flamuri vendoset pranë një foltoreje, duhet të qëndrojë lart, pas vendit të folësit, ose kur është në shtizë, në të djathtë të tij. Flamurët e tjerë vendosen në të majtë të folësit.

1.18 Në zyrat e administratës publike, duke filluar nga niveli drejtor drejtorie deri te titullarët e dikastereve dhe në përfaqësitë diplomatike shqiptare jashtë shtetit është e detyrueshme të vendoset portreti i Presidentit të Republikës.

1.19 Në ditë zije të miratuar, flamurit kombëtar i lidhet në pjesën e sipërme të shtizës një fjongo e zezë, e cila qëndron e varur përgjatë saj. Në rast zije për shkak të detyrës, flamurit i lidhet një fjongo kuq e zi.

1.20 Me vendim të Këshillit të Ministrave, flamuri vendoset në gjysmështizë me rastin e vdekjes së figurave qendrore të Shqipërisë. Kjo mund të bëhet edhe për personalitete të huaja të spikatura ose me lidhje të veçanta me Shqipërinë, por gjithmonë sipas vendimit të mësipërm.

1.21 Kur flamuri vendoset në gjysmështizë, ai ngrihet deri në majë, qëndron pak çaste dhe pastaj zbritet në pozicionin gjysmështizë. Nëse në përfundim të diellit flamuri do të ulet, atëherë ai çohet përsëri deri në majë të shtizës dhe pastaj ulet.

1.22 Në ceremoni funebre ushtarake, flamuri përdoret për të mbuluar arkivolin. Ai vendoset në pozicionin që shqiponja të bjerë në gjoksin e të ndjerit. Në asnjë mënyrë nuk lejohet që flamuri të futet në varr apo të takojë tokën gjatë ceremonisë.

1.23 Flamuri i mbajtur në dorë nga trupat ushtarake nuk vendoset asnjëherë në gjysmështizë. 1.24 Flamurë dallues. Për të vënë në evidencë një rang të lartë të hierarkisë shtetërore ose ushtarake, i cili ka të drejtën e drejtimit të shtetit ose të komandës ushtarake, përdoren flamurë dallues. Këta flamurë vendosen në selitë dhe mjetet e transportit të tyre.

1.25 Flamurë dallues kanë të drejtë të kenë:

- Presidenti i Republikës,
- Kryeministri,
- Ministri i Punëve të Jashtme,
- Ministri i Mbrojtjes,
- Ministri i Rendit Publik,
- Shtabi i Përgjithshëm, komandat e armëve të Forcave të Armatosura, Policia e Shtetit dhe Garda e Republikës.

1.26 Flamuri dallues i autoritetit më të lartë përfshin në vetvete të gjithë të tjerët. Në këtë kontekst,

flamuri i Presidentit të Republikës është flamuri i parë dhe ka vlerë të përgjithshme, meqenëse rangu i tij përmbledh edhe komandën e përgjithshme të Forcave të Armatosura.

1.27 Flamurët dallues të armëve dhe të autoriteteve që kanë në varësi trupa ushtarake të Ministrisë së Mbrojtjes kanë në fundin e tyre një shirit me ngjyrë tjetër.

1.28 Persona zyrtarë të përfaqësive diplomatike që lejohen të mbajnë flamurin të fiksuar në zyrë, ndërtesë banimi dhe makinën e tyre janë ambasadorët e jashtëzakonshëm e fuqiptotë, shefa të misioneve, shefa postesh konsullorë, konsuj nderi.

1.29 **Qytete, njësi vendore të nivelit të parë, institucione të ndryshme, gjysmë shtetërore, private, shoqata të ndryshme e fondacione mund të kenë stemat dhe flamurët e tyre të veçantë. Këto shenja duhet të shprehin qartë karakterin e atyre që i mbajnë, të jenë të studiuara me kujdes, të kontrolluara dhe të miratuara nga Protokollit i Shtetit në emër të Këshillit të Ministrave.**

1.30 Kryetarët e bashkive dhe të komunave të Republikës në ushtrimin e detyrës së tyre vendosin **shenjën dalluese të brezit kuq e zi**. Ky brez mbahet në ceremonitë zyrtare, pritjen e autoriteteve të larta, manifestimet e popullit në sheshin e qytetit, mbledhjet e këshillit ose të punës, festa, dasma, funerale dhe ngjarje të tjera publike. Brezi kuq e zi vishet krahaqafë në shpatullën e djathtë. Në pjesën e sipërme kapen stema e Republikës dhe më poshtë stema e njësisë vendore.

1.31 Ngritja e flamurit dallues apo vendosja e shenjave të tjera të këtij karakteri bëhet vetëm në zyrat, selitë, ndërtesat dhe territoret e përcaktuara ku shtrihet ndikimi i këtyre enteve dhe kurdoherë krahas flamurit kombëtar.

1.32 Radha e përparësisë së vendosjes së flamurëve shqiptarë është si më poshtë:

- flamuri kombëtar luftarak me medaljet e nderit;
- flamuri kombëtar;
- flamuri i njësisë vendore (sipas radhës së tyre);
- flamurët dallues të institucioneve;
- flamurët dallues të shoqatave, fondacioneve dhe institucioneve të pavarura.

## 2. Himni kombëtar

2.1 Himni kombëtar shqiptar titullohet "Rreth flamurit të përbashkuar" dhe ekzekutohet kurdoherë në prezencën e flamurit kombëtar. Çdo shqiptar ka të drejtë të këndojë himnin kombëtar.

2.2 Himni kombëtar ekzekutohet në ceremonitë zyrtare dhe në raste të tjera të parashikuara nga rregulloret përkatëse ushtarake. Zyrtarisht interpretohet vetëm strofa e parë dhe refreni. Himni nuk ekzekutohet asnjëherë në mjedise publike pa prezencën e flamurit kombëtar. Përfshihen rastet kur ekzekutohet në televizion ose në radio.

2.3 Vizita zyrtare e një presidenti ose kryeministri të huaj shoqërohet me ekzekutimin e himneve kombëtare të të dy vendeve. Himni shqiptar interpretohet pas himnit mik.

2.4 Gjatë ekzekutimit të himnit kombëtar repartet ushtarake mbajnë drejtqëndrim ose sipas rastit për nder armë. Ushtarakët e veçantë nderojnë ushtarakisht të drejtuar nga flamuri, kurse autoritetet civile dhe të gjithë sa janë prezent ngrihen në këmbë dhe mbajnë drejtqëndrim. Nuk është e ndaluar që gjatë gjithë kohës së interpretimit të vendoset dora e djathtë në zemër, si shenjë e një nderimi më të veçantë për himnin dhe flamurin.

2.5 Nëse ndodh të ekzekutohen më shumë se dy himne, radha e tyre përcaktohet nga përparësia e

caktuar që më parë e vendeve pjesëmarrëse në takim. Zakonisht radha caktohet sipas rendit alfabetik të shteteve pjesëmarrëse, por mund të përcaktohen edhe kritere të tjera. Himni shqiptar interpretohet i fundit për arsye mikpritjeje.

### 3. Stema e Republikës

3.1 Përdorimi stemës së Republikës është e drejtë ekskluzive e organeve shtetërore.

Dimensionet e stemës së Republikës janë orientative dhe shprehen në raportin 1: 1,5.

#### 3.2 Stema e Republikës vendoset:

- në hyrje të institucioneve shtetërore, së bashku me emërtesën e tyre;
- në të gjitha aktet zyrtare;
- në vulat e institucioneve shtetërore;
- si shenjë dalluese e objekteve të shtetit;
- në dokumentet dhe marrëveshjet e shtetit shqiptar me shtetet e huaja, në bazë të reciprocitetit.

3.3 Zyrtarisht njihen edhe stemat e niveleve të ndryshme të pushtetit vendor, të enteve publike, shenjat dalluese të armëve të ndryshme të ushtrisë, të policisë dhe të universiteteve të miratuara nga Protokollin i Shtetit në emër të Këshillit të Ministrave.

3.4 Stema dhe tituj privatë. Ato përdoren nga organe shkencore e kulturore të pavarura për të treguar individualitetin e tyre, ndërmarrjet ekonomike, për t'u dalluar në treg apo për etiketat e prodhimeve të tyre, shoqatat nga fondacionet shoqërore të çdo lloji, për të dalluar specifikat e punës së tyre apo objektet e artit dhe lokalet e ndryshme për të specifikuar veçantitë që kanë.

3.5 Radha e përparësisë së stemave private përcaktohet nga vjetërsia e ekzistencës së entit. Ashtu si dhe flamuri, edhe stemat individuale vendosen vetëm në territorin e entit dhe objektit që i përmban.

3.6 Vend të veçantë zënë titujt e fituar nga individët gjatë jetës, karrierës së tyre dhe për kontributin e shquar që ata kanë dhënë në sektorin social, publik dhe shkencor. Tituj të tillë si: doktor, profesor, qytetar nderi, mjeshtër i madh, etj janë të vlerësuar nga ceremoniali i shtetit.

3.7 Radha e përparësisë së titujve përcaktohet nga shkalla e titullit dhe, për tituj të barabartë, është përcaktuese data e marrjes së tyre.

## KAPITULLI IV

### CEREMONIALI ZYRTAR I AUTORITETEVE MË TË LARTA TË SHTESTIT

#### 1. Rregulla të përgjithshme

1.1 Rangjet e presidentit të Republikës, kryetarit të kuvendit, kryeministrit dhe ministrit të Punëve të Jashtme, për shkak të funksioneve që kanë, rolit që luajnë dhe detyrave që zgjidhin, dallohen në radhën e përparësisë dhe të privilegjeve ceremoniale.

1.2 Ceremonitë ku marrin pjesë këto autoritete organizohen sipas specifikave të aktivitetit nga Protokollin i Shtetit, **zyrat e protokollit të brendshëm të tyre**, institucione të ndryshme, ministri, organe vendore etj.

1.3 Përgatitja e aktivitetit bëhet paraprakisht. Organizatorët kanë për detyrë të njoftojnë Protokollin e Shtetit (kur në ceremoni marrin pjesë edhe personalitete të huaja), të paktën 1-2 javë para datës së caktuar. Ata janë të detyruar të informojnë për qëllimin, programin e plotë të aktivitetit, mënyrën

e organizimit, masat e marra, listën e të ftuarve, kohën dhe vendin e caktuar.

1.4 Personaliteti i lartë i ftuar pritet nga titullari përkatës (ministër, prefekt, kryetar bashkie) dhe zyrtarët më të lartë në rang të institucionit përkatës. Titullari pritës i uron mirëseardhjen dhe i prezanton zyrtarët që e shoqërojnë.

1.5 Nuk është e nevojshme që Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit dhe Kryeministri, si personalitetet më të larta të shtetit, të jenë të pranishëm në të njëjtin aktivitet. Kjo mund të ndodhë vetëm në raste emergjente, evenimente të rëndësishme të veçantë dhe ngjarje të shënuara, si festa kombëtare, funerale shteti, etj.

1.6 Gjatë ecjes së parashikuar në ceremonitë zyrtare apo në presidiume takimesh, vendi i personalitetit më të lartë në rang është në radhën e parë në mes të atyre që e shoqërojnë. Numri i tyre duhet të jetë tek. Në të djathtë të personalitetit qëndron shoqëruesi më i lartë në rang.

1.7 Nëse ecja bëhet drejt një tribune folëse, personaliteti i lartë shoqërohet nga tre vetë. Në momentin e mbërritjes te tribuna, shoqëruesit ndahen prej tij dhe qëndrojnë në vendet e tyre të caktuara që më parë. Vendosja në tribunë bëhet sipas prezencës zyrtare të pjesëmarrësve.

Personaliteti vjen i fundit dhe largohet i pari.

1.8 Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, Ministri i Punëve të Jashtme dhe çdo autoritet tjetër në Republikën e Shqipërisë respektojnë një ceremonial të barabartë kundrejt dinjitarëve të lartë klerikë. (Protokolli i ndjekur për dinjitarët e fesë katolike nuk ka të bëjë me protokollin e respektuar ndaj ambasadorit të shtetit të Vatikanit).

1.9 Kur konsiderohet e nevojshme ose për arsye shtetërore, personalitetet e mësipërme mund të bëjnë lëvizje preferenciale në radhën e klerikëve, duke mbajtur më pranë apo dalluar dinjitarin që lidhet me veçoritë ceremoniale të momentit. Në çdo rast tjetër, më afër qëndron kleriku më i lartë në rang në fenë respektive.

1.10 Personalitetet e mësipërme presin dhe takojnë me kërkesën e tyre individë të ndryshëm, diplomatë, zyrtarë të niveleve të ndryshme dhe njerëz të thjeshtë sipas një rregulli të përcaktuar nga vetë institucioni. Përgjithësisht, takimet nuk zgjasin më shumë se 30 minuta, me përjashtim të rasteve të njohura që më parë.

1.11 Protokolli i Shtetit vihet në dijeni paraprakisht për çdo lëvizje të tre personaliteteve kryesore jashtë shtetit. Vizitat koordinohen në mënyrë që të mos jenë të tre njëkohësisht jashtë vendit në të njëjtën kohë.

1.12 Presidenti i Republikës, Kryeministri dhe Kryetari i Kuvendit kryejnë vizita të nivelit të lartë jashtë shtetit. Protokolli i Shtetit merret me procedurat zyrtare të organizimit të vizitave, nga përgatitja deri në përfundimin e tyre. Në funksion të këtij programi bashkëpunohet me kabinetet përkatëse.

1.13 Ceremonia e pritjes së homologut të huaj bëhet në aeroport ose në selinë e personalitetit të lartë. Kjo përcaktohet paraprakisht në bisedimet e Protokollit të Shtetit me protokollin e palës së huaj. Ceremonia kryhet sipas skemave të miratuara të ceremonialit të Republikës.

## 2. Presidenti i Republikës

2.1 Presidenti i Republikës përfaqëson autoritetin më të lartë të shtetit në Shqipëri, që është shprehje e unitetit të popullit. Ushtrimi i mandatit të Tij shoqërohet gjatë gjithë periudhës nga një ceremonial i veçantë për të gjitha aspektet zyrtare dhe jozyrtare të jetës dhe aktivitetit të tij.

2.2 Bashkëshortja e Presidentit gëzon statusin e zonjës së parë të vendit. Pjesëtarët madhorë të

familjes që jetojnë me të gëzojnë një status protokollar të barabartë me këshilltar presidenti, kurse ata që nuk bashkëjetojnë me të, të barabartë me këshilltar ministri. Ky status është i vlefshëm vetëm kur marrin pjesë të ftuar në aktivitete formale, së bashku me Presidentin. Në raste të tjera, si dhe të afërmit e mitur, nuk gëzojnë status protokollar.

2.3 Në pritje të ndryshme dhe festa kombëtare të dhëna nga përfaqësitë diplomatike të akredituara në Shqipëri, Presidenti i Republikës merr pjesë vetëm në rastet kur e konsideron tepër të arsyeshme dhe të rëndësishme prezencën e tij. Pjesëmarrja e Presidentit sinjalizohet nga Protokolli i Shtetit.

### 3. Ceremonia e fillimit të detyrës së Presidentit të Republikës

3.1 Ceremonia e fillimit të detyrës së Presidentit të Republikës zhvillohet si një e tërë, e ndarë në dy momente kryesore, në sallën e Kuvendit dhe në Pallatin e Brigadave.

3.2 Ditën e caktuar në seancën e Kuvendit të Shqipërisë, përveç deputetëve, mund të marrin pjesë edhe të ftuar të tjerë të huaj dhe titullarët e përfaqësive diplomatike. Protokolli i Kuvendit drejton ceremoninë në sallën e Kuvendit.

3.3 Presidenti në detyrë me familjen e tij zë vend në lozhën nr.1, kurse në atë ngjitur vendoset familja e Presidentit të zgjedhur.

3.4 Në orën 18.00, Presidenti i Republikës mbërrin në hyrjen kryesore të Kuvendit dhe po në këtë moment del aty për ta pritur Kryetari i Kuvendit dhe, mbasi përshëndeten, hyjnë nëpërmjet sallës dhe zënë vend në podium.

3.5 Kryetari i Kuvendit fton Presidentin të ngrihet në këmbë për të bërë betimin, ndërkohë të gjithë të pranishmit janë të ulur nëpër vendet e tyre. Kryetari i Kuvendit lexon formulën e betimit, sipas kushtetutës, neni 88 pika 3. Presidenti deklaron: "Beto hem" (Presidenti mund të shtojë "Zoti më ndihmoftë").

3.6 Ekzekutohet himni kombëtar i Shqipërisë dhe të gjithë të pranishmit ngrihen në këmbë. Kryetari i Kuvendit fton Presidentin për të marrë fjalën përshëndetëse para Kuvendit. Presidenti mban fjalën.

3.7 Kryetari i Kuvendit uron Presidentin për detyrën dhe deklaron mbylljen e seancës plenare, duke kërkuar leje për të shoqëruar Presidentin deri në hyrjen kryesore. Të gjithë të pranishmit ngrihen në këmbë.

3.8 Mbas Kuvendit të Shqipërisë, ceremonia presidenciale vijon në Pallatin e Brigadave. Të ftuarit mbërrijnë në Pallatin e Brigadave deri në orën 19.15 dhe zënë vendet e caktuara për ta. Tribuna A rezervohet për miqtë e huaj dhe titullarët e përfaqësive diplomatike, kurse tribuna B, për personalitetet e larta shtetërore dhe miqtë vendas .

3.9 Në orën 19.25 mbërrin dhe zë vend në krye të shkallëve të Pallatit të Brigadave ish-Presidenti i Republikës.

3.10 Në orën 19.30 mbërrin Presidenti i Republikës, makina e të cilit shoqërohet nga truproja e nderit në katër motoçikleta ceremoniale.

3.11 Zhvillohet ceremonia e nderit sipas skemës përkatëse. Presidenti drejtohet dhe zë vend në krye të shkallëve të Pallatit të Brigadave, në të djathtë të ish-Presidentit. Në të dyja anët e shkallëve janë vendosur oficerë të Gardës së Republikës me uniforma ceremoniale.

3.12 Ekzekutohet himni kombëtar, i cili shoqërohet me 21 të shtëna topi artilerie me interval 30 sekonda nga njëra-tjetra. Gjatë gjithë kohës, flamuri kombëtar qëndron i ngritur.

3.13 Drejtori i Protokollit të Shtetit fton ish-Presidentin të bëjë përshëndetjen e rastit dhe në fund të saj, në mënyrë simbolike, i dorëzon Presidentit të ri Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.



3.14 Drejtori i Protokollit të Shtetit fton Presidentin e zgjedhur të Republikës të bëjë përshëndetjen e rastit.

3.15 Zhvillohet parakalimi tradicional i truprojës së nderit. Pas kësaj, të pranishmit ftohen në Pallatin e Brigadave për të marrë pjesë në pritjen zyrtare.

#### 4. Zonja e Parë

4.1 Bashkëshortja e Presidentit të Republikës gëzon statusin Zonja e Parë e vendit.

4.2 Në ceremonitë ku merr pjesë vetëm me Presidentin, Zonja e Parë qëndron në të djathtë të tij. Në ceremonitë e nderit ku ekzekutohen himnet kombëtare qëndron së bashku me zonjën e parë mike, tre hapa pas të dy presidentëve. Në mjedise pritjesh formale, në rastet kur ka një të ftuar nderi, Presidenti ecën i pari, së bashku me bashkëshorten e të ftuarit të nderit, ndërsa Zonja e Parë shoqëron të ftuarin e nderit dhe hyn e dyta pas Presidentit.

4.3 Zonja e Parë shoqëron Presidentin e Republikës në vizita shtetërore jashtë vendit, bën vetë vizita në cilësinë e zonjës së parë, jep pritje, organizon publikisht dhe privatisht ceremoni të ndryshme me karakter shoqëror, humanitar e patriotik, mban lidhje me zonjat e para të vendeve të tjera, por nuk mund të marrë pjesë në punët dhe takimet zyrtare të Presidentit të Republikës.

4.4 Nëse Presidenti është i pamartuar ose i ve, asnjë nga familjarët e Tij nuk mund të përfaqësojë apo të luajë rolin e zonjës së parë. Në veprimtarinë zyrtare, Presidenti i Republikës paraqitet i pashoqëruar. Në ceremonitë festive ose në kushtet kur udhëton jashtë kryeqytetit ose jashtë shtetit, Presidenti i Republikës mund të shoqërohet nga një person tjetër i familjes sipas dëshirës, por jo në rangun e zonjës së parë. Shoqëruesi i Presidentit gëzon në të gjitha rastet të drejtën e një protokollit të veçantë.

#### 5. Presidenca

5.1 Presidenca është selia e aktivitetit zyrtar të Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Në hyrjen lindore të Presidencës qëndrojnë në pozicion nderi dy truproje nderi me uniformë ceremoniale.

5.2 Para hyrjes së korridorit dhe në hyrje të zyrës së Presidentit qëndrojnë dy trup roj e nderi me uniformë ceremoniale.

5.3 Kur kalon Presidenti, të pranishmit (të ftuar ose bashkëpunëtorë) ngrihen në këmbë dhe i përgjigjen përshëndetjes së Tij. Edhe ata që kanë njohje personale me Presidentin nuk duhet ta ndalojnë ose ta përshëndesin të parët. Presidentit gjithsecili i drejtohet "Z. President". Bashkëshortes së Presidentit i drejtohet Znj. (vijon mbiemri).

5.4 Presidenti i Republikës ka të drejtë të mbajë flamur dallues si shenjë e veçantë që identifikon shkallën e hierarkisë dhe autoritetin e këtij rangu për të drejtuar e komanduar. Në zyrën e Presidentit, mbrapa poltronit të tij qëndrojnë dy flamurë, në të djathtë flamuri kombëtar dhe në të majtë flamuri dallues i Presidentit.

5.5 Protokollit i brendshëm i Presidencës drejtohet nga shefi i protokollit të Presidentit. Ai është përgjegjës për takimet e përditshme që bëhen në zyrën e Presidentit, lëvizjet dhe aktivitetet brenda territorit të Shqipërisë, në përputhje me ceremonialin zyrtar.

5.6 Në vizitat zyrtare brenda vendit, Presidenti i Republikës shoqërohet nga persona të stafit të tij, të cilët mund të jenë këshilltari përkatës, protokollit, zëdhënësi i shtypit, ndihmësi përkatës, fotografi dhe sigurimi. Në vizita zyrtare shoqërohet edhe nga Sekretari i Përgjithshëm i Presidencës, anëtarë

të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe deputetë.

5.7 Nëse është i domosdoshëm shoqërimi i Presidentit të Republikës nga anëtarë të kabinetit qeveritar, kjo kryhet vetëm pas kërkesës që Presidenca i paraqet Kabinetit të Kryeministrit.

5.8 Presidenti i Republikës jep sipas dëshirës pritje, dreka dhe darka shteti. Vendosja e të ftuarve bëhet sipas protokollit përkatës.

5.9 Rangu i Presidentit nuk është i delegueshëm. Në rastet kur Presidenti nuk merr pjesë vetë por dërgon një përfaqësues, ky i fundit nuk gëzon nderimin që do t'i bëhej vetë Presidentit. Përfaqësuesi i Presidentit radhitet në vendin që i takon sipas rangut të tij. Vetëm në rastin e ceremonisë së dekorimit, ai e merr fjalën dhe kryen procedurën e dekorimit menjëherë pas përshëndetjes së autoritetit më të lartë që është prezent në këtë ceremoni.

5.10 Kur Presidenti i Republikës bën vizitë zyrtare jashtë kryeqytetit, pritët në kufi të qarkut nga prefekti (dhe autoritete të tjera vendore), i cili e shoqëron gjatë vizitës brenda territorit që ka nën juridiksion. Kur arrijn në qytet, Presidenti i Republikës pritët nga kryetari i bashkisë. Personalitetet publike të vendit ftohen në një takim të përbashkët me kreun e shtetit. I njëjti nderim i bëhet edhe gjatë largimit. E njëjta ceremoni zhvillohet edhe kur vizitën e bën zyrtarisht një president i huaj.

5.11 Në rastin kur Presidenti i Republikës udhëton jashtë shtetit, përcillet nga sekretari i përgjithshëm, Drejtori i Kabinetit dhe Drejtori i Protokollit të Shtetit (ose zëvendësi), ambasadori i akredituar nga vendi pritës dhe ambasadorët e vendeve ku kalohet transit.

5.12 Për pritjen dhe përcjelljen e Presidentit të Republikës shtrohet tapeti i kuq në hyrje të sallës VIP të aeroportit dhe në hyrje të avionit. Gjithashtu, janë të pranishëm edhe gjashtë truproje nderi. Protokolli i Presidencës kryen të gjitha formalitetet dokumentare të nevojshme para largimit dhe për ardhjen e Tij.

## 6. Pritje në Presidencë

6.1 Në rastin e vizitës së një kryetari shteti, qeverie ose vizitor tjetër i lartë, Presidenti i Republikës e pret atë në selinë e Presidencës ose në një rezidencë tjetër qeveritare.

6.2 Nëse vizitori është kryetar shteti në vizitë zyrtare, organizohet për nder të tij ceremonia e nderit në aeroport ose në Pallatin e Brigadave, sipas skemës së miratuar.

6.3 Dy orë para mbërritjes së kreut të shtetit mik, në vendin e caktuar ngrihet flamuri i tij kombëtar në krah të majtë të flamurit shqiptar. Flamurë të të dy vendeve vendosen në sallën e takimit ose me përmasa të vogla në tavolinën e bisedimeve zyrtare.

6.4 Nëse kreu i shtetit mik nuk është në vizitë shteti (kalimtare, private, shumëpalëshe), atëherë nuk zhvillohet ceremoni nderi. Presidenti shqiptar i del përpara, e pret në fillim të shkallëve dhe e shoqëron për në brendësi të ndërtesës. Vizitori i huaj nderohet në hyrje nga truproja e nderit. Edhe përcjellja bëhet në të njëjtën mënyrë si pritja.

6.5 Në rastet kur nuk zhvillohen bisedime zyrtare, takimi bëhet në sallon ulur në poltrona. Në këto takime formati i pjesëmarrjes është jo më shumë se 1+5 vetë. Ceremonitë zyrtare drejtohen nga Protokolli i Shtetit.

6.6 Në hyrje të hollit dhe në sallën e takimit parashikohen fotografi, shtrëngim duarsh dhe regjistrim televiziv.

6.7 Kur ceremonia e nderit nuk bëhet në aeroport, por në rezidenca të tjera qeveritare, në territorin e tyre futet vetëm makina e protokollit dhe ajo e presidentit mik. Makinat e sigurimit dhe të delegacionit presin në hyrje të oborrit të selisë ose në një vend të veçantë.

6.8 Presidenti i Republikës pret miq të nivelit të lartë edhe në ambiente të tjera si në Pallatin e Brigadave, etj. Në to mund të zhvillohet e njëjta ceremoni nderi. Për homologun Presidenti shtron, sipas rastit, pritje kortezie, drekë ose darkë shteti.

6.9 Në rastet kur Presidenti i Republikës takohet me vizitorë të nivelit kryeministër, pritja bëhet në hollin e Presidencës, kurse për nivelet ministër, sekretar shteti ose autoritete të tjera me të njëjtin rang, pritja bëhet brenda në sallën e takimit.

## 7. Kryeministri

7.1 Kryeministri, si rang më i lartë i pushtetit ekzekutiv në Shqipëri, ka të drejtën e një ceremoniali të veçantë në të gjitha aspektet zyrtare dhe jozyrtare të jetës dhe aktivitetit të Tij. Kryeministrit gjithsecili i drejtohet, "Z. Kryeministër".

7.2 Bashkëshortja e Kryeministrit është personalitet publik dhe ka të drejtë të japë pritje dhe të organizojë aktivitete të ndryshme shoqërore, humanitare dhe me përfaqësues nga trupi diplomatik. Bashkëshortes së Kryeministrit gjithsecili i drejtohet Znj. (vijon mbiemri).

7.3 Në rastet kur Presidenti i Republikës është i pamartuar ose i ve, bashkëshortja e Kryeministrit fiton të gjitha privilegjet e Zonjës së Parë të vendit deri në ndryshimin e statusit familjar të Presidentit, por emërtimi i saj zyrtar nuk është Zonjë e Parë.

7.4 Bashkëshortja e Kryeministrit e shoqëron bashkëshortin në vizitat që kryen, merr pjesë, sipas dëshirës, në aktivitetet dhe ceremonitë që zhvillohen, por jo në takimet zyrtare. Gjatë këtyre ajo gëzon të drejtën e një programi të veçantë protokollar.

7.5 Fëmijët në moshë madhore të Kryeministrit, që jetojnë me të, kur marrin pjesë të ftuar në ceremoni të ndryshme formale, barazohen me rangun këshilltar i kryeministrit. Në raste të tjera ose kur janë në moshë të vogël, nuk gëzojnë status protokollar.

## 8. Betimi i qeverisë

8.1 Ceremonia e betimit të qeverisë së re zhvillohet në selinë e Presidencës së Republikës ose në Pallatin e Brigadave. Në të marrin pjesë gjithashtu të ftuar nga institucionet kryesore të shtetit, përfaqësues të klerit, dekani i trupit diplomatik, përfaqësues të shquar të shkencës, artit dhe kulturës etj. Listën e të ftuarve e përpilon zyra e Presidentit në përputhje me pre seancën e Republikës.

8.2 Qeveria e kryesuar nga Kryeministri ulet në vendin e caktuar sipas renditjes në listën qeveritare. Ceremoninë e hap Sekretari i Përgjithshëm i Presidencës. Hyn Presidenti i Republikës dhe zë vendin e caktuar pranë flamurit. Të gjithë të pranishmit ngrihen në këmbë. Fillon himni kombëtar.

8.3 Sekretari i Përgjithshëm lexon formulën e betimit. Kryeministri afrohet në vendin e caktuar, vë dorën mbi Kushtetutën e Republikës dhe thotë me zë të lartë "Betohem". Pastaj ulet dhe firmos dokumentin e betimit, shtrëngon dorën me Presidentin e Republikës dhe kthehet në vendin e tij. Të njëjtën procedurë e përsërisin të gjithë anëtarët e qeverisë sipas radhës.

8.4 Në mbarim të betimit, Sekretari i Përgjithshëm fton të pranishmit të ulen dhe i jep fjalën Presidentit të Republikës, i cili përshëndet qeverinë e re. Në mbarim të fjalës festohet me shampanjë. Të parët trokasin gotat Presidenti dhe Kryeministri.

8.5 Rreth 20-30 minuta më vonë, Presidenti fton Kryeministrin dhe anëtarët e tjerë të qeverisë për

një fotografi të përbashkët. Më pas, të dy tërhiqen në zyrën e Presidentit. Të pranishmit fillojnë të largohen nga mjediset e Presidencës të përcjellë nga stafi i Presidentit.

8.6 Pas betimit, qeveria e re mbledhet në selinë e Kryeministrit në takim të parë inagurativ dhe Kryeministri përshëndet çdo ministër për fillimin me sukses të detyrës.

8.7 Lista e qeverisë së re dhe CV -të e anëtarëve të saj shpërndahen në të gjitha prefekturat e vendit, përfaqësitë diplomatike shqiptare të akredituara jashtë vendit dhe përfaqësitë e huaja diplomatike të akredituara në Shqipëri.

8.8 Me rastin e fillimit të detyrës, Kryeministri jep në një nga rezidencat qeveritare një pritje për trupin diplomatik. Ftohen të gjithë shefat e përfaqësive të akredituar në Shqipëri, prefektët dhe personalitete të tjera. Lista përpilohet nga zyra e Kryeministrit, në pajtim me radhën e presecancës së Republikës. Organizimi i aktivitetit bëhet nga Protokollit i Shtetit.

## 9. Kryeministria

9.1 Në hyrjet veriore dhe perëndimore të selisë së Kryeministrit qëndrojnë dy truproja nderi me uniformë ceremoniale (të ndryshme nga të Presidencës).

9.2 Si rregull, para sallës së mbledhjeve të qeverisë dhe në hyrje të zyrës së Kryeministrit qëndrojnë dy truproje nderi me uniformë ceremoniale.

9.3 Rangu i Kryeministrit ka të drejtë të mbajë flamur dallues si shenjë e veçantë që identifikon shkallën e hierarkisë dhe autoritetin e këtij rangu për të drejtuar e komanduar. Në zyrën e Kryeministrit, mbrapa poltronës së tij qëndrojnë dy flamurë, në të djathtë flamuri kombëtar dhe në të majtë flamuri dallues i Kryeministrit.

9.4 Kryeministri merr pjesë në pritje të ndryshme që jepen nga trupi diplomatik i akredituar në Shqipëri. Kryeministri përcakton një qëndrim të vetin në këtë drejtim, por është mirë që respekti të jetë njëloj për të gjithë përfaqësitë, për të mos patur precedentë jo të kënaqshëm. Në të tilla raste, është mirë që Kryeministri, sipas momentit, të dërgojë në këto aktivitete një nga përfaqësuesit e tij kryesorë.

9.5 Protokollit i zyrës së Kryeministrit drejtohet nga Shefi i Protokollit të Kryeministrit. Ai është përgjegjës për pritjet dhe përcjelljet që bëhen në zyrën e Kryeministrit, lëvizjet dhe aktivitetet që bëhen brenda territorit të Shqipërisë, në përputhje me ceremonialin zyrtar.

9.6 Në vizitat zyrtare brenda vendit, Kryeministri shoqërohet zakonisht nga stafi i tij, drejtori i kabinetit, këshilltari përkatës, shefi i protokollit, zëdhënësi, ndihmësi përkatës, fotografi dhe sigurimi.

9.7 Pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit të Ministrave në këto vizita apo aktivitete përcaktohet nga kabineti i Kryeministrit, me miratimin e tij. Kryeministri vendos për pjesëmarrjen, numrin dhe cili konkretisht do ta shoqërojë. Nëse prania e Kryeministrit nuk është e mundur, atëherë ai cakton se cili anëtar i Këshillit të Ministrave do të marrë pjesë si përfaqësues i tij në atë aktivitet.

9.8 Rangu protokollar i Kryeministrit është i delegueshëm. Nëse Kryeministri është i ftuar në aktivitete publike të çfarëdo lloji dhe nuk merr pjesë vetë por dërgon një ministër si përfaqësues, ky i fundit gëzon nderimin që do t'i bëhej vetë Kryeministrit. Kjo nuk zbatohet për përfaqësuesit e pozicioneve të tjera qeveritare.

9.9 Kur Kryeministri udhëton jashtë shtetit, përcillet zakonisht nga sekretari i përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, këshilltarë të tij dhe shefi i protokollit të Kryeministrit. Në vizita zyrtare asistojnë Ministri i Shtetit pranë Kryeministrit, Drejtori i Protokollit të Shtetit (ose zëvendësi) dhe

ambasadori i vendit pritës ose transit.

9.10 Për pritjen dhe përcjelljen e Kryeministrit shtrohet tapeti i kuq në VIP dhe në hyrje të avionit dhe qëndrojnë katër truproja nderi. Protokolli i Kryeministrit kryen të gjitha formalitetet dokumentare të nevojshme para largimit të tij.

## 10. Pritje në Kryeministri

10.1 Në selinë e tij Kryeministri i Republikës së Shqipërisë pret dhe përcjell vizitorë sipas një programi të miratuar që më parë. Kreun e shtetit të huaj e pret dhe e përcjell deri pranë makinës, ndërsa homologun deri në hyrje të selisë. Ceremonitë zyrtare me vizitorë të huaj drejtohen nga Protokolli i Shtetit.

10.2 Dy orë para mbërritjes, ngrihet në vendin e caktuar mbi hyrjen perëndimore flamuri i shtetit mik, në krah të majtë të flamurit shqiptar. Flamurë të të dy vendeve vendosen në sallën e takimit ose me përmasa të vogla, në tavolinën e bisedimeve zyrtare.

10.3 Në vizitat zyrtare zhvillohet ceremonia e nderit. Ajo mund të zhvillohet në aeroport, në selinë e Kryeministrit ose në një rezidencë tjetër qeveritare sipas skemës së përcaktuar.

10.4 Në vizita jozyrtare (kalimtare, private dhe shumëpalëshe) nuk zhvillohet ceremonia e nderit. Kryeministri e pret vizitorin mik në hyrjen perëndimore të selisë së Kryeministrit. Sipas rastit, së bashku me Kryeministrin presin 2-3 shoqërues zyrtarë të tij, personat e ngarkuar me protokollin, shtypin dhe përkthyesi.

10.5 Në hyrje të sallës të statujave dhe në sallën e takimit parashikohen fotografi, shtrëngim duarsh dhe regjistrim televiziv. Si rregull, në takim zyrtar marrin pjesë jo më shumë se gjashtë vetë për çdo delegacion. Nëse parashikohet të bëhet takim privat midis dy kryeministrave, ai zhvillohet para takimit zyrtar, në zyrën e Kryeministrit. Ndërkohë delegacionet presin në vendin e paracaktuar.

10.6 Përcjellja e kryeministrit mik bëhet në hyrje të selisë. Në rastin kur ceremonia e nderit nuk bëhet në aeroport, ajo zhvillohet në oborrin e selisë. Gjatë ceremonisë në oborr futet vetëm makina e protokollit dhe ajo e vizitorit mik. Makinat e tjera dhe të sigurimit presin në hyrje të oborrit.

10.7 Kryeministri i Republikës së Shqipërisë pret miq të nivelit të lartë si kryetar shteti dhe kryeministër të huaj edhe në ambientet e Pallatit të Brigadave dhe rezidencave të tjera qeveritare. Në to mund të zhvillohet e njëjta ceremoni nderi. Për miqtë, Kryeministri shtron, sipas rastit, drekë ose darkë zyrtare.

10.8 Në rastet kur Kryeministri takohet me vizitorë të huaj të nivelit ministër, sekretar shteti ose autoritete të të njëjtit nivel me ta, pritja e tyre bëhet në sallën e takimit.

## 11. Ceremoniali i Kuvendit

11.1 Kuvendi është organi legjislativ i Republikës së Shqipërisë. Si i tillë ai gëzon të drejtën e një ceremoniali të veçantë në aktivitetin e tij zyrtar. Kompetencat për trajtimin dhe për zbatimin e këtij ceremoniali në territorin e Kuvendit i ka zyra e protokollit të Kuvendit.

11.2 Protokolli i Kuvendit drejton ceremonialin në Kuvend. Detyrat e tij parashikohen në rregulloren e brendshme të Kuvendit.

11.3 Protokolli i Kuvendit organizon, ndjek dhe programon ceremonitë e pritjes e të përcjelljes, si dhe të gjitha praktikat protokollare gjatë vizitave të delegacioneve të huaja të institucioneve

parlamentare ndërkombëtare.

11.4 Protokollit i Shtetit ka për detyrë organizimin dhe realizimin e veprimtarisë protokollare të Kryetarit të Kuvendit në veprimtarinë e tij brenda dhe jashtë vendit.

11.5 Drejtoria e Protokollit të Shtetit koordinon në bashkëpunim me protokollin e Kuvendit takimet e Kryetarit të Kuvendit me delegacionet e nivelit president, kryeministër, ministër të punëve të jashtme që vizitojnë vendin tonë dhe të ambasadorëve të rinj që paraqesin letërkredencialet. Takimet e zëvendëskryetarit të Kuvendit, të kryetarëve të grupeve parlamentare dhe deputetëve koordinohen nga protokollit i Kuvendit.

11.6 Protokollit i Kuvendit harton ftesa dhe telegrame zyrtare të Kryetarit të Kuvendit për homologë dhe titullarë të organizatave e institucioneve të ndryshme ndërkombëtare dhe ia përcjell ato Protokollit të Shtetit.

11.7 Ndjek praktikat konsullore me përfaqësitë diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë për vizitat e delegacioneve të Kuvendit, për dërgim të ftesave dhe të telegrameve të urimit dhe harton listën e pjesëmarrësve në takimet zyrtare dhe pritjet e Kryetarit të Kuvendit.

11.8 Ceremonitë e ndryshme protokollare që zhvillohen në sallën plenare të Kuvendit janë objekt dhe kompetencë e zyrës së protokollit të Kuvendit.

## 12. Kryetari i Kuvendit

12.1 Kryetari i Kuvendit është autoriteti i dytë në radhën e përparësisë të Republikës së Shqipërisë dhe për pasojë ka të drejtën e një ceremoniali të veçantë në veprimtarinë zyrtare dhe jetësore të tij. Në hyrje të zyrës së Kryetarit të Kuvendit qëndrojnë dy truproja nderi. Gjithkush i drejtohet atij "z. Kryetar i Kuvendit".

12.2 Bashkëshortja e Kryetarit të Kuvendit gëzon status protokollar gjatë pritjeve dhe aktiviteteve ku është ftuar së bashku me bashkëshortin, brenda ose jashtë shtetit ose vetëm, gjatë organizimit të aktiviteteve të ndryshme shoqërore, humanitare, si dhe me trupin diplomatik. Bashkëshortes së Kryetarit të Kuvendit, gjithsecili i drejtohet znj. (vijon mbiemri).

12.3 Kur Kryetari i Kuvendit merr pjesë në aktivitetet publike së bashku me Presidentin e Republikës, qëndron në të djathtë të tij, përveç rasteve të përcaktuara ndryshe.

12.4 Statusi protokollar brenda strukturës së Kuvendit dhe në sallën e parlamentit drejtohet nga protokollit i brendshëm i këtij institucioni.

## 13. Pritje në Ministrinë e Punëve të Jashtme

13.1 Ministria e Punëve të Jashtme organizon me trupin diplomatik pritje të ndryshme, duke përfshirë në to, sipas rastit, edhe personalitete shqiptare të jetës politike e sociale.

13.2 Drejtuesit e saj kryesorë marrin pjesë, për shkak të detyrës, në shumë pritje ose aktivitete shtetërore, zyrtare dhe private, kur janë të ftuar nga autoritetet organizatore dhe kur në to marrin pjesë përfaqësues të trupit diplomatik apo delegacione të huaja të ndodhura për vizitë në Shqipëri.

13.3 Ministri i Punëve të Jashtme, së bashku me bashkëshorten, ka të drejtën të organizojë pritje dhe aktivitete diplomatike, sipas momentit dhe qëllimeve që kërkon të realizojë nëpërmjet tyre. Kjo përcaktohet në përputhje me synimet politike që ai vetë ka miratuar.

13.4 Pritja e parë e Ministrisë të Punëve të Jashtme jepet sapo fillon detyrën zyrtare. Pritja jepet brenda orarit zyrtar, vetëm për shëfat e përfaqësive diplomatike ose jashtë orarit zyrtar, nëse ftohen

së bashku me bashkëshortet.

13.5 Ministri i Punëve të Jashtme jep pritje për trupin diplomatik të akredituar në Shqipëri sipas rëndësisë së momentit. Të gjithë vizitorët e lartë të ardhur në Shqipëri me ftesën e tij, nderohen me drekë ose darkë zyrtare.

13.6 Ministri i Punëve të Jashtme jep drekë ose darkë zyrtare për shefat e rinj të përfaqësive diplomatike që akreditohen në Shqipëri, duke i ftuar në grupe nga 2-3 së bashku me bashkëshortet.

13.7 Ministri i Punëve të Jashtme (ose zëvendësi) jep drekë ose darkë përcjellje për shefat e përfaqësive që largohen nga detyra në Shqipëri. Ai pranon gjithashtu ftesat për të tilla aktivitete të dhëna prej tyre.

13.8 Ministri i Punëve të Jashtme merr pjesë në drekat ose darkat shtetërore që shtron Presidenti i Republikës për homologët e Tij ose miq të tjerë të lartë (kryeministër, mbret, princ trashëgimtar etj.).

13.9 Ministria e Punëve të Jashtme ndjek me kujdes të gjitha aktivitetet e përfaqësive diplomatike dhe respekton karakterin dhe qëllimin për të cilin ato zhvillohen.

## KAPITULLI V

### VIZITA DHE TAKIME

Ceremoniali i Republikës së Shqipërisë parashikon këto lloj vizitash:

- Shtetërore (vetëm nga kryetarë shteti)
- Zyrtare
- Pune
- Kortezie, Private

Vizitat dhe takimet ndërkombëtare të kreut të shtetit, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe Ministrit të Punëve të Jashtme në Republikën e Shqipërisë organizohen nëpërmjet kanaleve diplomatike dhe asistohen nga Protokollit i Shtetit.

Ftesat bëhen nga Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, Ministri i Punëve të Jashtme, homologëve të tyre të huaj gjatë takimeve që mund të kenë me ta ose edhe zyrtarisht, nëpërmjet përfaqësuesve diplomatikë. Ftesat dërgohen nëpërmjet Protokollit të Shtetit.

Palët bien dakord nëpërmjet kanaleve diplomatike për kohën e vizitës, si dhe për kohëzgjatjen e saj. Kur kryetari i delegacionit është kryetar shteti, kryetar parlamenti, kryeministër dhe ministër i punëve të jashtme, në masmedia jepet një biografi e shkurtër e jetës dhe e veprimtarisë së tij, e shoqëruar me një përmbledhje të shkurtër të historikut të marrëdhënieve midis dy vendeve.

Disa ditë përpara datës së caktuar të mbërritjes së delegacionit, hartohet programi përfundimtar i vizitës. Në program parashikohen, mënyra e pritjes dhe e përcjelljes, përbërja e delegacioneve, zhvillimi dhe formati i bisedimeve, marrëveshjet, nëse ka të tilla, takimet me personalitetet e vendit, vizita në qendra të ndryshme kulturore-turistike, të dhëna mbi vendin dhe klimën e tij etj.

Hartimi i programit bëhet duke bashkëpunuar ngushtë me përfaqësinë diplomatike të vendit nga vjen delegacioni. Përfaqësisë diplomatike i jepet një kopje e programit përfundimtar disa ditë përpara mbërritjes së delegacionit.

#### 1. Pritja e delegacioneve të huaja të nivelit të lartë

1.1 Në raste vizitash shtetërore dhe zyrtare zhvillohet gjithmonë ceremonia e plotë e pritjes me truporjen e nderit dhe ekzekutimin e himneve kombëtare.

- 1.2 Në rast vizite pune, kortezie dhe private, në selinë e autoritetit shqiptar zhvillohet një ceremoni pritje me truprojë nderi të reduktuar, pa ekzekutim himni. Komandanti i truprojës i paraqet forcën mikut të huaj. Protokolli i Shtetit e shoqëron atë në takimin me autoritetin shqiptar.
- 1.3 Delegacioni i huaj i nivelit kryetar shteti, kryetar parlamenti, kryetar qeverie, Sekretar i Përgjithshëm i OKB-së dhe i NATO-s, President i KE-së dhe i një rangu me ta, pritet me ceremoninë përkatëse në Aeroportin "Nënë Tereza" ose në selinë e autoritetit që e ka ftuar. Kjo fiksohet në programin e vizitës dhe miratohet paraprakisht nga personaliteti shqiptar pritës.
- 1.4 Ceremonia zyrtare me flamujt kombëtare të të dy vendeve, truprojen e nderit dhe bandën muzikore zhvillohet vetëm në rastin kur kryetari i delegacionit është kryetar shteti dhe kryetar qeverie ose i rangut të barabartë me ta. Përveçse në aero port, ceremonia mund të zhvillohet në Pallatin e Brigadave, në selinë e Presidentit, të Kryeministrit ose vende të tjera sipas skemave të miratuara. Në pikat kufitare tokësore nuk zhvillohet ceremoni zyrtare.
- 1.5 Autoriteti mik dhe anëtarët e tjerë të delegacionit përshëndeten gjatë ceremonisë së nderit me autoritetet e vendit që kanë dalë për t' i pritur, si dhe me personelin e përfaqësues diplomatike të vendit të tyre.
- 1.6 Të parët vendosen në radhë personalitetet vendase dhe më tej personeli i përfaqësues diplomatike, si dhe të tjerë të miratuar paraprakisht nga protokolli sipas përparësisë zyrtare. Sugjerohet që numri i personaliteteve vendase që marrin pjesë në ceremoni të jetë i kufizuar.
- 1.7 Personalitetet shqiptare prezantohen nga autoriteti shqiptar, kurse personeli diplomatik prezantohet nga ambasadori përkatës.
- 1.8 Në vizita shtetërore dhe zyrtare, makina e kryetarit të shtetit mik shoqërohet nga gjashtë motoçikleta ceremoniali dhe nga katër kur është kryetar parlamenti ose kryeministër. Në të djathtë të makinës VIP vendoset flamuri i vendit mik. Në raste vizitash pune, kortezie dhe private, personaliteti i huaj nuk shoqërohet me motoçikleta.
- 1.9 Dy autoritetet homologe mund të hipin në të njëjtin automjet vetëm në rastet e parashikuara sipas programit. Autoriteti shqiptar e fton mikun të qëndrojë në krahun e tij të djathtë.
- 1.10 Kur delegacioni kryesohet nga Ministri i Mbrojtjes, ceremonia zhvillohet në ambientet e Ministrisë së Mbrojtjes ose në repartin ushtarak të përcaktuar që më parë sipas programit.
- 1.11 Kur kryetari i delegacionit është kryetar shteti dhe takohet sipas kërkesës së tij me Kryetarin e Kuvendit dhe Kryeministrin, shoqërohet nga zëvendësministri i Punëve të Jashtme. Format i takimit nuk duhet të kalojë 1+ 5 persona. Anëtarët e veçantë të delegacionit mund të zhvillojnë takime të veçanta me homologët e tyre shqiptarë për probleme konkrete të interesit të ndërsjellë.
- 1.12 Kur kryetari i delegacionit është kryetar parlamenti dhe takohet sipas kërkesës së tij me Presidentin dhe me Kryeministrin, shoqërohet nga nënkryetari i Kryesisë së Kuvendit dhe, në mungesë të tij, nga kryetari i Komisionit Parlamentar të Politikës së Jashtme.
- 1.13 Kur kryetari i delegacionit është kryeministër dhe takohet me Presidentin, shoqërohet nga Ministri i Punëve të Jashtme dhe në mungesë të tij nga zëvendësministri i Punëve të Jashtme.
- 1.14 Çdo kryetar shteti ose kryeministër që viziton Shqipërinë për më shumë se një ditë, zhvillon një takim kortezie me kryetarin e bashkisë së qytetit ku vendoset dhe e falënderon atë për mikpritjen. kryetari i bashkisë i dhuron në shenjë simbolike çelësin e qytetit.
- 1.15 Në të gjitha rastet e vizitave të delegacioneve në nivel kryetar shteti, kryeministër dhe ministër i punëve të jashtme, thirret ambasadori shqiptar i akredituar në vendin nga vjen delegacioni dhe renditet i dyti në listën e delegacionit shqiptar, përveç rastit kur në të marrin pjesë dy nga personalitetet e mësipërme.



1.16 Për nder të delegacionit, homologu shqiptar jep drekë ose darkë zyrtare. Për delegacionin në nivel kryetar shteti, i cili qëndron vetëm një ditë, Presidenti shtron drekë shteti për të gjithë delegacionin.

Nëse delegacioni qëndron dy ditë, Presidenti shtron darkë shteti dhe Kryeministri, shtron drekë zyrtare të nesërmen.

Nëse delegacioni qëndron më gjatë, për nder të tij jep një pritje Kryetari i Bashkisë së kryeqytetit.

1.17 Në fillim të drekës ose darkës zyrtare mbahen përshëndetje të shkurtra në formën e urimit nga të dy kryetarët e delegacioneve. Është mirë që fjalimi dhe përkthimi i tij të përgatiten disa ditë përpara dhe t'i bëhen të njohura mikut të ftuar nëpërmjet përfaqësuesit diplomatike përkatëse, në mënyrë që ai të përgatisë përgjigjen dhe përkthimin në gjuhën shqipe.

1.18 Fjalimet mbahen gjithmonë në gjuhën kombëtare dhe secili pjesëmarrës në drekë ose darkë e ka përpara tekstin në të dyja gjuhët. Gjatë drekës ose darkës zyrtare duhet të jetë i pranishëm një përkthyes.

1.19 Midis kryetarëve të delegacioneve shkëmbehen dhurata. Shkëmbimi i dhuratave bëhet nëpërmjet protokolleve përkatëse. Kryetarit të delegacionit para largimit të tij, zakonisht i dhurohet nga homologu shqiptar një album me fotografi të vizitës së delegacionit.

1.20 Kur kryetari i delegacionit është kryetar shteti, dhe vizita e tij zgjat më tepër se një ditë, në program planifikohet vendosje e kurorës në emër të tij në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit. Në këto homazhe shoqërohet nga drejtori i Protokollit të Shtetit dhe pritjet në vend nga Kryetari i Bashkisë dhe komandanti i Gardës së Republikës. Përgatitjet e ceremonialit bëhen nga dekori i Bashkisë së Tiranës dhe kurora përgatitet sipas dëshirës së mikut.

1.21 Kur kryetari i delegacionit është kryetar shteti, në program mund të parashikohet një përshëndetje e tij në parlamentin shqiptar. Miku flet në gjuhën e zgjedhur prej tij. Protokollit i Kuvendit përgjigjet për përkthimin.

1.22 Flamuri i vendit mik vendoset në selinë e homologut shqiptar në të majtë të flamurit shqiptar. Gjatë kohës që miku i lartë qëndron në Shqipëri, në rezidencën ku ai vendoset ngrihet flamuri i tij kombëtar, i cili qëndron i shpalosur deri në largim.

1.23 Delegacioni i huaj, në vizitat që mund të bëjë në qytetet e tjera të Shqipërisë shoqërohet nga një personalitet i lartë i përcaktuar që më parë nga Protokollit i Shtetit. Në këto raste delegacionit i uron mirëseardhjen prefekti, kryetari i bashkisë dhe autoritete të tjera të pushtetit vendor. Përcjellja e delegacionit bëhet në të njëjtën mënyrë dhe nga të njëjtët persona që e presin.

1.24 Kur kryetari i delegacionit shoqërohet nga bashkëshortja, një program i veçantë përgatitet për të dhe bashkëshorten e autoritetit shqiptar. Të dyja zonjat asistojnë në pjesën ceremoniale të vizitës (pritje, përcjellje, drekë ose darkë zyrtare, vizita shoqërore, kulturore e humanitare etj.), por jo në bisedime dhe takime zyrtare.

1.25 Programi i vizitës së delegacionit të huaj pasqyrohet nga media. Mediat vihen në dijeni për vizitën nga zyra e shtypit e institucionit që e organizon këtë vizitë. Kjo zyrë organizon mbërritjen, lëvizjen, pjesëmarrjen dhe përcjelljen e grupit të gazetarëve që shoqërojnë personalitetin e huaj.

1.26 Programi i vizitës shtetërore apo zyrtare, listat e pjesëmarrësve në takimet e parashikuara dhe çdo veprimtari tjetër që përfshihet në program, miratohen paraprakisht nga autoriteti shqiptar pritës. Zbatimi i tij bëhet nga Protokollit i Shtetit. Ai mobilizon të gjitha strukturat e nevojshme shtetërore dhe i vendos në dispozicion të realizimit sa më të mirë të vizitës.

1.27 Nëse takimi i lartë është tre ose më shumëpalësh, atëherë nuk zhvillohet ceremoni e plotë nderi. Miqtë e huaj priten me truporje nderi të reduktuar pa bandë muzikore (14 truporja). Pritja në

aeroport bëhet nga Drejtori i Protokollit të Shtetit, dhe sipas rastit nga zyrtarë të tjerë të lartë të përcaktuar nga autoriteti shqiptar pritës. Miqtë e huaj priten nga homologu shqiptar në vendin e caktuar për takim.

1.28 Në të gjitha rastet e vizitave, shteti shqiptar siguron mbulimin e shpenzimeve për formatin 1 + 3 (2 + 3 kur shoqërohet nga bashkëshortja), transportin dhe akomodimin. Pala vizitore përballon të gjitha shpenzimet e tjera. Bëhen përjashtime vetëm në raste të reciprocitetit.

1.29 Ruajtjen dhe sigurimin e personalitetit të huaj gjatë gjithë kohës së vizitës dhe qëndrimit të tij në Shqipëri, si dhe ceremoninë e rojës së nderit e bën Garda e Republikës. Gardës i jepet programi i përgatitur i vizitës disa ditë përpara (jo më vonë se 48 orë përpara).

## 2. Përdorimi i sallës VIP të aeroportit

2.1 Salla VIP e Aeroportit "Nënë Tereza" është e formuar nga dy ose më shumë mjedise, shfrytëzimi i të cilave është i diferencuar dhe bëhet në bazë të rregullave të mëposhtme.

2.2 Përdorimi i sallës VIP drejtohet nga Protokollit i Shtetit ose me lejen e tij.

Salla 1 rezervohet për këto autoritete:

- Kryetarë shteti (president republike, mbret, princ trashëgimtar)
- Kryetarë qeverie
- Kryetarë parlamenti

Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Presidenti i Komisionit European dhe Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Presidenti i Parlamentit European.

2.3 Autoritetet e mësipërme të huaja lejohen të përdorin sallën 1 vetëm kur janë për vizitë zyrtare në Shqipëri ose udhëtojnë transit me delegacionin e tyre zyrtar për në vende të tjera.

Salla 2 rezervohet për këto autoritete:

- Kryetar i Gjykatës Kushtetuese;
- Nënkryetar Kuvendi;
- Zëvendëskryetar qeverie;
- Anëtarë qeverie, deputetë;
- Ish-president i Republikës;
- Komisionerë të Parlamentit European, Sekretari i Përgjithshëm i OSBE-së;
- Ambasadorë të huaj të akredituar në Shqipëri dhe ambasadorët shqiptarë në krye të detyrës. Të ngarkuar me punë a.i;
- Ish-kryeministër, anëtar i Gjykatës Kushtetuese, kryetar i Komisioni Parlamentar, Kryetari i Bashkisë së Tiranës;
- Avokati i Popullit, kryetari i Gjykatës së Lartë, Prokurori i Përgjithshëm Guvernatori i Përgjithshëm i Bankës së Shqipërisë, kryetar i KLSH-së dhe të barabartë në rang;
- Zëvendësministër, Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave dhe i Presidencës;
- Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, kryetari i SHISH-it;
- Grada Gjeneral, kur është në përbërje të një delegacionit zyrtar;

2.4 Kërkesa për shfrytëzimin e sallës VIP të shtetit bëhet në formën e një note verbale dhe i drejtohet Protokollit të Shtetit për miratim. Përjashtimet nga rregulli i mësipërm gjykohen rast pas rasti.

2.5 Në të gjitha rastet e vizitave shtetërore dhe zyrtare, pijet, ushqimet dhe shërbime të tjera jepen në përputhje me rregullat e përcaktuara nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare.

2.6 Në të gjitha rastet e udhëtimeve transit dhe vizitave private, individët, institucionet apo

përfaqësitë diplomatike që i përcjellin apo që i kanë ftuar janë të detyruar të paguajnë shërbimin.

2.7 Anëtarët e përfaqësive diplomatike lejohen të futen në sallën VIP kur përcjellin të ftuarit e tyre, por jo më shumë se 3 vetë në sallë. Emrat e tyre dhe targat e makinave duhet të pasqyrohen në kërkesën që i drejtohet Protokollit të Shtetit.

2.8 Parkingu në territorin e sallës VIP është pa pagesë, por përdorimi i tij ndjek radhën e përparësisë zyrtare.

2.9 Sallat VIP punojnë zakonisht me dy turne, por mund të ofrojnë shërbim edhe 24-orë pandërprerë. Për këtë duhet njoftuar 1 ditë më parë.

2.10 përdorimi i sallave VIP bëhet pa anashkaluar kontrollin e sigurisë së bagazheve dhe të personave. Ky kontroll përjashtohet vetëm për nivelin president, kryeministër, kryetar kuvendi dhe homologët e tyre të huaj. Çdo person tjetër që frekuenton sallën nr. 2 dhe çdo delegacion në përgjithësi, u nënshtrohet procedurave të kontrollit. Brenda sallës VIP 1 nuk lejohet monitorimi dhe përgjimi. Në të mund të futet vetëm një rojë sigurimi i personalitetit. Sigurimi i autoriteteve bëhet nga jashtë sallave VIP.

2.11 Futja e shoferëve në sallën VIP është e ndaluar. Kamerat e televizionit dhe fotografet lejohen t'i afrohen hyrjes së sallës VIP, por jo të futen brenda. Intervistat e autoriteteve jepen në hyrje të sallës ose në mjedise të tjera të përshtatshme.

### 3. Bisedimet

3.1 Bisedimet zyrtare ndërmjet dy delegacioneve zhvillohen në tavolinë, e cila përgatitet që me parë. Delegacionet zënë vend përballë njëri-tjetrit sipas rangut. Në qendër qëndron kryetari i delegacionit. Në tavolinë vendosen flamuj të vegjël kombëtarë. Vendasit zënë vend me shpinë nga dritarja ose përballë hyrjes, kurse miqtë, përballë tyre. Mund të vendosen edhe flamuj të mëdhenj kombëtarë.

3.2 Nëse takimi është i karakterit formal ose kortezie, është më e preferueshme të kryhet ulur në një sallon pritje. Në këtë formë zhvillohen kryesisht takimet kur rangu i bashkëbiseduesve nuk është i barabartë.

3.2 Takimet homologe dypalëshe zhvillohen në tavolina drejtkëndëshe, ato trepalëshe në tavolinë në formë U, me delegacionin pritës në qendër dhe, nëse janë katër delegacione, përdoret një tavolinë katrore.

3.3 Nëse delegacionet janë pesë ose më shumë, përdoret tavolinë vezake ose drejtkëndëshe, ku delegacioni pritës qëndron në pjesën e ngushtë të saj. Në rastet kur është e nevojshme që të evidentohet barazia formale e pjesëmarrësve dhe të evitohet pozicioni hierarkik i presidencës së takimit, atëherë përdoret tavolinë katrore ose e rrumbullakët.

3.4 Në të gjitha llojet e bisedimeve lejohet pjesëmarrja fillestare e medias dhe bëhen fotografi zyrtare të delegacioneve ose të kryetarëve të tyre. Lejohen sekretarët stenografisë.

3.5 Personaliteteve të shquara që marrin pjesë në takim u kërkohet kortezia e nënshkrimit në librin e nderit të vizitës.

### 4. Nënshkrimi i marrëveshjeve

4.1 Nënshkrimi i marrëveshjeve dy ose më shumë palësh është një moment solemn, i cili kërkon një protokoll të veçantë dhe të kujdesshëm. Ceremonia duhet të respektojë këto rregulla bazë:

- Tavolina e firmosjes duhet të ketë madhësi të përshtatshme me numrin e firmëtarëve, të cilët ulen të gjithë nga e njëjta anë e saj.
- Autoriteti pritës e vendos mikun në krah të djathtë. Nëse janë më shumë se dy, vendasi qëndron në mes.
- Në tavolinë sistemohen që më parë dosjet e marrëveshjes dhe penat.
- Pas nënshkruesve vendosen flamujt kombëtarë dhe përfaqësues, të cilët duhet të jenë të të njëjtës madhësi. Mundet që përveç flamujve të mëdhenj të vendosen edhe flamuj të vegjël tavoline.
- Të paktën dy vetë ndihmojnë firmëtarët gjatë procedurës së firmosjes.
- Media sistemohet përballë tavolinës së firmosjes, jo më pak se 2-3m distancë.
- Delegacionet përkatëse zënë vend në krah të kryetarit të tyre ose pas tij.
- Nëse marrëveshja nuk nënshkruhet nga autoritetet më të larta prezent në ceremoni, këta të fundit zënë vend pas nënshkruesve ose ulur në tavolinë në mes të tyre.

## 5. Shkëmbimi i dhuratave

5.1 Në rastet e vizitave, takimeve dhe në përgjithësi gjatë ushtrimit të detyrës shtetërore, personaliteteve të larta të shtetit u jepen **dhurata nga njerëz dhe institucione**. Presidenti, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri dhe Ministri i Punëve të Jashtme, shkëmbejnë dhurata në shenjë kortezie vetëm me personalitetet e huaja homologe.

5.2 Vlera e dhuratës nuk duhet të kapërcejë kufijtë e mirësjelljes, rregullat apo limitet ligjore që shtete të ndryshme mund të kenë vendosur, si dhe reciprocitetin. Për çdo dhuratë të dhënë hartohet dokumentacioni përkatës përshkrues. Institucionet rekomandohen të bëjnë personalizimin e dhuratave.

5.3 Autoritetet kryesore nuk i shkëmbejnë vetë dhuratat në takimet zyrtare, përveç rasteve të veçanta kur bihet dakord që më parë për këtë. Në çdo rast tjetër, dhuratat shkëmbehen nëpërmjet protokolleve përkatëse.

5.4 Vetëm Protokolli i Shtetit ka të drejtë të japë dhurata në mungesë të autoriteteve të larta shqiptare dhe në emër të tyre.

5.5 Të gjitha rangjet zyrtare, që kanë të drejtë të shkëmbejnë dhurata me homologë të huaj, mund të japin ose të pranojnë të tilla deri në shumën 25 000 lekë për çdo rast. Kjo shumë mund të kapërcehet vetëm në rastet kur personi, të cilit do t'i jepet dhurata zë vend të veçantë për Shqipërinë. Çdo dhuratë regjistrohet në natyrën e saj, datën, vendin dhe arsyen për të cilën është dhënë.

5.6 Ka raste kur pranohen dhurata që kalojnë shumën e mësipërme. Për të mos fyer dhuruesin mik dhe krijuar keqkuptime në marrëdhëniet midis vendeve, dhurata pranohet, por kthehet në pronë të shtetit shqiptar dhe bëhet pjesë e inventarit të institucionit që e ka pranuar. Ajo ekspozohet në vendin e duhur me sqarimin përkatës të dhuruesit.

5.7 Për autoritetet kryesore të shtetit, Presidentin e Republikës, Kryetarin e Kuvendit, Kryeministrin dhe Ministrin e Punëve të Jashtme, blerja e dhuratave që shkëmbehen me homologët e tyre dhe personalitete të larta të huaja, bëhet me prokurim të drejtpërdrejtë.

## 6. Pritja e delegacioneve jo të nivelit të lartë

6.1 Kur delegacionet e huaja që vijnë në Republikën e Shqipërisë kryesohen nga personalitete të

nivelit ministër dhe më ulët, priten dhe përcillen nga përfaqësues shqiptarë të të njëjtit rang me ta.

6.2 Këto delegacione priten pa ceremoni zyrtare dhe ngritje flamuri. Flamurët e të dy vendeve ngrihen në ministrinë përkatëse vetëm kur delegacioni kryesohet nga Ministri i Punëve të Jashtme ose Ministri i Mbrojtjes.

6.3 Delegacionet e huaja të kryesuara nga nivel ministri mund të priten në takime të veçanta nga Presidenti i Republikës dhe Kryeministri, bazuar në kërkesën e tyre pranë Protokollit të Shtetit. Delegacionet legjislative të të njëjtit rang priten nga Kryetari i Kuvendit. Në çdo rast merret mendimi paraprak i drejtorisë politike përkatëse të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

6.4 Në takimet me Presidentin ose Kryeministrin, ministri i huaj si rregull, shoqërohet nga homologu shqiptar, si dhe nga të paktën një zyrtar i Ministrisë së Punëve të Jashtme. Në takimet e Kryetarit të Kuvendit marrin pjesë edhe përfaqësues të Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë të Kuvendit.

6.5 Për nder të delegacionit, homologu shqiptar mund të japë një drekë ose darkë zyrtare.

6.6 Nëse ministri i huaj viziton qytete të ndryshme, si rregull, shoqërohet nga një zëvendësministër ose drejtori përkatës, si dhe protokollit i ministrisë. Në vizitat e ndryshme në qendra kulturore, muze ore e artistike të kryeqytetit, delegacioni shoqërohet nga homologu shqiptar.

6.7 Kur delegacioni i huaj kryesohet nga Ministri i Punëve të Jashtme, programin e vizitës e përgatit dhe e ndjek për zbatim Protokollit i Shtetit.

Kur delegacioni ose delegacionet e huaja jo në nivel ministri të punëve të jashtme vizitojnë Shqipërinë për vizita dy dhe shumëpalëshe të aktivitetit diplomatik, programi përgatitet në bashkëpunim me Drejtorinë Politike të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe e ndjek për zbatim Protokollit i Shtetit.

6.8 Kur delegacioni kryesohet nga një ministër tjetër ose personalitet i barabartë me rangun e ministrit, programi i vizitës përgatitet nga sektori i marrëdhënieve me jashtë i dikasterit përkatës pritës ose partner i drejtpërdrejtë. Po kështu edhe për rastet kur delegacionet janë të një rangu më të ulët se ministër.

6.9 Në të gjitha rastet e vizitave të nivelit ministër ose të barabartë me të, vihet në dijeni për programin e vizitës Garda e Republikës jo më vonë se 48 orë përpara mbërritjes së personalitetit të huaj.

6.10 Ceremonia e pritjes së një ministri mbrojtje ose shefi shtabi të përgjithshëm bëhet në Ministrinë e Mbrojtjes ose në një objekt ushtarak. Ceremonia zhvillohet në prani të truporës ushtarake të nderit dhe drejtohet nga protokollit i Ministrisë së Mbrojtjes.

## 7. Përcjellja e delegacioneve shqiptare të nivelit të lartë

7.1 Kur Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit dhe Kryeministri udhëtojnë jashtë shtetit për vizitë shteti ose zyrtare, mundet që 1 ditë më parë udhëton për në vendin pritës një punonjës i protokollit të institucionit përkatës ose Protokollit të shtetit, i cili njihet me përgatitjet, vendin dhe programin e vizitës ose këtë aktivitet e kryen përfaqësia diplomatike e Republikës së Shqipërisë e akredituar në vendin përkatës.

7.2 Delegacioni i lartë përcillet në aeroport nga Drejtori i Protokollit të Shtetit ose zëvendësi. Në përcjelljen e Presidentit të Republikës si rregull marrin pjesë, gjithashtu Sekretari i Përgjithshëm i Presidencës ose Drejtori i Kabinetit dhe anëtarë të stafit të tij. Merr pjesë edhe ambasadori i vendit përkatës.

7.3 Në përcjelljen e Kryeministrit si rregull marrin pjesë Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, Drejtori i Kabinetit të Kryeministrit dhe Drejtori i Protokollit të Shtetit ose zëvendësi.

7.4 Në përcjelljen e Ministrit të Punëve të Jashtme merr pjesë Shefi i Kabinetit dhe Drejtori i Protokollit të Shtetit ose zëvendësi i tij. Në rastet e vizitave zyrtare asiston edhe ambasadori i vendit përkatës.

7.5 Autoritetet e mësipërme vijnë në aeroport vetëm disa çaste përpara ngritjes së avionit. Anëtarët e tjerë të delegacionit kryejnë të gjitha formalitetet përpara mbërritjes së autoritetit dhe hipin të parët në avion. Personi i ngarkuar me protokollin e personaliteti kryen të gjitha formalitetet përpara mbërritjes së tij në aeroport.

7.6 Në të njëjtën mënyrë organizohet edhe pritja në aeroport e Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Ministrit të Punëve të Jashtme dhe delegacioneve që ata kryesojnë.

7.7 Gjatë vizitave zyrtare autoritetet shqiptare mund të shoqërohen nga bashkëshortet, të cilat ndjekin programin e përgatitur nga pala pritëse dhe angazhimet reciproke protokollare (shkëmbim dhuratash etj.).

## 8. Pritja e personaliteteve të rëndësishëm pa rang zyrtar

8.1 Nëse në Shqipëri vijnë për vizitë të ftuar nga autoritetet e larta të vendit, personalitete të veçanta pa rang zyrtar, por të rëndësishëm dhe të nivelit të lartë në vendin e tyre si, princ jotrashëgimtar, drejtues fondacionesh të rëndësishme, përfaqësues të mëdhenj të artit, kulturës, të familjeve të mëdha botërore ose të tjerë të barabartë me këtë nivel, ndaj tyre zbatohet një protokoll i veçantë.

8.2 Nëse ardhja e tyre është negociuar në rrugë diplomatike, priten nga zyrtarë të Protokollit të Shtetit, përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe trajtohen si vizitorë me status diplomatik. Nivelin e pritjes e përcakton Protokollin e Shtetit.

8.3 Nëse vizita bëhet me ftesë private nga një prej autoriteteve të larta shqiptare, personaliteti i huaj mund të pritët nga vetë autoriteti që e ka ftuar ose përfaqësues të tij dhe protokollin e brendshëm i institucionit pa ceremoni zyrtare. Shpenzimet përballohen nga institucioni ftues në formatin 1 +2 ose 2+2.

## KAPITULLI VI CEREMONIALI ZYRTAR

Ceremoniali zyrtar përfaqëson një përmbledhje normash, të cilat disiplinojnë tërë aktivitetin zyrtar formal dhe joformal të piramidës së shtetit në Shqipëri. Misioni kryesor i tij është:

1. Përcaktimi dhe respektimi i radhës së përparësisë së personaliteteve zyrtare në përputhje me funksionet që kryejnë dhe postin shtetëror që kanë.
2. Organizimi i veprimtarive kryesore dhe më të rëndësishme të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe Ministrit të Jashtëm si vizita, inaugurime, takime të nivelit të lartë, pritje, dreka dhe darka zyrtare, festa zyrtare e funerale, mesazhe e letra zyrtare, dekorime etj., pa të cilat nuk mund të kuptohet figura e shtetit.

### 1. Radha e përparësisë së rangjeve zyrtare

1.1 Në Republikën e Shqipërisë, përparësia e rangjeve zyrtare ndahet në tre grupe kryesore: Në grupin e parë bëjnë pjesë, Presidenti i Republikës si përfaqësues i shtetit, Kryetari i Kuvendit, i cili përfaqëson pushtetin legjislativ, Kryeministri, si kryetari i pushtetit ekzekutiv, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese dhe rangu i ish-presidenteve të Republikës.

Në grupin e dytë bëjnë pjesë, nënkryetarët e Kuvendit, anëtarët e Këshillit të Ministrave, rangjet që kanë iniciativë legjislative, ambasadorët e huaj, anëtarët e gjykatës kushtetuese, drejtuesit e organeve që kanë autonomi në harkun kushtetues, përfaqësuesit e forcave politike kryesore, shefi i shtabit të përgjithshëm, emërtesat politike të Presidentit, Kryeministrit dhe zyrtarë të tjerë të lartë të aparatit shtetëror.

Në grupin e tretë bëjnë pjesë kryesisht rangje të nivelit të dytë, emërtesa të Këshillit të Ministrave, drejtues të pushtetit vendor, personalitete të artit, kulturës dhe shkencës, të organizatave të veteranëve të LANÇ, këshilltarë të anëtarëve të Këshillit të Ministrave dhe ushtarakë.

## PËRPARËSIA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

### I

Presidenti i Republikës  
Kryetari i Kuvendit  
Kryeministri  
Kryetari i Gjykatës Kushtetuese  
Ish-presidentët e Republikës

### II

Nënkryetarët e Kryesisë së Kuvendit  
Zëvendëskryetari i Këshillit të Ministrave  
Anëtarët e qeverisë sipas listës së dekretimit nga Presidenti i Republikës.  
Ambasadorët e vendeve të huaja të akredituara në shtetin shqiptar  
Ambasadorët e Shqipërisë në krye të detyrës  
Ish-kryeministër  
Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese  
Kryetarët e grupeve parlamentare, sipas përfaqësimit në parlament  
Kryetarët e komisioneve parlamentare  
Kryetari i Bashkisë së Tiranës  
Kryetari i Gjykatës së Lartë, Avokati i Popullit  
Anëtarët e Gjykatës së Lartë  
Guvernatori i Bankës së Shqipërisë  
Prokurori i Përgjithshëm i Republikës  
Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit  
Kryetari i SHISH-it  
Deputetët  
Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë  
Kryetarët e klerit musliman, bektashian, katolik dhe ortodoks  
Trashëgimtarët e familjes mbretërore  
Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, Presidencës, Kuvendit

Zëvendësministrat

Të ngarkuarit me punë të vendeve të huaja të akredituara në Shqipëri

Ish-ministër i Punëve të Jashtme

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme

Drejtori i Kabinetit të Presidentit dhe Kryeministrit

Këshilltarët e Kryeministrit dhe Këshilltarët e Presidentit

Kryetari i Akademisë së Shkencave

Anëtar i Gjykatës së Lartë; Kryetar i Komisionit të Zgjedhjeve; Zëvendëskryetar i KLD. Prefekti i Tiranës

Drejtori i Protokollit të Shtetit

Drejtori i Administratës Publike

Komandantët e Armëve të Ushtrisë me gradë gjenerali

Kryetarët e partive parlamentare jodeputetë

Avokati i Shtetit

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë

Komandanti i Gardës së Republikës

Sekretarë të përgjithshëm të ministrive

Kryetari i Qarkut të Tiranës

Drejtori i Arkivit të Shtetit

III

Prefektët

Kryetarët e bashkive

Ambasadorë të karrierës

Ministër, këshilltar, gjeneral

Drejtorë të përgjithshëm dhe të enteve nacionale

Kryetarë të partive joparlamentare

Këshilltarë të ministrave

Të dekoruar me urdhra të artë

Përfaqësues të shquar të letërsisë, të artit dhe të shkencës me tituj

Kryetari i Dhomës së Tregtisë së Republikës

Nënkryetari i Akademisë së Shkencave

Presidenti i Këshillit të Rektorëve të Republikës

Grada Kolonel dhe të barabartë me të

Kryetari i LANÇ

Drejtori i Muzeut Kombëtar

Drejtorë të institucioneve qendrore dhe agjencie kombëtare

Prokurorë të qarqeve dhe ushtarak

Kryetarë të këshillave të qarqeve

Kryetarë të gjykatave të qarqeve

Rektorë universitetesh

Drejtues të pushtetit vendor në komuna

Drejtues të shoqatave joshtetërore

1.4 Ndër të kualifikuarit me të njëjtin rang përparësinë e ka më i vjetri në detyrë dhe më tej



më i vjetri në moshë.

1.5 Ndër të kualifikuarit me rang të barabartë prioritetin e ka një i huaj.

1.6 Krerët e Shteteve kanë të gjithë rang të barabartë, presidentë apo mbretër qofshin, prandaj përparësia vendoset mbi bazën se kush është më i vjetër në detyrë dhe më tej në moshë.

1.7 Personat "ish" dhe të dalë në pension radhiten më poshtë se ata që kanë zënë vendet e tyre në detyrë.

1.8 Bashkëshortet gëzojnë rangun e titullarit dhe zënë vend së bashku me ta në të njëjtën radhë kur ftesa është çift. Në rastin kur titullari mungon, automatikisht e humbasin privilegjin e rangut, me përjashtim të bashkëshortes së Presidentit, të Kryeministrit dhe të Kryetarit të Kuvendit.

1.9 Në raste ceremonish të një natyre specifike, e cila lidhet me ngjarje dhe manifestime të një karakteri të përcaktuar, mund të ndodhë që të bëhen përjashtime në radhën e përparësisë së rangjeve. Në këto raste është natyra e ceremonisë që kushtëzon edhe radhën e vendosjes ndryshe të personaliteteve. Kjo bëhet brenda limiteve të caktuara dhe sipas një programi të miratuar që më parë. (p.sh. Në një manifestim të armës së Policisë së Shtetit, vendi i drejtorit të përgjithshëm të policisë duhet të jetë pranë ministrit të rendit. Në inaugurime objektësh apo festa lokale, rangu drejtues përkatës qëndron pranë personalitetit më të lartë të pranishëm. Në takime pune, funksionare të ndryshëm, sekretarë të përgjithshëm të Presidencës, Këshillit të Ministrave etj., vendosen pas personaliteteve të tyre.)

## 2. Përparësia e organeve të pushtetit vendor

2.1 Për përcaktimin e radhës së përparësisë së organeve të pushtetit vendor nuk merret për bazë kriteri i madhësisë së territorit dhe as ai i numrit të popullsisë, sepse në bazë të Kushtetutës të gjithë qytetarët janë të barabartë pavarësisht nga njësia vendore ku jetojnë.

2.2 Kriteri bazë është ai përfaqësues ose më saktë pesha politike dhe social-ekonomike e njësisë vendore. Mbi këtë bazë, përparësia e drejtuesve të organeve të pushtetit vendor ndjek këtë radhë:

Kryetarë bashkie-qendër qarku. Bën përjashtim Kryetari i Bashkisë së Tiranës, i cili mban një vend të veçantë si bashkia e kryeqytetit.

Kryetarë bashkie-qendër qarku.

Kryetarë të bashkive të tjera. Brenda kategorisë radha përcaktohet sipas rendit alfabetik të bashkive.

Kryetarë komunash

2.3 I njëjti kriter zbatohet edhe për prefekturat, qarqet, komunat. Radha e përparësisë në njësinë vendore është:

- Deputeti i zgjedhur
- Prefekti (bën përjashtim pushteti vendor i kryeqytetit)
- Kryetari i bashkisë
- Kryetari i këshillit të qarkut
- Kryetari i gjykatës
- Rektori i universitetit
- Prokurori
- Kryetarët e besimeve fetare
- Drejtori i policisë

- Komandanti i njësisë ushtarake
- Anëtari i këshillit bashkiak/komunë
- Drejtuesit e zyrave të bashkisë
- Kryetari i dhomës së tregtisë dhe industrie
- Drejtuesi i zyrës së tatimeve
- Drejtuesi i policisë tatimore
- Drejtorët e shkollave të mesme

### 3. Përparësia e drejtuesve të organizmave të Bashkimit European

3.1 Siç është përcaktuar në traktatin e Romës, radha e përparësisë së organizmave të BE-së është:

- Presidenti i Parlamentit European
- Presidenti i Këshillit European
- Presidenti i Komisionit të BE-së
- Presidenti i Gjykatës së Drejtësisë
- Presidenti i Gjykatës së Llogarive
- Anëtarët e Këshillit European (ministra të jashtëm)
- Nënpresidenti i Komisionit European
- Anëtarë të Këshillit European (joministra të jashtëm)
- Anëtarë të Komisionit të BE-së (sipas vjetërsisë së komisionerit)
- Kryetarë të misioneve diplomatike permanente pranë BE-së
- Nënpresidenti i Parlamentit European
- Anëtari i Gjykatës së Drejtësisë
- Presidenti i Bankës Europiane të Investimeve
- Presidenti i Komitetit Ekonomik e Social
- Zëvendës-presidenti i Bankës Europiane të Investimeve
- Anëtari i Parlamentit European
- Anëtari i Gjykatës së Llogarive

3.2 Protokolli shqiptar kërkon që rangjet europiane të homologohen me rangjet shqiptare. Kështu, Presidenti i Komisionit është i njëjtë me Kryeministrin, komisionerët me ministrat, Presidenti i Bankës Europiane të Investimeve me Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, Presidenti i Gjykatës së Llogarive me Kryetarin e Kontrollit të Shtetit, ndërsa për rangjet e tjera vazhdohet sipas titujve përkatës.

### 4. Elemente të ceremonive zyrtare

4.1 Ecja zyrtare, organizohet duke respektuar radhën e parë të saj, e cila si rregull duhet të jetë me numër tek. Vendi i nderit është në mes sipas renditjes: 4-2-1-3-5. Kur numri i personave të caktuar në radhën e parë është çift, vendi i nderit është në të djathtë: 1-2-3-4.

4.2 Kur personalitetet nisen për të zënë vend në një tribunë, ata ecin në mënyrë të tillë: 2-1-3 dhe në fund të lëvizjes personalitetet të zënë vendet e caktuara nga protokolli.

4.3 Vendi i nderit, konsiderohet ai në krah të djathtë nëse kemi dy vende ose i mesit, nëse janë tre. I dyti për nga rëndësia vjen vendi në të djathtë të vendit të mesit, i treti ai në të majtë dhe kështu me

radhë. Nëse janë dy personalitete të të njëjtit rang, atëherë vendosen të dy në mes duke pasur në të dy krahët një numër të barabartë shoqëruesish.

4.4 përcaktimi i vendeve në salla ndjek radhën e përparësisë së rangjeve të pjesëmarrësve. Pika e referimit është poltrona e mesit në radhën e parë ose poltrona e parë në të djathtë të rrugëkalimit në të cilën ulet personi më i rëndësishëm.

4.5 Për të respektuar ceremonialin duhet të përpilohet një hartë e qartë me mënyrën e ndarjes së vendeve sipas emrave të pjesëmarrësve në ceremoni dhe që ju shpërndahet pjesëmarrësve bashkë me ftesat.

4.6 Përshëndetja zyrtare në manifestime dhe festa të rëndësishme bëhet menjëherë pas fjalës së hapjes, të cilën e mban autoriteti më i lartë mikpritës.

4.7 Përshëndetjen e mban autoriteti më i lartë i shtetit, i ngarkuar sipas programit të evenimentit ose i caktuar që më parë me protokoll. Në asnjë rast nuk përshëndesin në të njëjtin aktivitet Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit dhe Kryeministri. Anëtarët e Këshillit të Ministrave nuk përshëndesin pas fjalës së Kryeministrit.

4.8 Nëse përshëndetja i delegohet për ta lexuar një përfaqësuesi zyrtar, ai e merr fjalën pas autoritetit më të lartë të pranishëm, i caktuar të përshëndesë i dyti. Bën përjashtim vetëm përfaqësuesi i Kryeministrit, i cili flet në vend dhe në emër të Tij.

4.9 Përshëndetja Kombëtare realizohet nga Presidenti i Republikës.

Lloji i veçantë ceremoniali i përshëndetjes kombëtare është edhe përshëndetja me breshërinë e 21 topave, e cila realizohet në këto raste:

- Në orën 10:00 të çdo jubileu të datës 28 Nëntor në Vlorë
- në marrjen e detyrës nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë dhe
- në funerale zyrtare.

4.10 Trupi diplomatik, duke qenë i akredituar pranë Kryetarit të Shtetit, ftohet të marrë pjesë në grup në ceremonitë më të rëndësishme zyrtare që jep ose merr pjesë Presidenti i Republikës dhe Kryeministri.

4.11 Në ceremonitë zyrtare vendi i shefave të përfaqësive është në tribunë pranë personaliteteve kryesore, në vendin e paracaktuar nga protokoll. Trupi diplomatik nuk merr pjesë asnjëherë në parakalim. Përparësia e tyre përcaktohet në varësi nga koha e paraqitjes së kredencialeve.

4.12 Nëse parashikohet një parakalim me një karakter ushtarak apo civil, trupi diplomatik shoqëron Presidentin e Republikës në tribunën e nderit dhe qëndron në vendin e paracaktuar për të.

4.13 Vendosja në tribunën e nderit ndjek radhën si vijon: në qendër vendoset Presidenti i Republikës dhe në të dy krahët Kryetari i Kuvendit, Kryeministri dhe mikpritësi ose organizatori i ceremonisë.

Në radhën e dytë qëndrojnë ministrat. Titullarët e trupit diplomatik vendosen sipas përparësisë së tyre në të djathtë të tribunës qendrore, radha e parë, vendi i parë, duke filluar nga e djathta. Në të majtë të tribunës qendrore vendosen autoritete të tjera të vendit dhe të ftuar të tjerë.

4.14 Vendosja e autoriteteve në tribunë bëhet sipas përparësisë zyrtare, përveç përjashtimeve sipas rastit.

4.15 Kur në një ceremoni nuk ndodhet asnjë anëtar i Këshillit të Ministrave, prefekti është përfaqësuesi i qeverisë.

## 5. Ceremoni inaugurimi

5.1 Nëse autoritetet më të larta të shtetit marrin pjesë në inaugurime të objekteve, veprave dhe prodhimeve të reja, kjo përbën një ceremoni solemne, e cila organizohet me kujdesin e duhur.

5.2 Momentet kryesore të një inaugurimi janë:

- Vendi ku bëhet inaugurimi duhet të jetë i zbratur, për të treguar se do të jenë autoritetet që do të shkelin të parët. Njerëzit e ftuar duhet të kenë distancë nga vendi i nderit.
- [Autoritetet priten në mënyrë festive nga organizatorët dhe pjesëmarrësit e tjerë të ftuar me atë rast. Mund të ofrohen edhe lule.](#)
- Vepra që inaugurohet duhet të jetë e zbukuruar me flamurë, pankarta, lule, etj. Është me vend që banda muzikore të ekzekutojë muzikë të përshtatshme për momentin. Mund të thirret edhe kleri për të bekuar veprën sipas ritit të fesë përkatëse.
- Vendoset shiriti i kuq, që do të pritët nga autoriteti i nderit ose përgatiten materialet përkatëse, kur vendoset guri i parë. Guri i parë duhet të jetë i veçantë, mundësisht të ketë datën dhe emrin përkatës ose mund të vendoset gjithashtu një pllakë përkujtimore.
- Nëse objekti është vepër arti, atëherë duhet të jetë e mbuluar dhe e pajisur me shiritin e zbulimit.
- Për të dhënë më saktë idenë e punës, është mirë që autoritetit të ftuar dhe atyre që e shoqërojnë t'u shpërndahen kaskat, dorëzat e punës dhe çdo material tjetër që përdoret nga punëtorët e vendit.

5.3 [Inaugurimet mbyllen zakonisht me një koktej të ofruar nga organizatorët, të cilët falenderojnë të ftuarit për pjesëmarrjen në këtë ngjarje. Të ftuarit përcillen në të njëjtën mënyrë si priten.](#)

## 6. Ceremoni emërimi në detyrë

6.1 Çdo institucion ka detyrimin moral të bëjë të njohur zyrtarët që fillojnë punë në të. Në funksion të kësaj zhvillohet një ceremoni e thjeshtë, gjatë së cilës bëhet prezantimi i personit, i aftësive dhe aktivitetit të tij dhe më pas bëhet betimi. Nëse objekti është një grup të emëruarish të rinj, prezantimin mund ta bëjë edhe titullari i institucionit. Tipi i ceremonisë varet nga rangu i zyrtarit. Kështu:

- Ministri prezantohet në kolektiv nga Kryeministri ose Zëvendëskryeministri.
- Zëvendësministri dhe sekretari i përgjithshëm prezantohen nga ministri.
- Drejtorët e drejtorive prezantohen në kolektiv nga ministri ose zëvendësministri.
- Shefi i sektorit prezantohet në drejtori nga sekretari i përgjithshëm.
- Specialistët prezantohen në drejtori nga drejtori i përgjithshëm ose drejtori i personelit.

6.2 Në ceremonitë e rangjeve të rëndësishme (drejtor e lart), bashkë me kolektivin mund të marrë pjesë edhe familja e të emëruarit. Ai e merr fjalën pas prezantimit dhe shpreh mendimet e tij për organizimin e punës në të ardhmen dhe bën betimin.

6.3 Ministria e Punëve të Jashtme zhvillon ceremoninë e përcjelljes së ambasadorëve të akredituar në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë në vendet e tjera. Në ceremoni, përveç zyrtarëve të institucionit, ftohen të marrin pjesë edhe ambasadorët e vendeve përkatëse.

## 7. Ceremoni përcjelljeje në pension

7.1 Kjo ceremoni përbën një traditë të mirë civile dhe ushtarake që i shpreh mirënjohjen

institucionale zyrtarëve që dalin në pension pas një kariere të gjatë, të përkushtuar dhe një shërbimi të nderuar.

7.2 Çdo zyrtar duhet të dalë në pension me një shprehje falënderimi për vlerësimin e kontributit të tij nga vendi i punës dhe me bindjen se kurdoherë do të jetë një anëtar i përhershëm i institucionit ku ka punuar.

7.3 Institucionet duhet të kenë librin e nderit të punonjësve, të përdorin stimuj të ndryshëm vlerësimi, dhurata simbolike për këtë ceremoni dhe sipas rastit mund të përdorin programin zyrtar të dekorimeve. Ceremonitë e daljes në pension përgatiten paraprakisht nga komisionet e institucioneve përkatëse.

## 8. Dekoratat dhe vënia e tyre

8.1 Dekorimi përbën një vlerësim zyrtar dhe në të njëjtën kohë publik të veprimtarisë së individëve në shërbim të shtetit dhe të shoqërisë. Interesi zyrtar është të bëjë të njohur veprimtarinë e merituar të personave të veçantë dhe të nxisë çdo individ drejt përmirësimit dhe progresit.

8.2 Dhënia e urdhrave dhe dekoratave bëhet me dekret të Presidentit të Republikës, sipas legjisllacionit në fuqi.

8.3 Shpërndarja e urdhrave dhe dekoratave bëhet sipas një protokolli të veçantë të miratuar dhe të zbatuar rast pas rasti. Prodhimi i dekoratave është i certifikuar dhe kompetencë e zyrës së Presidentit.

8.4 Nderimi bëhet në momente të rëndësishme kombëtare, vendore dhe për ngjarje të veçanta të jetës së personave që nderohen. Gjatë ceremonisë ata shprehin mirënjohjen për nderin dhe vlerësimin që ju bëhet.

8.5 Ceremonia e shpërndarjes së dekoratave bëhet me raste dhe në mjedise të ndryshme, sipas një plani të përcaktuar që më parë:

Kur bëhet në Presidencë, drejtohet nga protokolli i brendshëm i saj. Kur ka më shumë se një dekorim, të parin e bën Presidenti i Republikës, ndërsa të tjerat vijojnë të bëhen sipas radhës së përparësisë së autoriteteve të ftuara në ceremoni.

8.6 Kur ceremonia e dekorimit bëhet në Kryeministri, drejtohet nga protokolli i Kryeministrit. Dekorimin e parë e bën Kryeministri, të tjerat vijojnë të bëhen sipas radhës së autoriteteve të ftuara në ceremoni

8.7 Kur ceremonia e dekorimit bëhet në mjedise publike, festa, përkujtime ngjarjesh historike, përfaqësi diplomatike etj. dekorimi bëhet sipas radhës, duke filluar nga dhënia e dekoratës më të lartë nga autoriteti më i lartë prezent.

8.8 Dekoratat janë pjesë e veshjes zyrtare. Ato vendosen në të gjitha aktivitetet zyrtare, festa, pritje, raste solemne. Veshja e rekomandueshme për dekoratat është ajo e errët solemne, frak dhe uniforma ushtarake ceremoniale.

8.9 Dekoratat nuk vendosen në jetën e përditshme dhe as në ceremoni funebre të çdo lloji. Ato nuk vendosen gjithashtu në pallto, pardesy apo kostume sportive.

8.10 Distinktivët e llojeve të ndryshme si anëtarësi në klube, pjesëmarrje në manifestime, shoqata, ente publike e private, mund të mbahen çdo ditë.

## KAPITULLI VII

### CEREMONITË KRYESORE ZYRTARE

#### 1. Festat zyrtare dhe publike

1.1 Ceremonitë festive në Republikën e Shqipërisë ndahen në zyrtare dhe publike. Ndryshimi midis tyre qëndron në faktin se festat zyrtare janë të tilla për të gjithë. Ditët e festave zyrtare nuk punohet dhe angazhimi i organeve të shtetit në ceremoni i jep festës një natyrë solemne.

1.2 Festat zyrtare. (Festimi i tyre parashikohet me ligj)

1 dhe 2 Janar Viti i Ri

22 Mars Novruz

1 Maj Dita e Punëtorëve

19 Tetor Lumturimi i Nënë Terezës

28 Nëntor Dita e Pavarësisë

29 Nëntor Dita e Çlirimit të Atdheut

Bajram i Madh

Bajram i Vogël

Pashkët Ortodokse

Pashkët Katolike

25 dhjetor Dita e Krishtlindjeve

1.3 Festat publike. Pavarësisht se festohet, dita e festës publike mbetet një ditë e zakonshme pune. Këto festa parashikojnë vetëm një dekor të ndryshëm të qytetit dhe vendosje flamujsh në ndërtesat publike. Kjo kategori përmbledh festa fetare, historike dhe evenimente, të cilat lidhen me përvjetorë ngjarjesh të ndryshme. Të tilla janë:

6 Janar Shën Jovani

7 Mars Dita e Mësuesit

8 Mars Dita e Gruas

5 Maj Dita e Dëshmorëve

9 Maj Dita e Europës

1 Qershor Dita e Fëmijëve

16 Shtator Dita e Bashkimit Kombëtar - Festa e Pezës

24 Tetor Dita e OKB-së

4 Dhjetor Dita e Forcave të Armatosura  
dhe festa të tjera.

1.4 Në ditët e festave, të gjitha institucionet publike marrin masa për vendosjen e flamurëve kombëtarë në ndërtesat e tyre dhe dekori i qytetit zbukuron mjediset publike. Të njëjtën procedurë ndjekin edhe institucionet e pavarura dhe entet private, duke vendosur flamurin kombëtar dhe shenjatat e tyre dalluese në objektet dhe ndërtesat që disponojnë:

1.5 Në ditët e festave merren masa të veçanta për ndriçim shtesë të qyteteve, objekteve të zbukurimit, flamurëve dhe shenjave të tjera festive.

## 2. Ceremonia e ngritjes së flamurit kombëtar

2.1 Ngritja e flamurit në Vlorë më 28 Nëntor është ceremonia më solemne në Republikën e Shqipërisë. Ajo organizohet në qytetin e Vlorës çdo 5 vjet. Për organizimin e saj ngrihet një komision qeveritar i kryesuar nga Zëvendëskryeministri. Programi përfundimtar përpunohet nga Protokollit i Shtetit.

2.2 Në ceremoni marrin pjesë të ftuar:

- Personalitetet kryesore shtetërore dhe publike shqiptare;
- Trupi diplomatik rezident dhe jorezident i akredituar në Shqipëri;
- Personalitetet më në zë të diasporës dhe të trojeve shqiptare jashtë kufijve;
- Personalitete të huaja që kanë dhënë dhe japin kontribut të shquar në interes të Shqipërisë;
- Konsujt e nderit të Shqipërisë në vendet e huaja.

2.3 Ceremonia fillon në orën 10:00. Të ftuarit arrijnë më parë sipas itinerarit të përcaktuar. Organizimi i pjesëmarrjes së trupit diplomatik bëhet nga Protokollit i Shtetit.

2.4 Pranë Monumentit të Pavarësisë, në pjesën e pasme ngrihet një tendë e përkohshme, ku mbledhen personalitetet para se të fillojë ceremonia.

2.5 Me ardhjen e Presidentit të Republikës fillon ceremonia. Vargu i personaliteteve drejtohet nga Protokollit për tek vendi i ngritjes së flamurit. Ecja ceremoniale bëhet sipas skemës 4-2-1-3-5. Presidenti shoqërohet nga kryetari i bashkisë, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri dhe prefekti i Vlorës.

2.6 Presidenti i Republikës ecën jo më shumë se dy hapa para të tjerëve. Komandanti i trupprojës ushtarake të nderit i afrohet dhe i paraqet forcën. Në orën 10:00 Presidenti kryen ngritjen ceremoniale të flamurit.

2.7 Ngritja e flamurit shoqërohet nga himni kombëtar dhe përshëndetet nga 21 të shtëna artilerie. Të gjithë të pranishmit mbajnë drejtqëndrim.

2.8 Pas ngritjes së flamurit, nga të pranishmit vendosen kurora në emër të kombit shqiptar tek varri i Ismail Qemalit. Ecja e personaliteteve bëhet sipas skemës përkatëse dhe shoqërohet me marshe solemne.

2.9 Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit dhe Kryeministri zënë vend në tribunën e ngritur në këmbët e Monumentit të Pavarësisë. Të ftuarit e tjerë, trupi diplomatik, anëtarët e qeverisë, deputetë, përfaqësues të partive politike, familje patriotësh, përfaqësues të diasporës etj., janë të vendosur që më parë sipas përparësisë në tribunë.

2.10 Presidenti i Republikës u drejtohet pjesëmarrësve dhe mbarë kombit me përshëndetjen e rastit. Ceremonia mbyllet pas përshëndetjes së Presidentit.

2.11 Nëse parashikohen në program aktivitete të tjera, përrurimi i tyre bëhet sipas radhës së përparësisë nga personalitete të tjera. Në këto ceremoni marrin pjesë të gjitha personalitetet kryesore të shtetit.

2.12 Vizitat në familjet e patriotëve dhe dëshmorëve bëhen sipas programit të miratuar më parë për secilin personalitet më vete dhe jo më shumë se dy vizita. Presidenti i Republikës shoqërohet nga kryetari i bashkisë, Kryeministri nga prefekti dhe Kryetari i Kuvendit nga kryetari i qarkut.

2.13 Për nder të të gjithë pjesëmarrësve, pushteti vendor i Vlorës shtron një drekë. Kryetari i bashkisë ngre me këtë rast një dollit dhe përshëndet të gjithë të ftuarit. Ceremonia mbyllet në orën 16:00. Pjesëmarrësit shpërndahen për t'u mbledhur përsëri në Tiranë në Pallatin e Brigadave për pritjen e festës kombëtare.

### 3. Ceremonia e festës kombëtare

3.1 Me rastin e Ditës Kombëtare të Pavarësisë së Shqipërisë, Presidenti i Republikës jep një pritje shtetërore, e cila organizohet në Pallatin e Brigadave më 28 nëntor, ora 19:30. Organizimi ceremonial i festës dhe respektimi i përparësisë zyrtare bëhet nga Protokolli i Shtetit.

3.2 Të ftuar të Presidentit janë:

- Trupi diplomatik rezident dhe jorezident i akredituar në Republikën e Shqipërisë;
- Personalitetet kryesore të shtetit, politikës, kulturës, artit dhe letërsisë në Shqipëri, sipas përparësisë;
- Personalitetet më në zë të diasporës dhe trojeve shqiptare jashtë kufijve;
- Personalitete të huaja që kanë dhënë dhe japin kontribut të shquar në interes të Shqipërisë;
- Konsujt e nderit të Shqipërisë në vendet e huaja dhe ata që përfaqësojnë vendet e huaja në Shqipëri;
- Pjesëmarrja e të ftuarve është së bashku me bashkëshortet. Në rast të kundërt, ftesa është e patransferueshme.

3.3 Të ftuarit fillojnë të grumbullohen në ambientet e Pallatit të Brigadave pas orës 19:00. Në ora 19:30 jepet sinjali i fillimit. Hapen dyert e sallës së Skënderbeut dhe të ftuarit hyjnë në sallë. Ata priten në radhë nga Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit dhe Kryeministri me bashkëshortet (ose vetëm).

3.4 Mikpritja e autoriteteve të larta zgjat 30 minuta, pastaj ata prishin radhën dhe bashkohen me të ftuarit. Kushdo që vjen pas këtij momenti duhet t'i takojë duke kërkuar ndjesë për vonesën.

3.5 Në orën 20:00 Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit dhe Kryeministri me bashkëshortet e tyre (ose vetëm), shkojnë në krye të sallorit ku është vendosur mikrofonit.

3.6 Ekzekutohet himni kombëtar vetëm me muzikë. Përshëndet Presidenti i Republikës (5 min.). Përshëndetja e tij shoqërohet nga përkthimi në anglisht për trupin diplomatik. Pas përshëndetjes Presidenti ngre një doli urimi për të gjithë të ftuarit.

3.7 Të tre autoritetet e larta përshëndesin të ftuarit duke lëvizur në të gjitha mjediset e sallës së pritjes. Gjatë ceremonisë një grup muzikor ekzekuton pjesë të ndryshme muzikore.

3.8 Presidenti largohet i pari nga festa, pasi përshëndetet me personalitetet kryesore të huaja dhe të vendit (rreth orës 21 :30-22:00) Pas Tij mund të fillojnë të largohen edhe të ftuarit e tjerët sipas dëshirës.

3.9 Veshja e të ftuarve në këtë pritje rekomandohet të jetë kostum i errët, smoking ose kostum kombëtar.

3.10 Me rastin e festës kombëtare të vendeve të tjera Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri dhe Ministri i Punëve të Jashtme u dërgojnë telegrame urimi homologëve të tyre. Drejtoria përkatëse në Ministrinë e Punëve të Jashtme ndihmon në këtë drejtim.

3.11 Telegrami përgatitet dhe firmoset në gjuhën shqipe, shoqërohet me një përkthim jozyrtar dhe i dorëzohet përfaqësisë diplomatike përkatëse në Tiranë, ose i dërgohet përfaqësisë sonë diplomatike në vendin përkatës.

### 4. Ceremonia e pritjes së Vitit të Ri Diplomantik

4.1 Brenda 15 ditëshit të parë të muajit janar të çdo viti, Presidenti i Republikës jep për trupin



diplomatik një pritje me rastin e Vitit të Ri. Pritja organizohet në Pallatin e Brigadave. Organizimi i saj dhe respektimi i përparësisë bëhet nga Protokolli i Shtetit.

4.2 Në pritje, përveç trupit diplomatik, ftohen të marrin pjesë edhe personalitetet më të larta shtetërore, si dhe përfaqësues të shquar të shkencës, kulturës, artit etj. Ftesat bëhen çift.

4.3 Të ftuarit futen në sallën Skënderbeu duke filluar nga ora 18:30. Në orën 19:00 lajmërohet me zë dhe futet në sallë, nga kreu i saj, Presidenti i Republikës me bashkëshorten i shoqëruar nga Ministri i Punëve të Jashtme me bashkëshorten. Të ftuarit duartrokin. Dekani i trupit diplomatik afrohet dhe përshëndetet i pari me Presidentin e Republikës dhe i uron Vitin e Ri.

4.4 Të tre zënë vend pranë mikrofonit në krye të sallës. Dekani vendoset në të djathtë të Presidentit, kurse Ministri i Punëve të Jashtme në të majtë.

4.5 Presidenti i Republikës përshëndet të ftuarit (5 min). Mund ta marrë fjalën edhe dekani i trupit diplomatik, i cili përshëndet në emër të trupit diplomatik (3 min). Në fund ngrihet doli dhe Presidenti kalon dhe uron të gjithë trupin diplomatik të pranishëm dhe të ftuarit e tjerë.

4.6 Mundet që Presidenti të bëjë audienca të shkurtra në këmbë (2min) me titullarë të ndryshëm të trupit diplomatik. Në to mund të marrin pjesë, sipas rastit, Kryeministri ose Ministri i Punëve të Jashtme.

4.7 Presidenti i Republikës largohet i pari. Të tjerët fillojnë të largohen pas Tij.

4.8 Pritja shoqërohet me muzikë nga grupe të vogla muzikore. Veshja e të ftuarve rekomandohet të jetë kostum i errët, smoking ose kostum popullor.

## 5. Ceremonia e vendosjes së kurorave tek "Nëna Shqipëri"

5.1 Në nderim të dëshmorëve të kombit, ditën e festës së Çlirimit të Atdheut, me 29 Nëntor të çdo viti dhe ditën e dëshmorëve të kombit me 5 Maj të çdo viti, Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, Ministri i Mbrojtjes dhe Prefekti, Kryetari i Bashkisë, kryetari i Këshillit të Qarkut, si dhe organizatat e veteranëve, vendosin kurora në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit në Tiranë.

5.2 Kjo ceremoni ka vlera simbolike dhe gjatë vendosjes së kurorave mbahet qetësi e thellë nga pjesëmarrësit.

5.3 Kurora e rangut më të lartë vendoset e para. Kurora e Presidentit të Republikës vendoset në titull personal, të tjerat vihen në emër të institucioneve përkatëse. Kurorat e autoriteteve kryesore të shtetit mbahen nga truporjë nderi.

5.4 Ceremonia në përmendoren "Nëna Shqipëri" fillon në orën 10:00. Vendosen këto kurora sipas radhës:

Presidenti i Republikës, vetëm

Kryetari i Kuvendit dhe një person tjetër

Kryeministri dhe një person tjetër

Ministri i Mbrojtjes dhe Shefi i Shtabit

Prefekti dhe një person tjetër

Kryetari i Bashkisë dhe një person tjetër

Kryetari i Këshillit të Qarkut dhe një person tjetër

Organizatat e veteranëve dhe dëshmorëve të atdheut

5.5 Marshet funebre shoqërojnë ecjen ceremoniale. Himni kombëtar ekzekutohet kur të gjithë kanë mbaruar vendosjen e kurorave. Truproja e nderit është e pranishme gjatë ceremonisë në të majtë të

qillimit.

5.6 Në mënyrë të përsëritur çdo 29 Nëntor, vendos një kurorë edhe trupi diplomatik i akredituar në Republikën e Shqipërisë. Gjatë ceremonisë së vendosjes së kurorës nga dekani i trupit diplomatik, marshe funebre shoqërojnë ecjen dhe himni kombëtar ekzekutohet në fund të ceremonisë. Në ceremoni nuk ka trupojë nderi.

5.7 Bashkia e Tiranës është përgjegjëse për përgatitjen e dekorit tek Varrezat e Dëshmorëve të Kombit dhe rrugët që të çojnë atje. Në të gjitha qytetet e Shqipërisë bëhet e njëjta ceremoni nga autoritetet më të larta vendore.

## 6. Ceremonia e festës së Pezës

6.1 Festa e Pezës organizohet çdo vit, më 16 Shtator në Pezë. Ceremonia organizohet nga pushteti vendor i Tiranës dhe komuna e Pezës.

6.2 Çdo vit jubilar (5 vjet), për organizimin e festës ngrihet një komision qeveritar i kryesuar nga Zëvendëskryeministri. Protokollin i Shtetit merret me hartimin dhe zbatimin e programit. Ftohen të marrin pjesë personalitetet kryesore të shtetit.

6.3 I ftuari më i lartë në rang që përshëndet pjesëmarrësit është Kryeministri, të cilit ia jep fjalën kryetari i komunës së Pezës. Për të përshëndetur, më pas e merr fjalën përfaqësuesi i organizatës së veteranëve të luftës. Ceremonia mbaron pas kësaj përshëndetjeje.

6.4 Autoritetet e larta vizitojnë shtëpinë muze të konferencës, vënë buqeta me lule tek varri i Myslym Pezës dhe kurora tek monumenti. Pushteti vendor shtron një drekë për autoritetet e ftuara.

6.5 Vendosjen në tribunën e manifestimit jubilar e përcakton Protokollin i Shtetit. Festimet pas ceremonisë organizohen nga Bashkia e Tiranës.

## 7. Parada jubilarë e Forcave të Armatosura

7.1 Ceremonia jubilarë e paradës së Forcave të Armatosura të Republikës mbahet ë herë në pesë vjet, më 29 Nëntor. Parada e Forcave të Armatosura të Republikës dhe ceremonia organizohen nga strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes.

7.2 Tribuna e nderit ngrihet në bulevardin " Dëshmorët e Kombit" dhe ndahet në tre sektorë kryesorë:

Në tribunën A zënë vend personalitetet kryesore të shtetit.

Radha e parë: Presidenti i Republikës, Kryeministri, Ministri i Mbrojtjes, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Kryetari i Kuvendit, Zëvendëskryeministri, Ministri i Jashtëm, Ministri i Rendit Publik, komandanti i FT, komandanti i FA, komandanti i FD, ish-presidentët e Republikës, Ministri i Financave, Ministri i Ekonomisë, Ministri i Drejtësisë, Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës, Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit, Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit, Ministri i Arsimit dhe i Shkencës, Ministri i Shëndetësisë, Ministri i Pushtetit Vendor, Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale, Ministri i Bujqësisë, Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministri i Mjedisit, Ministri i Shtetit për Integrimin, Ministri i Shtetit pranë Kryeministrit dhe Kryetari i Bashkisë së Tiranës.

Radha e dytë: Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, nënkryetarët e Kuvendit, zëvendësministri i Mbrojtjes, komandanti i TRADOC, zëvendësministri i Punëve të Jashtme, gjeneralë të Forcave të Armatosura me dy yje, kryetarët e grupeve parlamentare (4), kryetari i SHISH, kryetarët e klerit (4),

Prokurori i Përgjithshëm, kryetari i Kontrollit të Shtetit, kryetari i Gjykatës së Kasacionit, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Avokati i Popullit, ish- kryeministra, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

Radha e tretë: Gjeneralë veteranë (10), kryetarë të partive parlamentare, Sekretari i Përgjithshëm i Presidencës, Sekretari i Përgjithshëm i Kryeministrit, prefekti i Tiranës, këshilltari ushtarak i Presidentit, ish-ministra të mbrojtjes jo në detyrë, ish-ministra të jashtëm jo në detyrë, drejtorë të Ministrisë së Mbrojtjes me gradën Kolonel.

Në Tribunën B zë vend trupi i huaj diplomatik.

Në radhën e parë, ambasadorët e akredituar sipas presecancës së tyre. Atashetë ushtarakë të akredituar, drejtori i Protokollit të Shtetit.

Në radhën e dytë, përfaqësuesit e misionëve ushtarakë, komandanti i NATO, MTL, ODC, NATO-PFP CELL, SAIC, UNDP dhe të ftuar të tjerë me shtetësi të huaj.

Në tribunën C zënë vend personalitete të tjera të vendit. Komisioni parlamentar i mbrojtjes, deputetë, këshilltarë të Presidentit dhe Kryeministrit, sekretarë të përgjithshëm të ministrive, drejtorë në Ministrinë e Mbrojtjes, ish-ministra.

## 8. Zija kombëtare

8.1 Zija është një ceremoni solemne e respektit shtetëror e qytetar që zhvillohet në frymën e vlerave më të larta humane dhe parimeve universale të të drejtave të njeriut, demokracisë dhe lirisë të përcaktuara nga kushtetuta.

8.2 Zi kombëtare mbahet për:

- Personalitete të larta shtetërore e publike kombëtare;
- Personalitete të shquara të komunitetit ndërkombëtar me origjinë shqiptare;
- Njerëz që sakrifikojnë jetën e tyre në krye të detyrës;
- Fatkeqësi të rënda njerëzore që prekin thellë ndërgjegjen e kolektivitetit;
- Për çdo rast tjetër me vendim të Këshillit të Ministrave.

8.3 Zija kombëtare shpallet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe i komunikohet trupit diplomatik nëpërmjet Protokollit të Shtetit. Sipas rastit përcaktohet ngritja e një komisioni të veçantë për organizimin e ceremonisë funebre.

8.4 Kohëzgjatja e zisë përcaktohet nga Këshilli i Ministrave. Normalisht zija për vdekjen e një presidenti të republikës është një ditë pune, por mund të zgjatet në raste të veçanta deri në tri ditë.

8.5 Zija kombëtare është e detyrueshme për trupin diplomatik dhe të gjitha institucionet shtetërore qendrore dhe vendore. Komisioni i krijuar në këtë rast përcakton të gjitha modalitetet e ceremonisë zyrtare funebre, komunikatën për shtyp dhe nekrologjinë e të ndjerit.

8.8 Format e manifestimit të zisë kombëtare janë të përshkallëzuara. Flamuri kombëtar vendoset në gjysmështizë në të gjitha objektet publike. Flamurit i lidhet fjonjo kuq e zi.

8.9 Manifestohen edhe forma të tjera:

Një minutë (ose më shumë) heshtje në salla dhe auditorë publike, si parlament, zyra, universitete, bashki, vende pune, shkolla, kazerma.

Mbyllje e pjesshme ose totale e lokaleve të shfaqjeve të ndryshme artistike me muzikë të lehtë.

Një minutë ndalim i të gjitha aktiviteteve publike në orën 12:00 ose gjatë zhvillimit të ceremonisë funebre.

Ekzekutim për një kohë të caktuar në radio dhe TV vetëm i muzikës funebre.

Vendosje e një fashoje të zezë në krahun e majtë.

Emërtim i shesheve, rrugëve, objekteve, instituteve, shkollave me emrin e të ndjerit. Ngritje monumenti ose lapidari përkujtimor.

8.10 Ceremonitë funebre shtetërore dhe zyrtare përballohen nga Këshilli i Ministrave. Të gjitha të tjerat përballohen nga administrata e institucionit përkatës.

8.11 Në homazhe zyrtare, funerale ose gjatë ceremonisë së varrimit marrin pjesë personalitete shtetërore ose personalitete zyrtare të huaja të ardhura me këtë rast. Me dëshirën e tij mund të marrë pjesë edhe trupi diplomatik i akredituar në Republikën e Shqipërisë. Për homazhe nga trupi diplomatik hapet një Libër Ngushëllimi.

8.12 Zija qytetare shpallet nga administrata vendore. Vdekja e një prefekti, kryetari bashkie apo drejtuesi tjetër vendor të administratës shtetërore, është me vend të përkujtohet me një ceremoni funebër nga autoritetet vendore.

8.13 Zija qytetare ka një shtrirje të kufizuar në kohë dhe territor. Organizimi i saj bëhet nga pushteti vendor.

8.14 Gjatë zisë qytetare ulet në gjysmështizë vetëm flamuri i institucionit që ka shpallur zinë (jo flamuri kombëtar) dhe flamuri i institucioneve të tjera që e përkrahin dhe bashkohen me të.

## 9. Ceremonitë funebre

9.1 Ceremonitë funebre në Republikën e Shqipërisë janë shtetërore, zyrtare, ushtarake dhe jo të plota zyrtare e ushtarake. Të gjitha tipet janë ceremoni të rëndësishme, të cilat programohen deri në imtësitë më të vogla për të ruajtur solemnitetin dhe manifestuar respektin e merituar.

Ceremonitë ushtarake organizohen nga protokollit i Ministrisë së Mbrojtjes.

9.2 Rangjet të cilave u takon t'u bëhet funeral shteti janë:

- Presidenti i Republikës në detyrë.
- Presidenti i Republikës i emëruar.
- Kryetari i Kuvendit në detyrë.
- Kryetari i Këshillit të Ministrave në detyrë.
- Kryetari i Këshillit të Ministrave i emëruar.
- Çdo personalitet tjetër që përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

9.3 Personaliteteve që u kryhet funeral shtetëror varrosen në Varrezat e Kombit në aneksin e njerëzve të shquar të tij.

9.4 Në rastin e ceremonisë mortore që organizohet për një president në detyrë, kryetar kuvendi ose kryeministër, arkivoli vendoset në shtratin e topit i mbuluar me flamur kombëtar dhe shoqërohet nga truproja e nderit të Republikës.

9.5 Ulja e arkivolit në varr shoqërohet me të shtëna nga truproja e nderit. Të gjitha personalitetet zyrtare pjesëmarrëse në ceremoni duhet të vendosin një shirit të zi në krahun e majtë. Ushtarakët marrin drejtqëndrim. Nderimi me të shtëna arme u rezervohet:

- Presidentit të Republikës 21 të shtëna
- Kryetarit të Kuvendit 19 të shtëna
- Kryeministrit 19 të shtëna
- Ministrave 15 të shtëna
- Shefit të Shtabit të Përgjithshëm 15 të shtëna

9.6 Pjesëmarrja në këtë ceremoni kërkon detyrimisht veshje të errët (kostum dhe kravatë të errët, këmbishë të bardhë dhe këpucë të zeza, pallto ose pardesy të errët). Për ushtarakët parashikohet uniforma ceremoniale.

9.7 Në të gjitha përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit hapet Libri i Ngushëllimeve. Nëse në ceremoni marrin pjesë kryetarë shteti të huaj, ata trajtohen sipas kësaj skeme: priten nga Protokolli i Shtetit, pa bandë, me truporjë të reduktuar, tapet të kuq dhe shoqërohen gjatë gjithë kohës së qëndrimit deri në largim.

## 10. Ceremoni funebre shtetërore

10.1 Kur Këshilli i Ministrave vendos për kryerjen e një ceremonie shtetërore funebre dhe familja e të ndjerit e pranon këtë lloj funerali, ngrihet një komision, ku bën pjesë edhe Protokolli i Shtetit.

10.2 Protokolli i Shtetit koordinon punën me Gardën e Republikës, Bashkinë e Tiranës, Drejtorinë e Policisë së Qarkut, Zyrën e Shtypit të Kryeministrit, për zhvillimin e ceremonisë funebre.

10.3 Trupi i të ndjerit vendoset në hollin e Pallatit të Kongreseve ose në ndonjë rezidencë tjetër qeveritare në bulevardin "Dëshmorët e Kombit" (në objektin e kultit, nëse familja kërkon ceremoni fetare), ku fillojnë edhe homazhet zyrtare dhe publike për përcjelljen e tij për aq ditë sa është zija e shpallur. Rrugëkalimi i njerëzve rregullohet nga truporja e nderit me uniformë ceremoniale. Për kryerjen e homazheve publike vendoset një orar i caktuar gjatë gjithë periudhës së zisë.

10.4 Pranë trupit krijohet një vend i posaçëm për familjen dhe të afërmit e të ndjerit. Në hyrje vendoset tavolina me Librin e Ngushëllimeve. Mbi të vendoset portreti i të ndjerit dhe në të djathtë flamuri kombëtar. Në të dy krahët mbajnë drejtqëndrim dy truporja nderi.

10.5 Lëvizja e kortezhit bëhet në orën 10:00. Arkivoli i vendosur në shtrat topi, i mbuluar me flamur kombëtar nisët nga vendndodhja, i shoqëruar nga gjashtë truporja nderi, tri në çdo anë. Përpara kortezhit ecën truporja e nderit e Gardës së Republikës dhe truporjat me jastëkët e kuq të dekoratave. Pas tyre vendoset banda, që ekzekuton marshe funebër. Familjarët dhe personalitetet ecin pas shtratit të topit. Kortezhi mbyllet nga populli i thjeshtë.

10.6 Kortezhi ecën në këmbë deri tek ura e Lanës dhe prej këtej drejtohet i motorizuar tek Varrezat e Kombit. Pranë varrit janë përcaktuar vende të veçanta për familjarët, personalitetet e larta të ftuar dhe për truporjën e nderit.

10.7 Arkivoli vendoset në mbajtësen e posaçme. Truporja e nderit merr drejtqëndrim "për nder armë" gjatë lëvizjes së arkivolit. Personaliteti i caktuar bën përshëndetjen e rastit (3 min). Nga arkivoli hiqet flamuri me palosje dhe arkivoli vendoset pranë varrit.

10.8 Ulja në varr e arkivolit paraprihet nga të shtënat e nderit. Skuadra përbëhet nga 5-7 ushtarë dhe komandohet nga një oficer. Armët mbahen 45-gradë nga horizontalja, me drejtim mbi varr. Të shtënat komandohen nga oficeri i truporjës. Mbas të shtënave skuadra merr drejtqëndrim "për nder armë".

10.9 Fillon ulja e arkivolit në varr. Gjatë varrimit mbahet heshtje.

10.10 Personalitetet e pranishme ngushëllojnë familjen e të ndjerit dhe largohen. Shpenzimet e funeralit shtetëror përballohen nga Këshilli i Ministrave.

10.11 Ceremonia përmbledh këto momente kryesore:

- Rregullimi i hollit të Pallatit të Kongreseve për homazhet.
- Lista e pjesëmarrësve, personalitete, të huaj, miq, familjarë.
- Njoftimi i trupit diplomatik.

- Ceremonia fetare, nëse është e nevojshme dhe mënyra e vendosjes së pjesëmarrësve.
- Rregullimi i shtratit të topit dhe flamurit që do të mbulojë arkivolin.
- Rrugëkalimi i kortezhit të përmortshëm.
- Oficeri drejtues.
- Truproja e nderit.
- Banda e Republikës.
- Motoçikletat e shoqërimit.
- Bërja gati e vendvarrimit në Varrezat e Kombit.
- Mbajtësit e arkivolit.

## 11. Ceremoni funebre zyrtare

11.1 Ceremonitë funebre zyrtare organizohen për personalitete të cilët nuk janë të përfshirë në pikën 9.5. Shpallja e zisë përcaktohet nga Këshilli i Ministrave.

11.2 Ceremonia e homazheve organizohet (me lejen e familjes), në institucionin përkatës, ku vendoset arkivoli dhe hapet Libri i Ngushëllimeve. Në orën e caktuar, kortezhi i përmortshëm nis drejt varrezave i eskortuar vetëm nga patrulla policore.

11.3 Kjo ceremoni nuk përmban bandë, truprojë nderi dhe të shtëna me armë. Në varreza marrin pjesë personalitete të larta të shtetit. Pas mbajtjes së përshëndetjes së fundit, arkivoli zbret në varr. Pjesëmarrësit qëndrojnë në heshtje deri në fund dhe pasi përshëndeten me familjen, largohen.

11.4 Organizimi i ceremonisë dhe shpenzimet e funerals përballohen nga institucioni përkatës.

## 12. Vdekja e një personaliteti të huaj

12.1 Nëse një personalitet i lartë i huaj ndërron jetë, homologët shqiptarë dërgojnë në misionin përkatës diplomatik të akredituar në Tiranë nga një përfaqësues të tyre për të shprehur ngushëllimet e rastit dhe për të bërë shënimin përkatës në librin e hapur me këtë rast. Ata shkruajnë mesazhin, për të cilin janë ngarkuar, emrin e personalitetit që përfaqësojnë dhe mundësisht lënë edhe kartëvizitën.

12.2 Nëse ndërron jetë një kryetar shteti, qeverie ose ministër i punëve të jashtme, Ministri shqiptar i Punëve të Jashtme viziton personalisht ambasadorin përkatës. Homologu shqiptar bën ngushëllime personalisht dhe nënshkruan në Librin e Ngushëllimeve. Autoritetet e tjera mund të dërgojnë sipas dëshirës një përfaqësues.

12.3 Përfaqësuesit e lartë të shtetit mund të shkojnë në ceremoninë e varrimit të një personaliteti të lartë politik të një shteti tjetër. Niveli i përfaqësimit duhet t'i përmbahet rangut të personalitetit të huaj që ka ndërruar jetë.

12.4 Në rast vdekjeje të një kardinali, ngushëllimet i drejtohen nuncit apostolik. Kryeministri i dërgon mesazh sekretarit të shtetit të Vatikanit, kurse Presidenti i Republikës i drejtohet Papës.

## 13. Ceremonitë funebre në Republikën e Shqipërisë

Tipi

Rangu Shteti Zyrtare Ushtarake Zyrtare ose  
ushtarake jo e  
plotë  
President i  
Republikës X  
Kryetar  
Kuvendi X  
Kryeministër  
X

President i zgjedhur i Republikës X

Rast i veçantë sipas  
vendimit të Këshillit të  
Ministrave X  
Anëtar, kryetar i  
Gj. Kushtuese X

Ish-president, ish-kryetar Kuvendi, ish-kryeministër X

Nënkryetar  
Kuvendi, deputet X  
Zv/Kryeministër  
X

Ministër i Punëve të Jashtme X  
Ministër, deputetë dhe të barabartë në rang X  
Shefi i Shtabi të Ushtrisë  
X

Emërtesa të Presidentit  
dhe Kryeministrit sipas  
vendimit të Këshillit të  
Ministrave X

X

X

Gjeneral

Komandant divizioni X

Ish-drejtues në pension  
sipas vendimit të  
institucionit X

Komandant arme  
dhe të barabartë X

Ish-oficerë madhorë në  
pension. Sipas rregullores  
së Ministrisë së Mbrojtjes X

X

Gradat e ulëta.  
Sipas rregullores të M.M  
dhe M.R.P X

## ANEKS PRIVILEGJE DHE IMUNITETE

### 1. Pajisja me kartë identiteti

1.1 Me arritjen e anëtarëve të rinj të përfaqësive diplomatike, organizatave ndërkombëtare të akredituara në Shqipëri, njoftohet menjëherë Ministria e Punëve të Jashtme me anë të një note verbale ku tregohet pozicioni i tij i ri ose në rastin kur zëvendëson një anëtar, i cili ka mbaruar misionin e tij në Shqipëri. Në notë shënohet emri dhe funksioni e këtij personi.

1.2 Për atashetë ushtarakë, anëtarë të përfaqësive diplomatike, duhet të merret akredimi nga Ministria e Mbrojtjes.

1.3 Paraqitet kërkesa për pajisjen me kartë identiteti pranë Drejtorisë së Protokollit të Shtetit, në Ministrinë e Punëve të Jashtme nga përfaqësia përkatëse.

1.4 Kartat e identitetit lëshohen vetëm pasi është dhënë viza e qëndrimit nga Drejtoria Konsullore e Ministrisë së Punëve të Jashtme, me përjashtim kur me marrëveshje dypalëshe parashikohet ndryshe.

1.5 Kërkesa bëhet me notë verbale të përfaqësisë diplomatike përkatëse duke bashkëlidhur:  
- Formularin "ID\*- 2002" të plotësuar nga vetë anëtari i ri dhe të nënshkruar dhe vulosur nga shefi i përfaqësisë, në dy kopje origjinale me fotografi të ngjitura në secilën kopje (shih



formularin ID\*- 2002 në aneksin 1).

- Dy copë fotografi me ngjyra me format 37 mm x 43 mm.

1.6 Kartat e identitetit lëshohen për një afat minimum 6-mujor dhe maksimum dy vjeçar.

Por afati maksimal i vlefshmërisë së tyre në çdo rast do të jetë në vartësi të afatit të vlefshmërisë së pasaportës të anëtarit të përfaqësisë për të cilin kërkohet karta.

1.7 Me mbarimin e vlefshmërisë, karta së bashku me kërkesën zyrtare për rinovim, i dërgohet Drejtorisë së Protokollit të Shtetit, duke ndjekur të njëjtën procedurë sipas rregullave të përcaktuara në pikën 2.

1.8 Me karta identiteti jeshile pajisen agjentët diplomatikë rezidentë në Shqipëri, bashkëshortet dhe fëmijët e tyre, mbajtës të pasaportave diplomatike, të cilët shoqërojnë diplomatin dhe nuk janë shtetas shqiptarë, agjentët diplomatikë jorezidentë të akredituar në Republikën e Shqipërisë.

1.9 Me karta identiteti të verdha pajisen mbajtësit e pasaportave të shërbimit dhe speciale, duke përfshirë anëtarët e familjeve të tyre që banojnë me ta dhe që nuk janë shtetas shqiptarë.

1.10 Me karta identiteti blu pajisen konsujt e nderit pavarësisht nga shtetësia e tyre.

1.11 Me karta identiteti rozë pajisen anëtarët e misioneve të organizatave ndërkombëtare mbajtës të pasaportave të zakonshme që nuk janë shtetas shqiptarë.

1.12 Kur bëhet kërkesë për pajisjen me kartë identiteti të atasheve ushtarakë, kjo duhet të shoqërohet edhe me fotokopjen e akreditimit dhënë nga Ministria e Mbrojtjes.

1.13 Në rastin kur një anët ar i një përfaqësie diplomatike ose i një organizate ndërkombëtare mbaron misionin e tij, është i detyruar të dorëzojë kartën e identitetit diplomatik.

1.14 Kur një anëtar i një përfaqësie diplomatike ose organizate ndërkombëtare humb kartën e identitetit, duhet të bëhet menjëherë denoncimi pranë komisariatit të policisë.

1.15 Kur karta e identitetit dëmtohet ose del jashtë përdorimit, zëvendësohet me një të re. Për këtë ndiqet e njëjta procedurë si për pajisjen për herë të parë.

1.16 Kartat e identitetit duhet të kthehen në Drejtorinë e Protokollit të Shtetit pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme kur mbaron afati i vlefshmërisë së saj ose 3 - 4 ditë përpara largimit të mbajtësit të saj.

## 2. Përcaktimi i familjes

2.1 Në Republikën e Shqipërisë gëzojnë të drejtën e privilegjeve dhe imunitetit diplomatik bashkëshortja e anëtarit të përfaqësisë diplomatike ose konsullore, fëmijët e tij të pamartuar nën moshën 18 vjeç, raste të fëmijëve me të meta mendore dhe që banojnë nën të njëjtën strehë me primarin.

2.2 Fëmijët e anëtarëve të përfaqësisë diplomatike e konsullore të moshës 18 deri 23 vjeç, mund të vazhdojnë të gëzojnë privilegjet dhe imunitetin, nëse vazhdojnë të ndjekin në mënyrë të plotë studimet e shkollës së lartë në Shqipëri.

2.3 Fëmijët e moshës mbi 18 vjeç, që nuk vazhdojnë shkollën ose të moshës mbi 23 vjeç, pasi të kenë mbaruar studimet e larta, nuk mund të vijojnë të kenë privilegjet dhe imunitetin, por mund të vazhdojnë të qëndrojnë në Shqipëri me statusin e vizës së vizitorit.

2.4 Çdo anëtar tjetër i familjes që mund të ketë lidhje gjaku me primarin, por nuk bën pjesë në personat e mësipërm, nuk gëzon statusin e privilegjeve apo imunitetin.

## 3. Punësimi i pjesëtarëve të familjes së diplomatit

3.1 Në Republikën e Shqipërisë lejohet të punësohen pjesëtarët e aftë për punë të familjeve të anëtarëve të përfaqësive diplomatike dhe organizatave ndërkombëtare kur ka marrëveshje dypalëshe dhe respektohet reciprociteti.

3.2 Leja e punës jepet në respektim të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe miratimit nga Protokollin e Shtetit të kërkesës së paraqitur.

#### 4. Shërbyesit privatë

4.1 Personeli diplomatik e konsullor i huaj në Shqipëri mund të sjellë me vete shërbyes të huaj nga vendi i origjinës ose nga një shtet i tretë. Pajisja e tyre me vizë hyrëse në Shqipëri dhe statusi i qëndrimit përcaktohen mbi bazën e reciprocitetit.

4.2 Të gjithë shërbyesit privatë, qofshin edhe shqiptarë, të punësuar nga personeli diplomatik i përfaqësive të huaja, i duhen bërë të njohur Protokollit të Shtetit. Në përputhje me këtë dërgohet në Protokollin e Shtetit, jo më vonë se 15 ditë nga fillimi i punës, dokumenti përkatës "Letër punësimi".

4.3 Nuk ka limit në marrjen në punë të personelit shërbyes. Shpërblimi i tyre duhet të parashikojë edhe të gjitha përfitimet e tjera si sigurimet shoqërore, shëndetësore që iu takojnë sipas legjislacionit shqiptar të punës në fuqi.

4.4 Shërbyesit e huaj të punësuar nga personeli i përfaqësive diplomatike në Shqipëri, pajisen me kartën e tyre të identitetit ngjyrë portokalli.

#### 5. Pajisja me targa TD, TK dhe TR (jeshile)

5.1 Numri i automjeteve të importuara apo të blera në vend, nga misionet diplomatike, organizatat ndërkombëtare, të nevojshme për përdorim zyrtar, duhet të jetë i arsyeshëm dhe në varësi të madhësisë dhe nevojave të misionit, por në çdo rast numri i tyre nuk mund të kalojë numrin e stafit diplomatik të tij. Automjeteve u jepen targa TD, TK ose TR (jeshile). Ky rregull zbatohet edhe për automjetet e importuara apo të blera në vend nga agjencitë e specializuara të OKB-së, të cilave u jepet targa TD.

5.2 Shefat e misioneve diplomatike dhe organizatave ndërkombëtare, që me marrëveshje dypalëshe janë të barazuara me misionet diplomatike, mund të importojnë në emër të tyre, pa taksa doganore dhe taksa të tjera, dy automjete për përdorim personal, ku njëra konsiderohet për bashkëshortin e tij/e saj, të cilave u jepet targa TD.

5.3 Përfaqësitë diplomatike, konsullatat e nderit, organizatat ndërkombëtare, si dhe agjencitë e specializuara të OKB-së në Shqipëri, mund të shesin një automjet të importuar pa doganë, qoftë ajo edhe e shërbimit zyrtar apo personal, pas kalimit të një periudhe kohe minimum 2 vjet nga importimi pa doganë ose nga shitja e fundit pa doganë e një autoveture, mbi bazën e reciprocitetit.

5.4 Shefat e agjencive të specializuara të OKB-së në Shqipëri mund të importojnë në emër të tyre, pa taksa doganore dhe taksa të tjera, një automjet për përdorim personal, së cilës i jepet targa TD. Një automjet tjetër shtesë mund të importohet ose të blihet në vend, pa taksa doganore dhe taksa të tjera, nëse ato janë të shoqëruara nga bashkëshortja/i.

5.5 Anëtarët e përfaqësive diplomatike, organizatave ndërkombëtare, agjencive të specializuara të OKB-së, mbajtës të pasaportave diplomatike, mund të importojnë ose të blejnë në vend, pa taksa doganore dhe taksa të tjera, ekskluzivisht për përdorim të tyre, një automjet. Një aut omjet tjetër

shtesë mund të importohet ose të blihet në vend, pa taksa doganore dhe taksa të tjera, nëse anëtari është i shoqëruar nga bashkëshorti i tij/i saj. Automjeteve u jepet targa TD dhe TK.

5.6 Anëtarët e përfaqësive diplomatike, organizatave ndërkombëtare dhe agjencive të specializuara të OKB-së, mbajtës të pasaportave të shërbimit apo speciale, do të lejohen të importojnë ose të blejnë në Shqipëri pa doganë, një automjet, menjëherë mbas marrjes së detyrës ose vetëm brenda gjashtë muajve nga dita e mbërritjes së tyre në Shqipëri. Automjeteve u jepet targa TR (jeshile).

5.7 Kërkesa për pajisjen me targa TD, TK ose TR (jeshile) të makinave personale, bëhet vetëm pas pajisjes me kartë identiteti të anëtarit dhe bashkëshortit/es të përfaqësive diplomatike, organizatave ndërkombëtare, agjencive të specializuara të OKB-së, nga Protokollin e Shtetit.

5.8 Konsujt e nderit, pavarësisht nga shtetësia e tyre, përdorin një automjet të cilit i jepet targa TK për përdorim ekskluziv zyrtar të konsullatës.

5.9 Anëtarët e përfaqësive diplomatike, mbajtës të pasaportave diplomatike, mund të importojnë ose të blejnë në vend, pa taksa doganore dhe taksa të tjera, ekskluzivisht për përdorim personal, një motoçikletë. Për pajisjen e motoçikletave personale me targa TD, ndiqet e njëjta procedurë si dhe për makinat.

5.10 Organizatat ndërkombëtare dhe agjencitë e specializuara të OKB-së, mbi bazën e marrëveshjeve të nënshkruara me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, mund të importojnë automjete që përjashtohen nga taksat doganore dhe taksa të tjera, për projektet e ndryshme, veprimtaria e të cilave varet dhe mbështetet prej tyre. Këto automjete marrin targa të zakonshme shqiptare dhe përdorin si shenja dalluese inicialet apo simbolet e organizatave ose projekteve të tyre.

5.11 Një autoveturë e importuar pa taksa doganore dhe taksa të tjera, nga një përfaqësi diplomatike apo organizatë ndërkombëtare e akredituar në Shqipëri, nga një agjent i tyre diplomatik apo një anëtar i personelit administrativ dhe teknik të tyre, mund të transferohet pa taksë doganore dhe taksa të tjera tek një përfaqësi diplomatike apo organizatë ndërkombëtare e akredituar në Shqipëri, tek një agjent i tyre diplomatik apo një anëtar i personelit administrativ dhe teknik të tyre ose tek një person tjetër me status të njëjtë, ose të rieksporthet, pasi të jetë bërë njoftimi dhe veprimet përkatëse të çregjistrimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

5.12 Aksesoret, komponentët dhe pjesët e këmbimit të automjeteve të importuara, pa taksa doganore dhe taksa të tjera, nga anëtarët e personelit diplomatik dhe administrativ dhe teknik të misioneve të përmendura më sipër, konsiderohen si pjesë përbërëse e këtyre automjeteve. Në rast shitje të automjetit nga pronarët e tyre, këto pjesë shkojnë bashkë me automjetin. Në të kundërt, nëse pronari dëshiron t'i mbajë ato, ai duhet të paguajë tatimet dhe taksat përkatëse doganore.

5.13 Kur importohet një automjet për herë të parë, agjenti diplomatik ose personeli administrativ i misionit duhet ta paraqesë atë për kryerjen e veprimeve doganore. Kjo nevojitet si për regjistrimin e hyrjes së automjetit në Shqipëri, ashtu edhe për vërtetimin e datës së importimit.

5.14 Për pajisjen e automjeteve me targa TD, TK dhe TR (jeshile) dhe me leje qarkullimi, përfaqësitë diplomatike, konsullatat e nderit, organizatat ndërkombëtare, agjencitë e specializuara të OKB-së, duhet të bëjnë me notë verbale kërkesën e tyre në Protokollin e Shtetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme, duke shënuar qëllimin për të cilin do të përdoret automjeti, emrin e pronarit, tipin e tij, numrin e shasisë, ngjyrën e tij, duke i bashkë lidhur një fotokopje të vërtetimit të zhdoganimit, faturë zhdoganimi, vërtetim hyrje të makinës lëshuar nga dogana ku është zhdoganuar automjeti, si dhe fotokopjen e kartës së identitetit, në rastin kur makina është për përdorim personal. Nota duhet të dërgohet në Protokollin e Shtetit. Pas kësaj, përfaqësia diplomatike ose organizata ndërkombëtare dorëzon notën në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor. Drejtoria e

Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor në Tiranë, i pajis këto automjete me lejeqarkullimi dhe targa TD, TK apo TR (jeshile).

5.15 Në rastin kur makina shitet brenda përfaqësisë diplomatike, organizatës ndërkombëtare ose midis tyre, nota verbale e dërguar në Protokollin e Shtetit, duhet të shoqërohet nga fotokopjet e kontratës së shitblerjes, lejeqarkullimit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, si dhe fotokopjen e kartës së identitetit të personave që kanë bërë shitblerjen në rastin kur makina është për përdorim personal.

5.16 Targat TD, TK dhe TR (jeshile) nuk janë të transferueshme kur automjeti që mban ato shitet ose ndryshon pronësi në çfarëdo lloj mënyre.

5.17 Në rastet kur një anëtar i një përfaqësie diplomatike shet automjetin e tij dhe blen një tjetër, targat e automjetit të parë nuk janë të transferueshme tek automjeti i dytë.

5.18 Numri i targave do të jetë në mënyrë progresive me përjashtim të ambasadorit ose përfaqësuesit të organizatës, i cili do të mbajë në makinën e tij zyrtare dhe personale nr. 01.

5.19 Përfaqësitë diplomatike, konsullatat e nderit, organizatat ndërkombëtare, agjencitë e specializuara të OKB-së, mbas pajisjes së makinës me targa TD, TK ose TR (jeshile), duhet të njoftojnë Protokollin e Shtetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme, për numrin e targës së dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

5.20 Për drejtimin e automjeteve në territorin e Republikës së Shqipërisë, të gjithë anëtarët e përfaqësisë diplomatike, konsullatave të nderit, organizatave ndërkombëtare, agjencive të specializuara të OKB-së në Shqipëri, si dhe anëtarët e familjeve të tyre, janë të detyruar të pajisen me lejedrejtimi shqiptare, e cila bëhet mbi bazën e ekuivalencës së dëshmisë që ka anëtari i misionit nga vendi i origjinës, vetëm në rastet kur ata qëndrojnë më shumë se një vit në Republikën e Shqipërisë. Pajisja bëhet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, në rastin kur nuk janë të pajisur me lejedrejtimi ndërkombëtare.

5.22 Përfaqësitë diplomatike, konsullatat e nderit, organizatat ndërkombëtare dhe agjencitë e specializuara të OKB-së në Shqipëri, si dhe anëtarët e tyre, duhet të bëjnë sigurimin e automjetit për palë të treta.

5.23 Në rastet kur vidhet automjeti, duhet të bëhet menjëherë denoncimi pranë komisariatit të policisë dhe të njoftohet njëkohësisht Protokollin e Shtetit, shoqëruar me fotokopjen e procesverbalit të denoncimit.

5.24 Në rastet kur humbet targa e automjetit, duhet të bëhet menjëherë denoncimi pranë komisariatit të policisë dhe të njoftohet njëkohësisht Protokollin e Shtetit, shoqëruar me fotokopjen e procesverbalit të denoncimit.

5.25 Sipas rregullave ekzistuese, të gjithë anëtarët e personelit të çdo kategorie, pronarët e automjeteve pa doganë, që largohen përfundimisht nga Shqipëria, në mbarim të misionit të tyre zyrtar, në rastet kur marrin me vete automjetet, misionet e tyre, me notë verbale, duhet të kthejnë targat TD, TK dhe TR (jeshile) dhe lejet e qarkullimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor. Pas kësaj duhet të bëjnë njoftimin në Protokollin e Shtetit. Nota verbale duhet të shoqërohet nga fotokopja e dokumentit të çregjistrimit, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

## 6. Armët dhe mbajtja e tyre

6.1 Leja e mbajtjes dhe e përdorimit të armëve nga anëtarët e përfaqësive diplomatike bëhet në bazë

të reciprocitetit ose kur parashikohet me marrëveshje në rastet e anëtarëve të organizatave ndërkombëtare.

6.2 Për pajisjen me armë gjahu dhe përdorimin e tyre dërgohet një notë verbale pranë Protokollit të Shtetit, sektori i privilegjeve dhe imuniteteve. Në notë verbale duhet të jetë shkruar emri i anëtarit të përfaqësisë diplomatike, fotokopja e kartës së identitetit lëshuar nga ky sektor, si dhe marka dhe numri i armës që do të zotërohet.

6.3 Për pajisjen me leje për armëmbajtje dhe përdorimin e tyre veprohet në zbatim të urdhrit të Ministrit të Rendit nr.1288, datë 09.08.2000.

6.4 Në rastet kur personalitetet e huaja, gjatë një vizite zyrtare shoqërohen me trupprojë, i cili është i pajisur me armë, përfaqësia diplomatike me notë verbale, krahas gjeneraliteteve të trupprojës, duhet të dërgojë në Drejtorinë e Protokollit të Shtetit edhe të dhënat e armës që ai mban. Të dhënat përkatëse i përcillen Ministrisë së Rendit Publik.

## 7. Mbajtja e kafshëve shtëpiake

7.1 Anëtarët e përfaqësive diplomatike mund të sjellin në Shqipëri qenie të gjalla të çdo lloji. Lejimi i kalimit të tyre është subjekt i rregullave dhe i kufizimeve ligjore në fuqi deri në mbajtjen në karantinë të tyre.

7.2 Të tilla konsiderohen të gjithë gjitarët, shpendët, peshqit, molusqet, zvarranikët, të gjallë ose në statusin e vezës.

7.3 Personat e lartpërmendur duhet të bëjnë të ditur llojin e qenies që bashkëjeton me ta dhe të gjitha dokumentet përkatëse që vërtetojnë se është e vaksinuar dhe që gëzon shëndet të plotë.

### 7.4 Rregullat e vaksinimit:

- Qentë dhe macet duhet të jenë vaksinuar kundër tërbimit dhe sëmundjeve të tjera të rrezikshme, të paktën 30 ditë para hyrjes në Shqipëri. Konet nën 3 muaj, regjistrohen dhe vaksinohen në Shqipëri në kohën e përshtatshme.

- Të gjitha vaksinat dhe sëmundjet e kaluara duhet të jenë të reflektuara në certifikatën përkatëse veterinare të kafshës. Nëse vaksinimi është bërë në më pak se 30 ditë, i zoti duhet të mbajë kafshën të izoluar deri në kohën e duhur.

- E njëjta certifikatë veterinare që të dëshmojë shëndetin e mirë, duhet të shoqërojë edhe kategorinë e shpendëve shtëpiake.

7.5 Është e ndaluar futja dhe mbajtja në Shqipëri e qenieve të rralla dhe të mbrojtura nga ligjet kombëtare dhe ndërkombëtare. Subjektet që veprojnë në të kundërt janë të detyruar t'i kthejnë ato në vendin nga i kanë sjellë duke përballuar tërë shpenzimet përkatëse.

## 8. Rimbursimi i TVSH-së

8.1 Rimbursimi i tatimit mbi vlerën e shtuar nga përfaqësitë diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë bëhet në bazë të legjislacionit në fuqi.

## 9. Posta dhe valixhja diplomatike

9.1 Shkëmbimi i valixhes diplomatike do të bëhet në transitin e Aeroportit të Rinasit.

9.2 Përfaqësuesi i përfaqësisë diplomatike, i pajisur me kartë të posaçme identifikimi do të

futet në transitin e aeroportit, ku do të takohet me personin i cili sjell me vete çantën diplomatike.

9.3 Posta diplomatike do të merret nga përfaqësuesit e përfaqësive diplomatike dhe organizatave ndërkombëtare të akredituara në Tiranë, në kargo.

9.4 Ndalohet hyrja në pistë e personave dhe e automjeteve.

9.5 Protokollin i Shtetit pajis me karta të posaçme, ngjyrë të bardhë, të gjithë personat e ngarkuar për tërheqjen e valixhes diplomatike nga përfaqësuesit diplomatike të akredituara në Tiranë.

9.6 Karta për tërheqjen e valixhes diplomatike konsiderohet e vlefshme vetëm kur është e shoqëruar me kartën e identitetit diplomatik ose të shërbimit lëshuar nga Protokollin i Shtetit.

9.7 Pajisja me kartë për tërheqjen e valixhes ose postës diplomatike bëhet me anë të një note verbale nga përfaqësia diplomatike drejtuar Protokollit të Shtetit. Nota duhet të shoqërohet edhe me fotokopjen e kartës së identitetit të personit. Afati i saj skadon me afatin e kartës së identitetit të lëshuar nga Protokollin i Shtetit.

## TABELA DHE SKEMA

Vendosja e kurorave tek monumenti "Nënë Shqipëri"

8 Veteranët

7 Këshilli i Qarkut

6 Kryetari i Këshillit të Qarkut

5 Institucioni i prefektit

4 Prefekti

3 Kryeministria

2 Kryeministri

1 Presidenti i Republikës

2 Kryetari i Kuvendit

3 Kuvendi

4 Ministri i Mbrojtjes

5 Shefi i Shtabit të Përgjithshëm

6 Kryetari i Bashkisë

7 Bashkia

8 Veteranët

Ceremonia

Ecje solemne me marsh funebër

Vendosja e kurorës dhe prekje me dorë e shiritit të kuq

Kthim në vendin e nisjes

Mbajtje e momentit të heshtjes

Ekzekutim i himnit kombëtar

Përkulje e lehtë para monumentit "Nënë Shqipëri"

Largim i autoriteteve sipas radhës duke takuar popullin

(kurorat mbahen nga ushtarë me uniformë ceremoniale, kurse autoriteti qëndron 1,5 m pas tyre)

1. Mbërritja e Kryeministrit. Priten nga Kryetari i Bashkisë së Tiranës dhe Komandanti i Gardës së Republikës (1).
2. Kryeministri ecën mbas ushtarëve që mbajnë kurorën. Delegacioni vjen mbas tij. Ekzekutohen marshe funebër (2).
3. Delegacioni qëndron në një radhë (3).
4. Kryeministri qëndron (4).
5. Ushtarët vendosin kurorën (5). Kryeministri rregullon kurorën dhe kthehet në pozicionin (4). Ekzekutohen të dy himnet kombëtare. Përulet. Bashkohet me delegacionin dhe ecën drejt makinave.
6. Ndahet me autoritetet shqiptare (1)

- Me mbërritjen e avionit hipin në të ambasadori i vendit përkatës dhe drejtori i Protokollit, i cili i uron mirëseardhjen autoritetit të lartë mik.

1. Zbret autoriteti mik dhe takohet me atë shqiptar (1). Ndërkohë të gjithë anëtarët e tjerë të delegacionit mik dhe ambasadori përkatës, të drejtuar nga protokollin vendas, vendosen në pozicionin (5/2) në radhë.
2. Të dy autoritetet hipin në podiumin e nderit. Miku qëndron në anën e trupprojës së nderit (2).
3. Komandanti i trupprojës së nderit i paraqet forcën autoritetit mik (3). Ekzekutohen himnet kombëtare të të dy vendeve.
4. Ecje, qëndrim dhe nderim të flamurit të nderit nga të dy autoritetit (4).
5. Prezantimi i palës shqiptare nga Kryeministri shqiptar (5/1).  
Prezantimi i delegacionit mik nga Kryeministri mik (5/2).
6. Vendosja e shtypit
7. Hipja në makina e delegacionit (sipas skemës së paracaktuar).

-----

1. Mbërritja e autoritetit mik. Drejtori i Protokollit e shoqëron dhe e prezanton me Autoritetin shqiptar. Pjesa tjetër e delegacionit drejtohet në vendin e paracaktuar për ta.
2. Të dy autoritetet takohen dhe nisen drejt podiumit të nderit.
3. Komandanti i trupprojës së nderit i paraqet forcën autoritetit mik, i cili qëndron në krahun e trupprojës së nderit. Pas paraqitjes së forcës fillon ekzekutimi i himnit kombëtar mik dhe atij shqiptar.  
Pas mbarimit të himneve të dy autoritetet kalojnë në revistë trupprojën e nderit, ndalojnë para flamurit shqiptar dhe përsëndesin me një përkulje të lehtë.  
Banda shoqëron me marsh ecjen e autoriteteve.

4. Autoriteti mik ia prezanton anëtarët e delegacionit të tij autoritetit shqiptar dhe drejtohen për në hyrjen e Pallatit të Brigadave.

5. Autoriteti shqiptar i prezanton delegacionin e tij autoritetit mik dhe hyjnë në pallat.

Protokolli shoqëron autoritetin mik dhe delegacionin përkatës në mjediset e përcaktuara për ta.

1. Autoriteti mik përshëndetet me anëtarët e delegacionit shqiptar. Të dy autoritetet drejtohen tek delegacioni mik.

2. Autoriteti shqiptar përshëndetet me anëtarët e delegacionit mik dhe hipin në podiumin e nderit.

3. Komandanti i truprojës së nderit i paraqet forcën autoritetit mik, i cili qëndron në krahun e truprojës së nderit. Pas paraqitjes së forcës fillon ekzekutimi i himnit kombëtar mik dhe atij shqiptar.

Pas mbarimit të himneve, të dy autoritetet kalojnë në revistë truprojen e nderit, ndalojnë para flamurit të nderit dhe përshëndesin me një përkulje të lehtë.

Banda shoqëron me marsh ecjen e autoriteteve.

4. Autoriteti shqiptar përshëndetet me autoritetin mik, i cili hipën në makinë dhe largohet për në aeroport.

1. Presidenti i Republikës
2. Presidenti i Federatës mike
3. Presidenti i Federatës mike
4. Presidenti i Federatës Shqiptare
5. Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë
6. Kryeministri

7. Zëvendëskryeministri
8. Ministri i Kulturës
9. FIFA
10. UEFA
11. FIFA
12. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
13. Nënkryetari i Kuvendit
14. Nënkryetari i Kuvendit
15. Ministër i Punëve të Jashtme
16. Ministri i Rendit Publik
17. Ambasadori i vendit mik
18. Ministri i Mbrojtjes
19. FIFA
20. UEFA
21. FIFA
22. Ministri i Financave
23. Ministri i Ekonomisë



24. Ministri i Drejtësisë
25. Ministri i Industrisë dhe Energjetikës
26. Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit
27. Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit
28. Ministri i Arsimit dhe i Shkencës
29. Ministri i Shëndetësisë
30. Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit
31. Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale
32. Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit
33. Ministri i Mjedisit
34. Ministri i Shtetit për Integrimin
35. Ministri i Shtetit pranë Kryeministrit
36. Kryetari i Bashkisë së Tiranës
37. Kryetari i maxhorancës parlamentare
38. Kryetari i opozitës parlamentare
39. Avokati i Popullit.

Pt. Vend i rezervuar i Protokollit të Shtetit.

Pt. Vend i rezervuar i Protokollit të Shtetit.

Në territorin e tribunës VIP, vendosen në anë të saj komandanti i Gardës së Republikës, një trupprojë e Presidentit të Republikës, një trupprojë e Kryetarit të Kuvendit dhe një e Kryeministrit.

Protokolli i Shtetit disponon dhe shpërndan për nevoja shtetërore të trupit diplomatik dhe sipas rastit për delegacione të huaja që ndodhen në Shqipëri:

1. Ballkonin kryesor në Teatrin e Operës dhe Baletit.
2. Radhën nr.3 dhe dy ballkonet anësore simetrike të sallës plenare të Pallatit të Kongreseve.
3. Radhët nr. 1 dhe nr. 2 të Teatrit Antik të Butrintit

Vendi i autoriteteve është i padelegueshëm. Shpërndarja bëhet sipas radhës së përparësisë zyrtare duke filluar nga qendra.

Formular PM1- 2003

NJOFTIMI (PËRBËRJES SË PËRFAQËSIVE)

A. Përfaqësia:

1. Emërtimi i plotë *ii*..

Përfaqësisë:

2. Adresa e plote e *ii*..

Përfaqësisë. Numri  
përkatës i telefonit;

B. Të dhënat për çdo anëtar të përfaqësisë diplomatike:

3. Emri, Mbiemri (edhe titulli. Në qoftë se  
ka) *ii*..

4. Grada dhe Funkzioni (problematika që mbulon) në përfaqësi: *iiiiiiii*

*ii*..

5. Vetëm për a. Data e paraqitjes së b. Shtete apo organizma te tjera  
ambasadorin: letrave kredenciale: ndërkombëtare ku është akredituar:

dd/mm/vv *iiiiiiiiiiiiiiiiiiii*

*ii/i./ii*

6. Emri, Mbiemri, i bashkëshortes/it dhe familjareve te tjerë

C. Adresa Private:

7. Adresa e pjatë private në *ii*  
territorin e RSH:

8. Numrat privatë te telefonit *ii*  
faksit, etj.

Nënshkrimi i Titullarit të përfaqësisë ose Vula e përfaqësisë:

Zëvendësit e tij:

....., me .....

Shënime

të Drejtorisë së Protokollit të Shtetit:

.....

.....

Data:../../.. Nënshkrimi:.....

**Formular AP'2003 (dy kopje origjinale)**

**FORMULAR KERKESE PER TARGA DHE LEJE QARKULLIMI TE AUTOMJETEVE PERSONALE**

A.PËRFAQËSIA:.....

B.TË DHËNAT PERSONALE TE PRONARIT TE AUTOMJETIT:

1. Emri: ..... 2. Mbiemri:.....

3. Funkzioni: .....

4. Ad. në Shqipëri .....

. DATA E HYRJES NE RSH: (d/m/v) ...../.../...

D. DOKUMENTI I IDENTITETIT TE PRONARIT TE AUTOMJETIT:

5. Karta e Identitetit: 6. Lëshuar më: 7. E vlefshme deri më:

(d/m/v....././.. (d/m/v....././..

? Diplomatike Nr. ....

? Shërbimi Nr. ....

? Familjar 8. Lidhja familjare:.....

E. QËLLIMI I DERGIMIT:

? Pajisje me targa GD: ? Pajisje me targa TR(jeshile): ? Pajisje me targa TR(zak,).

F. TË DHËNA PER AUTOMJETIN:

9.Tipi:..... 10.Nr.shasisë:.....

11.Nr.motorit:..... 12. Viti prodhimit:..... 13.Ngjyra:.....

G. TË DHËNAT PËR BLERJEN DHE HYRJEN E AUTOMJETIT NË SHQIPËRI:.

14. Blerë në:..... 15. Nr. Faturës:.....

16. Nr. i Vërtetimit të Hyrjes:..... 17. Lëshuar nga Pika Doganore: .....

18. Data hyrjes në Shqipëri:././ në emër të Z.....

19. Vërtetimi i Zhdoganimit (pa pagesë): 20. Lëshuar nga Dogana.....

Nr./datë././..... në emër të Z.....

I. AUTOMJETI PER TE CILIN KERKOHET LEJEQARKULLIMI DHE TARGA:

? do të merret për herë të parë.

? do të zëvendësoje automjetin ekzistues: Tipi..... Targa .....

regjistruar në Drejtorinë e Shërbimit të Transportit Rrugor më datë: ...../...../.....

Në se automjeti është çregjistruar, shënoni datën e dorëzimit të lejeqarkullimit dhe targave: ./....

Vula dhe nënshkrimi i titullarit të përfaqësisë ose zëvendësit të tij:

Tiranë, më:././.....

Drejtorisë së Shërbimit të Transportit Rrugor - Tiranë

Dakord të pajiset me lejeqarkullimi dhe targa \_\_\_\_\_

Vula dhe nënshkrimi i drejtorit të Protokollit të Shtetit

Tirane, me: ././.....

Formular AM'.2003

FORMULAR KERKESE PER TARGA DHE LEJE QARKULLIMI TE AUTOMJETEVE TE MISIONIT

A. PËRFAQËSIA: .....

B. QËLLIMI I DËRGIMIT:

? Pajisje me targa diplomatike CD ? Pajisje me targa shërbimi TR(jeshile)

C. TË DHËNA PER AUTMJETIN:.

1.Tipi:..... 2.Nr.shasisë:.....

3. Nr. i motorit:..... 4. Viti i prodhimit:..... 5. Ngjyra:.....

D. TË DHËNA PER BLERJEN DHE HYRJEN E AUTOMJETIT NE SHQIPERI:.

6. Blerë në:..... 7. Nr. Faturës:.....

8. Nr. i Vërtetimit të Hyrjes: ..... 9. Lëshuar nga Pika Doganore: .....

10. Data hyrjes në Shqipëri:././..... në emër të Misionit ose Org.....

11. Vërtetimi i Zhdoganimit (pa pagesë): 12. Lëshuar nga Dogana:.....

Nr./datë./....././..... në emër te Misionit ose Org.:.....

E. AUTOMJETI PËR TË CILIN KËRKOHET LEJEQARKULLIMI DHE TARGA:

? do të jetë shtesë në numrin e automjeteve zyrtare të Misionit ose Organizatës Ndërkombëtare

? do të zëvendësojë automjetin ekzistues: Tipi ..... Targa .....

regjistruar në Drejtorinë e Shërbimit të Transportit Rrugor më datë:./././.

Në se automjeti është çregjistruar më parë, shënoni datën e dorëzimit të lejeqarkullimit dhe targave: ./././.

Vula dhe nënshkrimi i titullarit të përfaqësisë ose zëvendësit të tij:

Tiranë, më:././.....

---

Drejtorisë së Shërbimit të Transportit Rrugor - Tiranë

Dakord të pajset me lejeqarkullimi dhe targa\_\_\_\_\_

Vula dhe nënshkrimi i drejtorit të Protokollit të Shtetit

Tiranë, më:./././.



d.../m.../v...

Vula dhe nënshkrimi i titullarit të përfaqësisë ose zëvendësit të tij:

Tiranë, më:././.....

Drejtorisë së Shërbimit të Transportit Rrugor - Tiranë

Dakord të pajiset me lejeqarkullimi dhe targa\_\_\_\_\_

Vula dhe nënshkrimi i drejtorit të Protokollit të Shtetit

Tiranë, më:././

Shënim: Lutemi plotësoni këtë formular në 2 kopje origjinale dhe së bashku me Notën Verbale të Misionit. i dërgoni ne adresën: Ministria e Punëve të Jashtme, Drejtoria e Protokollit te Shtetit. - Tiranë.

### Formular SHP - 2003

#### LETET PUNESIMI

Emër Mbiemër ..

Adresa e plote.....

Titulli i Diplomtit.....

Emri i Përfaqësisë.....

Adresa e Përfaqësisë.....

Unë marr përsipër futjen dhe qëndrimin ne Shqipëri te personave te poshtëshënuar, te cilët do te punësohen prej meje si shërbyes privat. Mbi këtë baze përgjigjem qe;

1. Punësimi i shërbyesve privat ne banesën time te jete me kohe te plote. Ata nuk do te kryej ne pune te tjera sezonale ose alternative.

2. Dokumentet e personave ne shërbimin tim te jene te vlefshëm gjate gjithë periudhës qe do te qëndrojnë ne Shqipëri.
3. Personat ne shërbim ne banesën time nuk do te transferohen ne shërbim te diplomateve te tjerë pa njoftuar me pare Ministrinë e Punëve te Jashtme, Protokollin e Shtetit.
4. Te siguroje mbulimin e gjithë shpenzimeve për udhëtimin e kthimit ne vendin e tyre te personave ne shërbimin tim privat, pasi atyre t'u këtë mbaruar leja e qëndrimit ne Shqipëri ose deri sa te miratohet nga Ministria e Punëve te Jashtme kërkesa për kalim ne shërbim te një diplomati tjetër.
5. Te njoftoj me ane te një Note Ministrinë e Punëve te Jashtme, Protokollin e Shtetit, se shërbyesit privat janë dërguar nga territori i Shqipërisë dhe te kthej kartat e tyre te identitetit.
6. Shërbyesit private te jene te mbuluar nga sigurimet shoqërore te vendit te tyre te origjinës ose te vendit tim dhe qe pagesa e sigurimit behet rregullisht.

Emri i plote i Shërbyesit Privat.....

Kombësia.....

Data dhe Vendi i Lindjes.....

Data e hyrjes ne Shqipëri.....

Data..... Vendi .....

Firma..... Miratohet.....  
e Punëdhënësit Protokollin e Shtetit

Vula e Përfaqësisë Vula e  
Protokollit

Tirane, dt.....

IMUNITETET DHE PRIVILEGJET DIPLOMATIKE DHE KONSULLORE PERBALLE LIGJIT NE  
REPUBLIKEN E SHQIPERISE

Kategoria Arrestohet



Ose  
Ndalohet Kontroll  
Ne  
Rezidence Gjobitet  
për shkelje  
trafiku Thirret  
për  
Dëshmitar Mund te  
Hetohet Anëtarët e  
Familjes  
D Diplomat Jo1 Jo Po Jo Jo Imunitet i  
plote  
Staf Teknik dhe  
Administrativ Jo1 Jo Po Jo Jo Imunitet i  
plote  
Stafi Shërbimit Po2 Po Po Po Jo-per akte zyrtar.  
Po- per te tjera2 Pa imunitet2  
K Konsull i Karrierës Jo Jo Po Jo Jo Me imunitet  
Konsull Nderi Po Po Po Jo-per akte zyrtare  
Po-per te tjerat Jo-per akte zyrtare  
Po-per te tjerat Pa imunitet  
Punonjës konsullor(vendas) Po2 Po Po Jo-per akte zyrtare  
Po- per te tjerat Jo-per akte zyrtare  
Po- per te tjerat Pa imunitet  
O  
N Stafi Organizatave  
Ndërkombëtare Jo3 Jo Po Jo Jo Me imunitet  
Staf Diplomantik Jo Jo Po Jo Jo Imunitet i  
plote  
Staff Sherbimi (vendas) Po Po Po Jo-per akte zyrtare  
Po- per te tjerat Jo-per akte zyrtare  
Po- per te tjerat Pa imunitet

---

1 (Mund te rruhet ne rastet e vetëmbrojtjes dhe parandalimit te ndonjë krimi serioz.

2 Mund te gëzojnë imunitet te plote vetëm ne baze te marrëveshjes bilaterale specifike

3 Trajtohen si diplomate kur kane status te tille

**VENDIM**  
**Nr. 735, datë 25.11.2005**

**PËR "DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 229, DATË 23.4.2004 TË  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E CEREMONIALIT ZYRTAR TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12 pika 2 dhe 49 të ligjit nr. 9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozim të Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 229, datë 23.4.2004 "Për miratimin e Ceremonialit Zyrtar të Republikës së Shqipërisë", të Këshillit të Ministrave, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 3 të kapitullit VII bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Emërtimi i titullit të kësaj pike ndryshon nga "Ceremonia e festës kombëtare", në "Ceremoniali për festat e Pavarësisë dhe çlirimit të Atdheut".

b) Në fillim të përmbajtjes së pikës 3 shtohet një paragraf i ri "3.a", me këtë përmbajtje:

"3.a Në përkujtim të festave zyrtare të Pavarësisë dhe të çlirimit të Atdheut, Protokollit i Shtetit organizon çdo datë 28 Nëntor të çdo viti, gjatë gjithë ditës këto aktivitete përkujtimore:

a) Ceremoni në nderim të dëshmorëve të kombit:

b) Pritje shtetërore.

3.a.1 Ceremonia e nderimit të dëshmorëve të kombit: Në nderim të dëshmorëve të kombit, Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, Ministri i Mbrojtjes, Prefekti, Kryetari i Bashkisë, kryetari i Këshillit të Qarkut, si dhe organizatat e veteranëve vendosin kurora në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit në Tiranë, ora 10:00. Ceremoniali zhvillohet në përputhje me procedurat e përcaktuara në pikën 5 të këtij kapitulli për nderimin e dëshmorëve të kombit. Një herë në 5 vjet kjo ceremoni transferohet në qytetin e Vlorës dhe zhvillohet sipas ceremonialit të përcaktuar në pikën 2 të këtij kapitulli.

Çdo 28 Nëntor vendos një kurorë edhe trupi diplomatik i akredituar në Republikën e Shqipërisë. Gjatë ceremonisë së vendosjes së kurorës nga dekani i trupit diplomatik, marshe funebre shoqërojnë ecjen dhe himni kombëtar ekzekutohet në fund të ceremonisë. Në ceremoni nuk ka truporje nderi. " .

2. Paragrafi 3.1, ndryshohet si më poshtë vijon:

"3.1 Pritja shtetërore: Pritja shtetërore me rastin e festave zyrtare të Pavarësisë dhe të çlirimit të Atdheut organizohet në Pallatin e Brigadave, çdo 28 Nëntor, ora 19.30."

3. Në pikën 5 të kapitullit VII, të bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi 5.1 ndryshohet si më poshtë vijon:

"5.1 Në nderim të dëshmorëve të kombit, më 5 Maj të çdo viti, Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, Ministri i Mbrojtjes, Prefekti, Kryetari i Bashkisë, kryetari i Këshillit të Qarkut, si dhe organizatat e veteraneve, vendosin kurora ne Varrezat e Dëshmorëve të Kombit në Tiranë."

b) Paragrafi 5.6 shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

---

## VENDIM

Nr. 105, datë 22.2.2006

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.229, DATË 23.4.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR CEREMONIALIN ZYRTAR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 21 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 4 të "Konventës së Vjenës për marrëdhëniet diplomatike", ratifikuar me dekretin nr.7164, datë 10.10.1987, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ceremonialin zyrtar të Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr.229, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave, në kapitullin II "CEREMONIALI DIPLOMATIK", pas pikës 1, shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

"1/1. Akreditimi i shefit të Misionit Diplomatik të Republikës së Shqipërisë

1/1.1 Në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me ligjin për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë dhe me "Konventën e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike" (neni 4, paragrafi i parë: "shteti dërgues duhet të sigurohet që agreementi i shtetit pritës të jetë dhënë për personin që ai propozon të akreditojë si shef të misionit, pranë këtij shteti), akreditimi i ambasadorëve të Republikës së Shqipërisë, si proces, kalon në disa shkallë, gjatë të cilave kërkohet plotësimi i formaliteteve të paracaktuara.

1/1.2 Ministri i Punëve të Jashtme i paraqet Kryeministrit propozimet për emërimin e ambasadorëve.

1/1.3 Kur Kryeministri miraton kandidatët, Ministri i Punëve të Jashtme kërkon akreditimin e ambasadorit në shtetin pritës apo organizatën ndërkombëtare, ku ai do të akreditohet.

1/1.4 Pasi shteti pritës a organizata ndërkombëtare, ku do të akreditohet ambasadori, vlerëson kandidaturën për ambasador dhe miraton agreementin, Presidenti i Republikës emëron ambasadorin, në përputhje me parashikimet e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

---

## VENDIM

Nr. 583, datë 23.8.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 229, DATË 23.4.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR CEREMONIALIN ZYRTAR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, pika 2, e 49 të ligjit nr. 9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në aneksin e ceremonialit zyrtar të Republikës së Shqipërisë, të miratuar me vendimin nr. 229, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i pikës 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"5. Pajisja me targa CD dhe TR (jeshile)

2. Në pikën 5, nënpikat 5.1, 5.2, 5.4, 5.5, 5.7, 5.8, 5.9, 5.14, 5.16, 5.18 dhe 5.19 ndryshohen si më poshtë vijon:

"5.1 Numri i automjeteve, të importuara apo të blera në vend, nga misionet diplomatike, organizatat ndërkombëtare, të nevojshme për përdorim zyrtar, duhet të jetë i arsyeshëm dhe në varësi të madhësisë dhe të nevojave të misionit, por, në çdo rast, numri i tyre nuk mund të kalojë numrin e stafit diplomatik të këtij misioni. Automjetet pajisen me targë CD ose TR (jeshile). Ky rregull zbatohet edhe për automjetet, e importuara apo të blera në vend, nga agjencitë e specializuara të OKB-së, të cilat pajisen me targë CD.

5.2 Shefat e misioneve diplomatike dhe të organizatave ndërkombëtare, që me marrëveshje dypalëshe janë të barazuara me misionet diplomatike, mund të importojnë në emër të tyre, pa taksa doganore dhe taksa të tjera, dy automjete për përdorim personal, njëra prej të cilave jepet për bashkëshortin/en, të cilat pajisen me targë CD.

...

5.4 Shefat e agjencive të specializuara të OKB-së, në Shqipëri mund të importojnë, në emër të tyre, pa taksa doganore dhe taksa të tjera, një automjet për përdorim personal, i cili pajiset me targë CD. Mund të importohet ose të blihet në vend, pa taksa doganore dhe taksa të tjera, edhe një automjet tjetër shtesë, nëse personat në fjalë janë të shoqëruar nga bashkëshortja/i.

5.5 Anëtarët e përfaqësive diplomatike, të organizatave ndërkombëtare dhe të agjencive të specializuara të OKB-së, mbajtës të pasaportave diplomatike, mund të importojnë ose të blejnë në vend, pa taksa doganore dhe taksa të tjera, një automjet, ekskluzivisht për t'u përdorur prej tyre. Mund të importohet ose të blihet në vend, pa taksa doganore dhe taksa të tjera, edhe një automjet tjetër shtesë, nëse anëtari është i shoqëruar nga bashkëshorti/ja. Automjetet pajisen me targë CD.

...

5.7 Kërkesa për pajisjen me targë CD ose TR (jeshile) të automjeteve personale bëhet vetëm pas pajisjes, nga protokollin i shtetit, me kartë identiteti të anëtarit të përfaqësive diplomatike, të organizatës ndërkombëtare dhe agjencive të specializuara të OKB-së dhe të bashkëshortit/es.

5.8 Konsujt e nderit, pavarësisht nga shtetësia, ekskluzivisht për qëllime zyrtare, përdorin një automjet, i cili pajiset me targë të zakonshme kombëtare dhe me një shenjë dalluese, ovale, në të djathtë të

targave kombëtare, me simbolet HCC. Ky automjet mund të importohet apo blihet në Shqipëri, pa doganë.

5.9 Anëtarët e përfaqësive diplomatike, mbajtës të pasaportave diplomatike, mund të importojnë ose të blejnë në vend, pa taksa doganore dhe taksa të tjera, ekskluzivisht për përdorim personal, një motoçikletë. Për pajisjen e motoçikletave personale me targë CD ndiqet e njëjta procedurë si për automjetet.

...

5.14 Për pajisjen e automjeteve me targë CD, TR (jeshile) dhe HCC dhe me lejeqarkullimi, përfaqësitë diplomatike, organizatat ndërkombëtare, agjencitë e specializuara të OKB-së dhe konsullatat e nderit, duhet të paraqesin kërkesën, me notë verbale, në protokollin e shtetit, në Ministrinë e Punëve të Jashtme, ku duhet të shënojnë qëllimin, për të cilin do të përdoret automjeti, emrin e pronarit, tipin e automjetit, numrin e shasisë, ngjyrën, si dhe një fotokopje të vërtetimit-zhdoganimit, të faturës së zhdoganimit, të vërtetimit të hyrjes së automjetit, të lëshuar nga dogana ku është zhdoganuar, dokumentin e hyrjes, të lëshuar nga pika e kalimit kufitar, dhe fotokopjen e kartës së identitetit, në rastin kur automjeti është për përdorim personal. Nota duhet të dërgohet në protokollin e shtetit. Pas kësaj, përfaqësia diplomatike, organizatat ndërkombëtare ose konsujt e nderit dorëzojnë notën në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, e cila i pajis këto automjete me leje qarkullimi dhe me targë CD, TR (jeshile) apo HCC.

...

5.16 Targat CD, TR (jeshile) dhe HCC nuk janë të transferueshme, kur automjeti, që i mban ato, shitet ose ndryshon pronësi, në çfarëdo mënyre.

...

5.18 Numri i targave do të jetë në mënyrë progresive, me përjashtim të ambasadorit ose të përfaqësuesit të organizatës, i cili do të mbajë në automjetin e vet, zyrtar dhe personal, nr. 001.

5.19 Përfaqësitë diplomatike, konsullatat e nderit, organizatat ndërkombëtare dhe agjencitë e specializuara të OKB-së, pas pajisjes së automjetit me targë CD, TR (jeshile), ose TR e zakonshme (në rastin e konsujve të nderit) duhet të njoftojnë protokollin e shtetit, në Ministrinë e Punëve të Jashtme, për numrin e targës së dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Gjithashtu, kjo e fundit, duhet të njoftojë protokollin e shtetit për targat e dhëna."

3. Pika 5.22, e numërtuar gabim në vendimin bazë, bëhet 5.21.

4. Pika 5.23 dhe 5.24 bëhen, përkatësisht 5.22 dhe 5.23.

5. Pika 5.25 bëhet 5.24 dhe riformulohet, si më poshtë vijon:

"5.24 Sipas rregullave ekzistuese, misionet, kur anëtarët e personelit, të çdo kategorie, pronarë të automjeteve pa doganë, që largohen përfundimisht nga Shqipëria, në mbarim të misionit zyrtar, në rastet kur marrin me vete automjetet, duhet të kthejnë, me notë verbale targën CD, TR (jeshile), si dhe lejet e qarkullimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor. Konsujt e nderit duhet të kthejnë shenjën dalluese HCC pranë protokollit të shtetit dhe, pas kësaj, të bëjnë njoftimin në protokollin e shtetit. Nota verbale duhet të shoqërohet me fotokopjen e dokumentit të çregjistrimit, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

---

## VENDIM

Nr.754, datë 9.11.2006

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.229, DATË 23.4.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E CEREMONIALIT ZYRTAR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, pika 2, e 49 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në kapitullin VII të vendimit nr.229, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Festat zyrtare, ditë përkujtimore dhe ditë të tjera, të shënuara

1.1 Në Republikën e Shqipërisë festohen dhe përkujtohen festat zyrtare, ditët përkujtimore publike dhe ditë të tjera, të shënuara, në përputhje me këtë ceremonial.

1.2 Festa zyrtare janë ditë feste, të përcaktuara me ligj. Festa zyrtare janë:

1 e 2 janar Viti i Ri;

14 mars Dita e Verës;

22 mars Dita e Novruzit;

1 maj Dita e Punëtorëve;

19 tetor Dita e Lumturimit të Nënë Terezës;

28 nëntor Dita e Pavarësisë;

29 nëntor Dita e Çlirimit të Atdheut;

Bajram i Madh;

Bajram i Vogël;

Pashkët Ortodokse;

Pashkët Katolike;

25 dhjetor Krishtlindjet.

Gjatë festës zyrtare fetare, angazhimi i personaliteteve të larta shtetërore në veprimtari apo vizita urimi publike, në komunitetet fetare duhet t'u shërbejë forcimit të tolerancës, mirëkuptimit dhe bashkëjetesës së komuniteteve zyrtare fetare në vend.

Përveç kur pjesëmarrja e personaliteteve të larta shtetërore, sipas ceremonialit, të përcaktuar në këtë vendim, është e detyrueshme, pjesëmarrja në festat e tjera zyrtare, ditët e përkujtimit dhe ditët e shënuara bëhet në përputhje me traditën, nevojat apo kalendarin e personaliteteve.

**Ditë pushimi, sipas ligjit, janë vetëm ditët e festave zyrtare.**

1.3 Ditë përkujtimi publike janë ditë të rëndësishme përkujtimore, festimi apo përkujtimi i të cilave kryhet sipas rregullave të caktuara në këtë vendim. Ditë përkujtimi publike janë:

5 maji Dita e Dëshmorëve;

21 maji Dita e Kujtesës Historike për Viktimat e

Krimeve të Komunizmit;

4 dhjetori Dita e Forcave të Armatosura;

8 dhjetori Dita e Rinisë.

Në ditët e festave zyrtare dhe ditët e përkujtimit publik, në selinë e institucioneve, shtetërore dhe private, vendosen flamuri kombëtar dhe shenjat dalluese të institucioneve apo enteve përkatëse. Në këto ditë merren masa të veçanta për zbukurimin e shesheve qendrore të qyteteve.

1.4 Ditët e shënuara janë festa të karakterit fetar, vendor, ndërkombëtar, shoqëror apo politik, të cilat, për shkak të traditës ose të vlerave të veçanta, përkujtohen në Republikën e Shqipërisë. Ditë të shënuara janë:

6 janar Shën Jovani;

Dita e Hashures;

7 mars Dita e Mësuesit;

8 mars Dita e Gruas;

9 maj Dita e Europës;

20 maj Dita e Jetimëve;

1 qershor Dita e Fëmijëve;

16 shtator Festa e Pezës;

1 tetor Dita e të Moshuarve;

24 tetor Dita e OKB-së.

Ministritë përgjegjëse, për ditët e shënuara, kombëtare apo ndërkombëtare, me karakter ndërgjegjësues, të caktuara sipas legjislacionit në fuqi, organizojnë veprimtari përkatëse, sipas rregullave të protokollit të tyre.

Në ditët e shënuara mund të përfshihen edhe ditë të tjera, përkujtimi ose festimi i të cilave, në nivel kombëtar, bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, dhe në nivel vendor me vendim të njëjësive të organeve të qeverisjes vendore (p.sh. dita e ngritjes së flamurit në qytet apo e themelimit të qytetit). Veprimtaritë, që kryhen në përkujtim apo festim të ditëve të shënuara, përcaktohen, rast pas rasti, në vendimin e

përkujtimit, ku, përveç ceremonisë, përcaktohen edhe masat për zbukurimin e shesheve qendrore. Pjesëmarrja e personaliteteve të larta shtetërore në përkujtimin e ditëve të shënuara bashkërendohet nga Protokollit i Shtetit."

2. Fjalja e fundit, e pikës 2.13, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Pjesëmarrësit shpërndahen për t'u mbledhur përsëri në Tiranë, në Pallatin e Brigadave, për pritjen e festave zyrtare të Pavarësisë dhe të Çlirimit të Atdheut."

3. Pika 6 shfuqizohet.

4. Pika 7 "Parada jubilarë e Forcave të Armatosura", ndryshohet, si më poshtë vijon:

"7. Parada jubilarë e Forcave të Armatosura

7.1 Ceremonia jubilarë e paradës së Forcave të Armatosura të Republikës zhvillohet një herë në pesë vjet, më 4 dhjetor. Parada dhe ceremonia organizohen nga strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes.

7.2 Tribuna e nderit ngrihet në bulevardin "Dëshmorët e Kombit" dhe ndahet në tre sektorë kryesorë:

- Në tribunën A zënë vend personalitetet kryesore të shtetit:

Radha e parë: Presidenti i Republikës, Kryeministri, Ministri i Mbrojtjes, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Kryetari i Kuvendit, Zëvendëskryeministri, Ministri i Punëve të Jashtme, Ministri i Brendshëm, Komandanti i Forcave Tokësore, Komandanti i Forcave Ajrore, Komandanti i Forcave Detare, Komandanti i Komandës së Doktrinave dhe Stërvitjes Ushtarake, Komandanti i Komandës së Mbështetjes Logjistike, ish-presidentët e Republikës, ministrat e tjerë dhe Kryetari i Bashkisë së Tiranës.

Radha e dytë: Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, nënkryetarët e Kuvendit, zëvendësministri i Mbrojtjes, zëvendësministri i Punëve të Jashtme, gjeneralët e Forcave të Armatosura, me dy yje, kryetarët e grupeve parlamentare (4), kryetari i SHISH-it, kryetarët e klerit (4), prokurori i Përgjithshëm, kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, kryetari i Gjykatës së Lartë, guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Avokati i Popullit, ish-kryeministrat, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

Radha e tretë: Gjeneralë veteranë (10), kryetarët e partive parlamentare, sekretari i Përgjithshëm i Presidencës, sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, prefekti i Tiranës, këshilltari ushtarak i Presidentit, ish-ministra të Mbrojtjes, ish-ministra të Jashtëm, drejtorë në Ministrinë e Mbrojtjes, që kanë gradën kolonel.

- Në tribunën B zënë vend trupi i huaj diplomatik:

Në radhën e parë, ambasadorët e akredituar, sipas prezencës së tyre, atashetë ushtarakë, të akredituar, dhe drejtori i Protokollit të Shtetit.

Në radhën e dytë, përfaqësuesit e misionëve ushtarakë, komandanti i NATO-s, MTL-së, ODC-së, NATO-PFP CELL, SAIC-it, UNDP-së dhe të ftuar të tjerë, me shtetësi të huaj.

- Në tribunën C zënë vend personalitete të tjera të vendit:

Anëtarët e komisionit parlamentar të mbrojtjes, deputetë, këshilltarë të Presidentit dhe të Kryeministrit, sekretarët e përgjithshëm të ministrive, drejtorë të drejtorive, në Ministrinë e Mbrojtjes dhe ish-ministra."

5. Pas pikës 7, shtohen pikat 7/a e 7/b, me këtë përmbajtje:

"7/a. 8 dhjetori, Dita e Rinisë

7/a.1 Në nderim të lëvizjes për liri, demokraci, dinjitet njerëzor, dhe të aspiratës, për shtet ligjor e të integruar në strukturat atlantike, më 8 dhjetor, të çdo viti, përkujtohet Dita e Rinisë. Ceremonia organizohet nga ministria përgjegjëse, që mbulon çështjet e rinisë dhe të kulturës.

7/a.2 Përfaqësues të ministrisë, që mbulon çështjet e rinisë dhe të kulturës, më 7 dhjetor të çdo viti, në orën 20:00, ndezin flakën e pishtarit, në sheshin e Qytetit Studenti, në Tiranë. Flaka e pishtarit vazhdon të qëndrojë e ndezur edhe gjatë ditës së 8 dhjetorit. Përfaqësues të kësaj ministrie dhe përfaqësues, anëtarë të lëvizjes "Dhjetor 1990", bëjnë homazhe në memorialin e Qytetit Studenti, në orën 10:00.

Në orën 11:00, përfaqësues të lartë të shtetit zhvillojnë ceremoni zyrtare, përpara memorialit të liderit të lëvizjes së dhjetorit, Azem Hajdari, dhe vendosin kurora me lule. Në këto homazhe, ftohen të marrin pjesë edhe veprimtarë të lëvizjes "Dhjetor 1990".

Ministri përgjegjës për çështje të rinisë dhe kulturës, në bashkëpunim me institucionet, kulturore dhe shkencore, organizon në këtë ditë në qytete të ndryshme të vendit, veprimtari artistike dhe simpoziume shkencore.

7/a.3 Në të gjitha institucionet arsimore, publike dhe jopublike, parauniversitare, ditën e përkujtimit të 8 dhjetorit, me nxënësit, të ndarë sipas grupmoshave, në klasa individuale, zhvillon 45 minuta mësim, ku, sipas programit të miratuar nga ministria, që mbulon çështjet e arsimit, përkujtohen idealet e lëvizjes rinore "Dhjetor 1990" dhe aspiratat për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Programi i miratuar përfshin edhe të dhëna historike për përndjekjen politike, vuajtjen, torturat ndaj kundërshtarëve politikë nga regjimi komunist, në emër të luftës së klasave dhe të vendosjes së diktaturës komuniste.

7/a.4 Çdo vit jubilar (5 vjet), ministri përgjegjës për çështjet e rinisë dhe të kulturës drejton një komision ndërministror pune, për organizimin e ditës përkujtimore, Dita e Rinisë, i cili përcakton projektprogramin e kësaj dite përkujtimore.

Projektprogrami paraqitet për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, jo më vonë se 45 ditë para ditës së organizimit të përkujtimit. Protokollit i Shtetit përfshihet në përgatitjen e programit të punës dhe ndjek anën protokollare të zbatimit të tij. Në program marrin pjesë personalitetet më të larta të shtetit.

7/b. 21 maj, dita e kujtesës historike për viktimat e krimeve të komunizmit

Në përkujtim të mijëra viktimave të pafajshme të regjimit totalitar komunist, të cilët, u vranë, u burgosën, u dhunuan, u dëbuan dhe u denigruan, në mënyrë të organizuar shtetërore, për shkak se besonin në lirinë e ndërgjegjes, të pronës, lirive politike, aspironin përparim, më 21 maj të çdo viti, do të përkujtohet "Dita e kujtesës historike për viktimat e krimeve të komunizmit". Ceremonia përkujtimore do të organizohet nga ministria përgjegjëse, që mbulon çështjet e rinisë dhe të kulturës. Kur në ceremoni do të marrin pjesë personalitetet më të larta të shtetit, Protokollit i Shtetit përfshihet në përgatitjen e programit dhe në ndjekjen e anës protokollare të tij."

Ky ve ndim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM  
Nr.1544, datë 19.11.2008

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.229, DATË 23.4.2004 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E CEREMONIALIT ZYRTAR TË REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, pika 2, e 49 të ligjit nr.9095,  
datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e  
Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1.4 të kapitullit VII "Ceremonitë kryesore zyrtare", të ceremonialit zyrtar të  
Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr.229, datë 23.4.2004 të Këshillit të  
Ministrave, të ndryshuar, të shtohet si një ditë e shënuar edhe data:  
"20 nëntor Dita e Alfabetit."

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha